Të Rinjtë

Një gjeneratë e re për një Kosovë të re

UNDP Kosovë

RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

2006

KOSOVË 2006

UNDP Kosovë

Një gjeneratë e re për një Kosovë të re

RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

2006

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Programit për Zhvillim të OKB-së (UNDP) apo të USAID-it.

Në këtë raport, "Kosova" i referohet territorit të administruar nga OKB-ja në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Botimi i Raportit të Zhvillimit Njerëzor 2006 është bashkëfinancuar nga UNDP dhe USAID-i.

Perkthyes:
Organizata 'Shërbimet për Interpretimin dhe Përkthimin e Konferencave'

Redaktor i gjuhës angleze
Jeffrey Arthur Hoover

Produksioni: Rrota, www.rrota.com
Drejtor Artistik: Visar Ulaj
Thyerja: Arbër Matoshi
Shpat Paçarada
Ballina: Kushtrim Balaj
Fotografitë: Afrodita Bytyçi

Shtypi: Grafika Rezniqi - Prishtinë, Kosovë

Mirënjohje

Ekipi i ekspertëve Konsultues:
Dr. Ylli Çabiri dhe Dr. Lindita Xhillari nga Qëndra për Promovimin e Zhvillimit Njerëzor, dhe bashkëpuntorët e kësaj Qëndre.

Kontribuesit:
Ekspertët e 'Integra Consulting' dhe Dr. Ekrem Beqiri-Instituti Riinvest

Recenzentët:
Dukagjin Pupovci-Qendra për Arsim e Kosovës, Burim Leci-Departamenti i Rinisë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MA.Sabri Kicmari- Ligjërues në Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës, Andrey Ivanov-UNDP Qendra Rajonale ne Bratisllave (QRB)
Elena Danilova-UNDP Wendra Rajonale ne Bratisllave (QRB), Maike Verhagen-Organizata për Siguri dhe Kooperim në Europë, Valli Corbanese dhe Gianni Rosas-Organizata Ndërkombetare e Punës.

Felenderime të posaçme:
Remzi Salihu-Minsitra e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, Lemane Hatashi- Zyra e Krye ministrit KDSP-Sekretariati, Bashkim Bellaqa-Zyra Statistikore e Kosovës, Ilir T. Berisha-Zyra Statistikore e Kosovës, Ylber Shabani-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sihana Xhaferi-Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, Salih Morina-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Piotr Uhma- Organizata për Siguri dhe Kooperim në Europë, Fatmir Hoxha-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Blerim Azizi-Rrjeti Rinor i Kosovës, Dritan Shala-Koordinator i Sekretariatit PKVR 2007-2010 - Departamenti i Rinisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Krasniqi- Rrjeti Rinor i Kosovës dhe Vasa Pavić - CARE - Sërbia.

Stafi i UNDP në Kosovë:
Nora Ahmetaj - *Koordinatore e projektit*
Mytaher Haskuka - *Program Analist*

Si dhe të gjithë pjesëmarrësit ne punëtoritë e organizuara, në qendrat e të rinjve në Kosovë.

Punëtoria në Pejë
Anduen Krasniqi, Arton Muhaxheri, Ganimete Ramaj, Valdet Balaj, Regje Mulaj, Sahit Kandić, Lirije Demiraj, Fatos Fetahaj, Shkodran Mavraj, Hysen Nikqi,Valon Mavraj, Ibrahim Mulaj, Luan Hasanaj, Mehmet Mehmetaj, Tahire Gashi, Zymer Asani, Gjylfidane Sylaj, Haxhi Raci, Shemsije Seferi, Valon Loxhaj, Armend Vuthaj, Pal Marku, Burim Qelaj, Driton Zeqiraj, Gazmend Blakaj

Punëtoria në Gjakovë
Berat Thaçi, Memli Doli, Arbër Xharra, Besart Malaj, Egzon Alickaj, Avdyl Mehmetaj, Jorinda Gacaferi, Besjana Alickaj, Milot Lushaj, Jeton Krasniqi, Arjeta Miftari, Donika Ahmeti, Hekuran Radoniqi, Bashkim Kurti, Marina Maric, Alban Krasniqi, Ilir Cacaj, Asim Muqaj, Liridon Mazrekaj, Burim Bashaj, Ardian Dërvishaj, Krenare Kastrati, Kushtrim Saraqini

Punëtoria në Mitrovicë
Shqipe Qarkaj, Ivo Gjokiq, Radojko Vlaskovic, Aleksandra Stojanović, Bajruša Kosumi
Mehmet Çollaku, Naim Murati, Nehat Jusufi, Liridon Beqiri, Behxhet Maliqi, Adem Hajzeri, Vesna Ordic, Valbone Shala, Bashkim Paçarizi, Ardita Hamiti, Miranda Ibishi, Ergin Kani, Ylber Maxhuni, Vazira Bahtiri, Arjeta Miftari, Bashkim Asllani, Ukshin Feka, Burim Haxhiu, Merita Rama, Bujar Lahu

Punëtoria në Gjilan

Besim Salihu, Flamur Ismajli, Burim Korqa, Arbenita Llapashtica, Fatmire Llapashtica, Emrush Azemi, Besim Haliti, Shkëlqime Limani, Vjollca Jakupi, Arben Ramadani, Fitore Azemi, Sahit Abazi, Irfan Veseli, Mensur Morina, Shaban Terziu, Shehide Hasani, Hajrije Hasani, Jeton Biqkaj, Alban Rrahmani, Naim Shaqiri, Shprese Sahiti, Muhabere Kadriu, Adnan Hoxha, Riada Maloku, Enver Këqiku, Fehmi Sylejmani, Liza Gashi, Besfort Morina, Landim Terziu, Arlind Jonuzi, Getoar Jonuzi, Fisnik Muja

Punëtoria në Ferizaj

Enver Kashtanjeva,Alaudin Bytyqi, Uran Zeqiri, Kushtrim Palushi, Jetullah Sulejmani, Albulenë Nrecaj, Ardit Gashi, Arben Halili, Avni Raka, Rrahim Sejdiu, Majlinda Emini, Baki Bakiu, Ilir Ukiqi, Sevdije Rrahmani, Adnan Rexhepi, Kenan Gashi, Erton Bega, Nexhmedin Loki, Selman Thaqi, Nazmi Aliu, Avni Shabani, Makfire Ramadani, Bedri Pajaziti, Florentina Ferati, Besarta Vranovci, Edmond Salihu, Armond Pajaziti, Ilir Buzhala, Shaban Shabani, Arta Ferati, Abide Osmani, Sala Kurtaliqi

Punëtoria në Rahovec

Mehdi Krasniqi, Edmir Mullabazi, Fesal Jusufi, Bekim Bytyqi, Hidajete Mazreku, Bashkim Bytyqi, Mejtim Bytyqi, Mensur Zena, Remzi Gashi, Dritan Kërcagu, Xhemajl Durguti, Behar Hoti, Syle Kodra, Shedat Ukaj, Mirveta Hasku, Melisa Sharku, Enis Berisha, Jetmir Berisha, Hamdi Hoxha, Feride Hoxha, Jeton Zulfaj, Afërdita Dragaj, Ermira Bekeri, Sylejman Mustafa, Sead Nuhiu, Nazlije Sharku.

Falënderohen përzemërsisht: studentët dhe studentet e Departamentit të Sociologjisë, viti i tretë i studimeve, fakulteti Filozofik në Univerzitetin e Prishtinës, si dhe pjesëmarrësit në nëntë fokus grupe.

Lista e shkurtesave

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AED-USAID	Akademia për Zhvillim Arsimor-Agjensia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
BE	Bashkimi Europian
CEC / KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
CV	Curiculum Vitae
EJL	Evropa Juglindore
ESI / IES	Iniciativa Europiane për Stabilitet
ESK	Enti Statistikor i Kosoves
ETF-VET	Fondacioni Europian për Trainim-Trajnimi dhe Aftësimi
FMN/IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GTZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik
IARD	Instituti Italian për Hulumtime të Rinisë (Milano)
IIEP- UNICEF	Instituti Ndërkombëtar për Planifikim Arsimor- Fondi për fëmijë i OKB
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IVNJ-1	Indeksi i Varfërisë Njerëzore-1
IVNJ-2	Indeksi i Varfërisë Njerezore-2
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OBP/ILO	Organizata Botërore e Punës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri the Bashkëpunim e Europës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse
RAE	Romët,Ashkalinjtë dhe Egjiptianët
RZHNJ	Raporti i Zhvillimit Njerëzor
UP	Universiteti i Prishtinës
UNDP	Programi Zhvillimor i OKB
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e OKB
UNFPA	Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për fëmijë i OKB
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të OKB në Kosovë
USAID	Agjensia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
WB/BB	Banka Botërore

Parathënie

Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës (RZHNJK 2006) është raporti i tretë i tillë i hartuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) me qëllim të shqyrtimit të sfidave politike, ekonomike dhe sociale, si dhe të mundësive të Kosovës. Raporti i parë i vitit 2002 u përqendrua në treguesit, siç janë: Indeksi i zhvillimit njerëzor, Indeksi i zhvillimit gjinor dhe Indeksi i varfërisë njerëzore. Në bazë të këtyre treguesve, Kosova është kategorizuar se ka një nivel mesatar të zhvillimit njerëzor. Raporti i dytë i vitit 2004 i paraqiti të dhënat e zhvillimit njerëzor nga niveli komunal dhe Indeksin e parë të pjesëmarrjes, që i përshkroi nivelet e pjesëmarrjes në jetën civile dhe politike të grupeve të ndryshme etnike në komuna, duke përfshirë vendet urbane dhe ato rurale.

Raporti i tretë është përqendruar në një fushë tjetër – në rininë e Kosovës. RZHNJK-ja e vitit 2006 i shqyrton problemet, me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e këtij grupi të rëndësishëm të popullatës, shenjat shpresëdhënëse për të ardhmen e tyre më të ndritur dhe pozitën e tyre të përgjithshme në shoqëri. Përmes këtij raporti analizohen problemet dhe mundësitë e tyre nga këndvështrimi i zhvillimit njerëzor, dhe tentohet të arrihet ky qëllim përmes shqyrtimit të rolit të rinisë në proceset zhvillimore të Kosovës, duke përfshirë çështjet lidhur me arsimin e edukimin, punësimin, vendimmarrjen, kohezionin civil dhe lidhur me pjesëmarrjen e përgjithshme në shoqëri. Përmes këtij raporti, u apelohet institucioneve publike dhe autoriteteve që të krijojnë marrëdhënie të forta me të rinjtë në mënyrë që shqetësimet e tyre specifike të dëgjohen dhe të trajtohen. Raporti po ashtu përmban rekomandimet për atë sesi duhet të rritet përfshirja e tyre në proceset e monitorimit dhe vendimmarrjes, si dhe në zbatimin e politikave të Qeverisë.

RZHNJK-ja e vitit 2006 në mënyrë specifike rekomandon që zyrtarët e Qeverisë, politikëbërësit dhe donatorët të hartojnë strategji për të reformuar sektorin e arsimit dhe të punësimit. Strategjitë e tilla mund të përfshijnë caktimin e qëllimeve afatmesme dhe afatgjata, që janë të qarta dhe të matshme, për përmirësimin e shkollave dhe të objekteve të tjera edukativo-arsimore. Ngjashëm me këtë, përmes këtij raporti rekomandohet që të gjitha institucionet qeveritare në Kosovë të bashkëpunojnë në hartimin e programeve të parapara për rritjen e mundësive për punësim të të rinjve. Rekomandimet e tjera përqendrohen në atë sesi institucionet e Kosovës, me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, mund të vlerësojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e nismave të Qeverisë në përmirësimin e jetës së të rinjve dhe përkrahjen që mund ta japin ato.

Procesi i hulumtimit dhe i hartimit të RZHNJK-së të vitit 2006 ishte mjaft sfidues për shkak të strukturës së tij të veçantë dhe metodologjisë së përdorur në hartimin e tij. Ky proces jo vetëm që bazohet në analiza të të dhënave sasiore dhe cilësore të mara nga burimet e shumta, por gjithashtu është bazuar edhe në qasjen pjesëmarrëse në grumbullimin e të dhënave. Fillimisht u bë një anketë me 1200 të intervistuar të grupmoshës 15-29 vjeçare dhe u zhvilluan nëntë diskutime në grupe të fokusuara ku morën pjesë palë të ndryshme me interes. Më pastaj, gjithandej Kosovës u organizuan edhe shtatë punëtori me të rinjtë me qëllim të dëgjimit të shqetësimeve dhe çështjeve të tyre, si dhe të vlerësimit të rezultateve të anketës së lartpërmendur e të diskutimeve të mëhershme në grupe të fokusuara. Burimet dytësore, siç janë dokumentacioni i punës dhe planet e punës së institucioneve ishin shumë të dobishme gjatë procesit të hartimit. Edhe pse këta hapa u dëshmuan të jenë tepër të rëndësishëm në kuptim të grumbullimit të informatave të dobishme dhe të vrojtimeve, një sfidë e vazhdueshme gjatë procesit ishte mungesa e të dhënave statistikore dhe qasja në të dhënat e regjistruara e në baza të të dhënave. Raporti përfundimtar është fryt i punës dhe përkushtimit të madh të individëve që ndihmuan në tejkalimin e pengesave gjatë hartimit të tij.

Raporti përfundimtar është i ndarë në disa kapituj. Në kapitullin I shqyrtohen analizat e përgjithshme të indekseve, si dhe lidhjet mes arsimimit dhe hyrjes në radhët e fuqisë punëtore. Në kapitullin II analizohet gjendja në sistemin shkollor ku identifikohen dobësitë e tij dhe jepen rekomandime për përmirësime, veçanërisht lidhur me përgatitjen e të rinjve për punësim.

Kapitulli III trajton arsyet pse investimet në rini, posaçërisht në aspektin e ngritjes së cilësisë së arsimit dhe të mundësive për punësim, paraqesin investim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e varfërisë dhe në zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë në përgjithësi. Në fund, përmes kapitullit IV shqyrtohet mënyra sesi mund të përfitoj shoqëria e Kosovës nga pjesëmarrja më e madhe e rinisë në procesin e vendimmarrjes. Përfshirja më e gjerë e rinisë do të lirojë entuziazmin, energjinë dhe kreativitetin e tyre, të cilat do të mund të ndihmojnë në heqjen e pengesave në zhvillimin politik, ekonomik dhe shoqëror.

Dëshiroj t'ua shprehi falënderimet e mia të gjithë atyre që kontribouan në këtë raport. Po ashtu, kolegët e mi nga UNDP-ja së bashku me mua shprehin falënderimet për USAID-in në Kosovë si dhe për përkrahjen e tyre financiare, nga e cila është varur ky raport.

Frode Mauring
Përfaqësues i Përhershëm
UNDP Kosovë

Përmbajtja

Përmbledhje e përgjithshme 13

1. SFIDA E TRANZICIONIT 21

1.1 Rinia, tranzicion i dyfishtë 21
1.2 Kosova, tranzicion pa status 26
1.3 Niveli i zhvillimit njerëzor 32
1.4 Politika dhe masa prioritare 35

2. E DREJTA DHE MUNDËSIA PËR T'U ARSIMUAR 41

2.1 Arsimi parauniversitar 41
2.2 Arsimi i lartë 48
2.3 Investimi për arsimimin e të rinjve 51
2.4 Politika dhe masa prioritare 54

3. NGA SHKOLLA NË PUNË 59

3.1 Tranzicion i vështirë 59
3.2 Mundësitë për t'u punësuar 61
3.3 Nivele shqëtësuese të papunësisë 64
3.4 Aftesimi profesional 69
3.5 Planet për të ardhmen 71
3.6 Politika dhe masa prioritare 71

4. PJESËMARRJA – E DREJTË DHE PËRGJEGJËSI 77

4.1 Pjesëmarrje simbolike e të rinjve 77
4.2 Jeta shoqërore në komunitet 78
4.3 Pjesëmarrja në demokraci 83
4.4 Politika dhe masa prioritare 88

SHTOJCA 1 91

KUTIZAT

Kutiza 1.1 Përbërësit e tranzicionit të moshës 21
Kutiza 1.2 Pavarësia ekonomike 23
Kutiza 1.3 Trafikimi-Rreziku me i ri i tranzicionit 24
Kutiza 1.4 Rrëfimi i një vajze 26 vjeçare bullgare 24
Kutiza 1.5 Përparimi i demokracisë 26
Kutiza 1.6 Parashikimi i zhvillimit makroekonomik 28
Kutiza 1.7 Paqartësia mbi dërgesat 29
Kutiza 1.8 Shpërfillja e statistikave 30
Kutiza 1.9 Ngërçi i financimeve 32
Kutiza 1.10 Matja e zhvillimit njerëzor 32

Kutiza 2.1 Cilësia e kapitalit njerëzor 41
Kutiza 2.2 Cilësi e ulët e arsimit fillor në vendet në zhvillim 44
Kutiza 2.3 Dy qasje të ndryshme për reformën e kurrikulave 45
Kutiza 2.4 Sa është real vlerësimi i dijeve të nxënësve? 45
Kutiza 2.5 Politikat Europiane të Kualifikimeve 48
Kutiza 2.6 Procesi i Bolonjës 49

Kutiza 2.7 "…Marrëdhëniet student-pedagog 50
Kutiza 2.8 Lehtësi për arsimin e minoriteteve 51

Kutiza 3.1 Plani akcional i punësimit të të rinjve në Kosovë – 2007-2010 62
Kutiza 3.2 Në administratën publike kërkohet mendësi e re 63
Kutiza 3.3 Përse krijohen kaq pak vende pune? 67
Kutiza 3.4 Plan i veprimit për rininë 2007-2010 69
Kutiza 3.5 Fond Vetëpunësimi për rininë në fshat 69
Kutiza 3.6 Frytshmëri e ulët e shërbimit të punësimit 71
Kutiza 3.7 A është zgjidhje emigrimi? 71

Kutiza 4.1 Koncepti i pjesëmarrjes 77
Kutiza 4.2 Objektiva të OJQ-ve rinore 79
Kutiza 4.3 Ç'po ndodh me OJQ-të rinore? 80
Kutiza 4.4 Një qasje e gabuar? 81
Kutiza 4.5 "Vullnetarizmi institucional" i Kosovës 82
Kutiza 4.6 Misioni dhe objektivat e Departamentit të Rinisë 84
Kutiza 4.7 Model i suksesshëm pjesëmarrjeje 84
Kutiza 4.8 Objektivat e politikës së pjesëmarrjes 84
Kutiza 4.9 Nisma për punësimin e të rinjve 85

TABELAT

Tabela 1.1: Grupmosha e rinisë në vendet e EJL 22
Tabela 1.2: Disa tregues kryesorë makroekonomikë 27

Tabela 1.3: Vlerat e llogaritura të PBB dhe PBB për frymë 28
Tabela 1.4: Të dhënat për llogaritjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 33
Tabela 1.5: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 34
Tabela 1.6: Indeksi i Varfërisë Njerëzore (IVNJ-1) të Kosovës në % 35

Tabela 2.1: Numri i nxënësve në arsimin parauniversitar sipas viteve 42
Tabela 2.2: Numri i nxënësve dhe shkollave të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2004/2005 43
Tabela 2.3: Shkalla e regjistrimit në arsimin fillor (2003/2004) 43
Tabela 2.4: Shkalla e e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë (2003/2004) 46
Tabela 2.5: Krahasimi i treguesit nxënës/mësues 47
Tabela 2.6: Nxënësit në arsimin e mesëm dhe në arsimin profesional 2002-2005 47
Tabela 2.7: Shpenzimet për arsimin sipas viteve (në milion Euro dhe në %) 52
Tabela 2.8: Struktura e shpenzimeve publike për arsimin 53
Tabela 2.9: Shpërndarja e shpenzimeve sipas niveleve arsimore, 2003 53

Tabela 3.1: Pjesa e rinisë në tranzicionin nga shkolla në punë 59
Tabela 3.2: Treguesit kryesorë të tregut të punës (2004) 61
Tabela 3.3: Të rinjtë në tregun e punës (2004) 61
Tabela 3.4: Numri i të papunëve dhe i bizneseve 65
Tabela: 3.5: Papunësia sipas grup-moshave 65
Tabela 3.6: Shkalla e kualifikimit të të papunëve 66
Tabela 3.7: Të trainuarit sipas grup-moshave 70
Tabela 3.8: Të trainuarit sipas komunave 70

Tabela 4.1: Disa të dhëna mbi pjesëmarrjen e të rinjve në Kosovë 77

SHTOJCA 1

Tabela 1: Shpëndarja gjeografike dhe etnike e mostrës 91
Tabela 2: Shpërndarja e mostrës sipas etnive dhe zonës rurale dhe urbane (%) 91

FIGURAT

Figura 1.1.	Vendimmarrja në familje	22
Figura 1.2:	Marrëdhëniet me prindërit	22
Figura 1.3:	Varësia financiare nga familja	23
Figura 1.4:	Kur mendon të shkëputesh nga familja e prindërve?	23
Figura 1.5:	Vendimmarrja për martesë	24
Figura 1.6:	Marrëdhëniet ndëretnike midis të rinjve	25
Figura 1.7:	Fondet për politikat rinore	25
Figura 1.8:	Evolucioni i disa treguesve makroekonomikë	27
Figura 1. 9:	Arsyet e emigrimit të të rinjve	29
Figura 1.10:	Vendet në tranzicion me dërgesat më të larta	29
Figura 1.11:	Varfëria e skajshme sipas grup-moshave	31
Figura 1.12:	Struktura e të ardhurave në zonën urbane	31
Figura 1.13:	Indeksi i të ardhurave i vendeve të rajonit të Ballkanit	33
Figura 1.14:	Indeksi i Jetëgjatësisë së vendeve të rajonit të Ballkanit	33
Figura 1.15:	Indeksi i Arsimimit i vendeve të rajonit të Ballkanit	34
Figura 1.16:	Renditja e vendeve të Ballkanit sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor	34
Figura 2.1:	Përceptimi mbi cilësinë e niveleve të ndryshme të sistemit të arsimit të mesëm të lartë	42
Figura 2.2:	Nxënësit në arsimin profesional sipas profileve	47
Figura 2.3:	Numri i studentëve sipas viteve	49
Figura 2.4:	Pranimet në universitet	49
Figura 2.5:	Pranimet me pagesa informale	49
Figura 2.6:	Cilësia e përgatitjes së studentëve	50
Figura 2.7:	Mundësia për tu punësuar	50
Figura 2.8:	Struktura e shpenzimeve të arsimit	53
Figura 3.1:	Pjesa e të rinjve punëkërkues	59
Figura 3.2:	Bizneset sipas numrit të punonjësve	61
Figura 3.3:	Punësimi i të rinjve sipas sektorëve	62
Figura 3.4:	Përdorimi i internetit nga të rinjtë	63
Figura 3.5:	Papunësia në Kosovë	64
Figura 3.6:	Të papunët sipas etnive	65
Figura 3.7:	Të rinje të papunë sipas gjinisë	66
Figura 3.8:	Vendet e punës sipas sektorëve	67
Figura 3.9:	Arsyet e të qënit i papunë	67
Figura 3.10:	Biznesi familiar	68
Figura 4.1:	Pjesëmarrja e të rinjve në veprimtari shoqërore	78
Figura 4.2:	Ndikimi në qështjet komunitare	79
Figura 4.3:	Pjesëmarrja e të rinjve në OJQ	79
Figura 4.4.:	Pjesëmarrja e të rinjve në iniciativa rinore	80
Figura 4.5:	Dëshira për të marrë pjesë në OJQ	80
Figura 4.6:	Shpërndarja e Asambleve Komunale Rinore	81
Figura 4.7:	Pjesëmarrja si vullnetarë	83
Figura 4.8:	Përceptimi mbi përfitimet nga puna vullnetare	83
Figura 4.9:	Përceptimi i të rinjve mbi punën e institucioneve	85
Figura 4.10:	Interesi për t'u marrë me politikë	86
Figura 4.11:	Përfaqësimi në politikë	87
Figura 4.12:	Interesi për të marrë pjesë në votime	87
Figura 4.13:	Vlerësime mbi sistemin e zgjedhjeve në Kosovë	87
Figura 4.14:	Vlerësime mbi besueshmërinë e mediave në Kosovë	88
Figura 4.15:	Mediat dhe nevojat e të rinjve	88

SHTOJCA 1

Figura 1:	Shpërndarja e mostrës sipas komunave	91

Përmbledhje e Përgjithshme

Hyrje

Kosova është vendi me popullsi më të re në Europë, ku mbi gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeç. Të rinjtë nga 15 deri në 25 vjeç zënë rreth 21% të popullsisë. Rrjedhimisht, sfidat e zhvillimit politik, ekonomik dhe shoqëror të Kosovës përgjatë këtij tranzicioni të vështirë janë, para së gjithash, sfida të të rinjve të sotëm, që nesër do të jenë punëtorët, biznesmenët, prindërit, qytetarët dhe udhëheqësit e Kosovës. Për këtë arësye, Raporti i Zhvillimit Njerëzor - Kosova 2006 është fokusuar tek rinia[1], duke analizuar problemet kryesore me të cilat ajo përballet, rolin që luan në Kosovë dhe rrugët për ta fuqizuar më tej pjesëmarrjen dhe ndikimin e saj në përparimin e Kosovës.

Raporti përmban katër kapituj. Kapitulli i parë paraqet ndryshimet e moshës së rinisë në kushtet e tranzicionit të Kosovës, duke vlerësuar se çdo investim tek rinia është një investim për të nxitur përparimin e vendit dhe përshpejtuar zbutjen e varfërisë. Kjo mund të realizohet vetëm me të rinj cilësisht të arsimuar dhe të pajisur me njohuri, aftësi dhe kompetenca bashkëkohore. Prandaj Kapitulli i dytë përqëndrohet në të drejtën e të rinjve për t'u arsimuar, me një theks të veçantë tek shkalla e përgatitjes së tyre për jetën. Kapitulli i tretë shqyrton problemet që lidhen me kalimin e të rinjve nga shkolla në punë dhe rëndësinë që ka për një vend si Kosova që çdo i ri të jetë në shkollë ose në punë. Që shoqëria të mund të përfitojë nga energjia, entuziazmi dhe dijet e rinisë, ajo duhet të krijojë kushtet që të rinjtë të mund të ushtrojnë të drejtën dhe përgjegjësinë e tyre të pjesëmarrjes qytetare. Gjendja e sotme dhe rrugët për rritjen e rolit të gjithanshëm të të rinjve në jetën shoqërore dhe politike dhe në përparimin e demokracisë, analizohen në Kapitullin e katërt.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006 është bazuar në rezultatet e një anketimi të gjerë të të rinjve, të ndërtuar posaçërisht mbi tematikën e këtij raporti. Çështjet e trajtuara u bënë, gjithashtu, objekt diskutimesh në tryeza debatesh me të rinjtë në shumë rajone të Kosovës. Raporti ka marrë parasysh edhe të dhëna e dokumente strategjikë të institucioneve të Kosovës, studime të ndryshme të organizatave jo qeveritare dhe institucioneve ndërkombëtare mbi Kosovën, si dhe përvojën disa vjeçare të UNDP në Kosovë.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006 përfshin disa politika e masa prioritare, që lidhen ngushtë me çështjet që trajton. I është kushtuar kujdes që këto të mos jenë përsëritje e rekomandimeve të dokumenteve të shumtë strategjikë të Kosovës, por të jenë më shumë masa plotësuese për zbatimin me sukses të reformave. Ky raport nuk ka për qëllim të zëvendësojë politikat institucionale e sektoriale, që ekzistojnë në Kosovë. Ai synon të jetë një instrument, që nxit debatin e të rinjve, institucioneve, donatorëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe medias mbi këto politika, si dhe mbi masat prioritare për zbatimin e tyre.

Sfida e tranzicionit

Shkollimi, punësimi, shëndeti, aftesimi i familjes dhe të ushtruarit e qytetarisë janë përbërësit kryesorë të tranzicionit të moshës së rinisë. Menaxhimi i këtij tranzicioni, megjithëse në dukje është një çështje e çdo të riu, lidhet ngushtë me familjen, shtetin dhe shoqërinë, si dhe me mjedisin e me mundësitë që ata ju ofrojnë të rinjve për të marrë vendime të drejta. Të rinjtë e Kosovës janë tradicionalisht shumë të lidhur me familjet e tyre prandaj edhe tranzicioni i tyre i moshës lidhet ngushtë me profilin e familjes. Ekonomitë familjare të Kosovës janë të mëdha dhe në to vendimet më të rëndësishme zakonisht merren nga prindërit. Të rinjtë kanë vështirësi të shkëputen nga familja, jo vetëm per shkak te traditës, por sepse janë shumë të varur ekonomikisht prej familjes dhe nuk i kanë mundësitë financiare të ndërtojnë jetën jashtë saj.

Tranzicioni i të rinjve të sotëm është i dyfishtë. Tranzicioni i tyre i moshës përkon me tranzicionin e vështirë të Kosovës. Reformat ekonomike po zbatohen në kushtet e një ekonomie të prapambetur, me të ardhura dhe shpenzime intitucionale modeste dhe me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, e cila vitet e fundit është zvogëluar në mënyrë drastike. Dërgesat e emigrantëve, që deri dje mendohej se ishin një e ardhur e konsiderueshme për Kosovën, janë zvogëluar mjaft dhe rreth tyre ka shumë paqartësi. Varfëria prek rreth 1/3 e popullsisë dhe 15.2% e saj jeton në varfëri të skajshme.

Mungesa e një Statusi të qartë e përfundimtar vazhdon te paraqes njërën ndër pengesat kryesore të tranzicionit në Kosovë. Ekonomia ka mbetur e mbërthyer në ngërçin e financimit, të investimeve të pamjaftueshme, të mosshfrytëzimit të burimeve potenciale, të papunësisë së lartë dhe të pamundësisë për të zbutur varfërinë. Mungesa e statusit po pengon edhe zbatimin e strategjive të shumta të hartuara, për shkak të mungesës së burimeve financiare.

Kjo gjendje nuk ka dhënë ndonjë ndikim të dukshëm pozitiv në nivelin e zhvillimit njerëzor. Kosova renditet e fundit në rajonin e Ballkanit për vlerat e Indeksit të të Ardhurave dhe atij të Jetëgjatësisë. Si rrjedhim, vlera e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të saj në vitin 2006 ka një rritje të lehtë krahasuar me vlerën e vitit 2002.

Në kushtet e një tranzicioni kaq kompleks, krijimi i mundësive për rininë, që të marrë pjesë aktive në punën e gjithanshme për transaftesimin e vendit, mbetet një objektiv prioritar i politikave shumësektoriale të zhvillimit të Kosovës. Që kjo të bëhet e mundur, krahas masave për sigurimin e rritjes ekonomike të vendit, nëpërmjet përshpejtimit të reformave, janë të nevojshme të ndërmerren edhe masa të veçanta, për të krijuar kushtet që çdo i ri të jetë në shkollë ose në punë.

E drejta dhe mundësia për t'u arsimuar

Zhvillimet politike të viteve '90 e kushtëzuan mjaft ecurinë e arsimit në Kosovë, duke sjellë një prapambetje të dukshme sidomos në cilësi. Pas vitit 1999 filluan reformat e para për ndryshimin e kësaj gjendjeje, që prekën të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Megjithëse të dhënat statistikore nuk japin mundësi të gjykohet saktë mbi shkallën e interesit të të rinjve për të ndjekur shkollën, kuotat e regjistrimit janë të larta në arsimin e detyrueshëm, por fillojnë e zvogëlohen në arsimin e mesëm e sidomos në arsimin e lartë. Arsyet e kësaj rënie janë të shumta, por gjendja e keqe ekonomike e familjeve, mungesa e motivimit të nxënësve për të mësuar, kushtet e mësimit dhe largësia e shkollave nga vendbanimet dhe, në rastin e vajzave, tradita zakonore e familjes, janë ato që ndikojnë më shumë tek të rinjtë për të mos ndjekur shkollën e mesme. Pamundësia ekonomike dhe numri mjaft i kufizuar i pranimeve në Universitetin e Prishtinës janë arësyet kryesore të kuotes shumë të ulët të regjistrimit. Duke qënë se rreth 2/3 e të rinjve të interesuar u privohet e drejta për t'u regjistruar në Universitet të Prishtinës, janë krijuar kushte të favorshme për pranime subjektive, me baza njohjeje ose me pagesa informale.

Reforma e sistemit të arsimit përparon në kushte mjaft të vështira financiare. Zvogëlimi i shpejtë i kontributit të donatorëve nuk ka mundur të balancohet nga rritja e kontributit të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Pjesa më e madhe e shpenzimeve shkon për pagat e punonjësve të sistemit të arsimit dhe buxheti është më shumë një financim mbijetese se sa zhvillimi për këtë sektor.

Në këto kushte, është i nevojshëm një ndërgjegjësim më i madh i shoqërisë dhe i vendimmarrësve mbi përgjegjësinë që kanë për arsimimin e të rinjve. Çështja e arsimimit të të rinjve nuk duhet konsideruar thjesht si përgatitje e tyre për tregun e punës dhe si përgjegjësi e tyre, e familjeve dhe e disa institucioneve. Dituria është pasqyra e emancipimit të përgjithshëm shoqëror të një vendi, prandaj arsimimi i të rinjve, para së gjithash, duhet konsideruar si një çështje me rëndësi primare.

Nga shkolla në punë

Të rinjtë përbëjnë moshën e kalimit nga shkolla në tregun e punës. Punësimi i tyre për herë të parë kushtëzohet nga cilësia jo e përshtatëshme e shkollimit, kërkesa e ulët e tregut të punës për forca pune dhe nevoja e madhe që të rinjtë kanë për t'u punësuar sa më parë. Mundësitë e punësimit janë të kufizuara për shkak të zhvillimit shumë të ngadaltë të biznesit privat. Punësimi në sektorin publik gjithashtu nuk është i lehtë për shkak të mundësive të limituara për punsim në sektorin publik, kujdesit të vendimmarrësve dhe mungesës së procedurave rigoroze dhe transparente të rekrutimit. Të rinjve, që arrijnë të punësohen në administratë, përgjithësisht u krijohet një mjedis bashkëpunues pune, por përfshihen pak në vendimmarrje. Këta të rinj shprehen qartë se në administratën publike kërkohet një mendësi e re, me metoda të përparuara pune dhe vendimmarrje gjithpërfshirëse. Vetëm të rinjtë mund ta sjellin këtë mendësi të re.

Për shkak të këtyre kufizimeve të tregut të punës, papunësia e të rinjve ka ardhur duke u rritur, veçanërisht tek të rejat. Aktualisht në Kosovë ka 530 të papunë të regjistruar për një vend pune të lirë. Politikat e rritjes së punësimit janë fokusuar në nxitjen e zhvillimit të bizneseve dhe paisjen e të rinjve me njohuritë e nevojshme, sa më në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Nxitja e ndërmarrësisë së rinisë vlerësohet, gjithashtu, si një rrugë e rëndësishme për rritjen e punësimit, por për këtë nevojitet një kuadër ligjor lehtësues. Megjithëse rreth gjysma e numrit të të rinjve të Kosovës janë pjesë e popullsisë rurale, numri i atyre të punësuar në sektorin bujqësor është i vogël. Zhvillimi i bujqësisë me ritme më të ngadalta se çdo sektor tjetër dhe rënia e interesit të të rinjve për të punuar në bujqësi janë disa prej arësyeve kryesore të kësaj gjendjeje.

Aftesimi profesional konsiderohet si një urë lidhëse midis shkollës dhe punës dhe si një masë që lehtëson punësimin e të rinjve. Megjithë përmirësimet në këtë sektor, kapacitetet trainuese janë shumë të kufizuara në krahasim me nevojat dhe sistemi i aftesimit profesional nuk ka si referencë të punës së tij rezultatin, por vetëm numrin e të trainuarve, pa ditur nëse ata punësohen apo jo më pas.

Për nxitjen e punësimit të të rinjve janë hartuar dokumente të ndryshme strategjike. Ato kanë nevojë të njësohen, për të evituar konfuzionin dhe mbivënien e përgjegjësive të institucioneve përkatëse, si dhe të kordinohen nga ana financiare me Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Pa këtë koordinim, ato nuk mund të financohen nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe rrezikojnë të mbeten në letër.

Pjesëmarrja- e drejtë dhe përgjegjësi

Ndikimi i të rinjve të Kosovës ndaj vendim marrjes së institucioneve, që kanë lidhje me jetën e tyre, është shumë i vogël. Kjo vjen sepse institucionet nuk e ndjejnë detyrimin për ta respektuar të drejtën e pjesëmarrjes së rinisë, por edhe sepse vetë të rinjtë nuk e kuptojnë pjesëmarrjen si përgjegjësi qytetare.

Angazhimi i pakët qytetar dhe mungesa e pjesëmarrjes aktive të tyre lidhet ngushtë me faktin se të rinjtë e grupmoshës 15-19 vjeç kanë preokupim kryesor shkollën dhe ata të grupmoshës 20-25 vjeç gjetjen e një vendi pune. Nga njera ane ata janë të prirur më shumë për çdo lloj veprimtarie, që i lehtëson zgjidhjen e problemit kryesor që kanë dhe janë shumë më pak të interesuar për veprimtari të tjera. Nga ana tjetër, të rinjtë e të dy grupmoshave kanë kulturë të pakët angazhimi qytetar, sepse nuk kanë marrë njohuri të tilla në shkollë dhe familja nuk ushtron ndonjë ndikim të dukshëm mbi ta në favor të këtij angazhimi.

Kultura e pakët e pjesëmarrjes dhe mendësia hierarkike e familjes bëjnë që ndikimi i të rinjve në komunitetin ku bëjnë pjesë të jetë i vogël. Edhe pjesëmarrja e tyre në organizatat jo qeveritare është minimale dhe përgjithësisht të rinjtë nuk ndjehen përfitues nga projektet e këtyre organizatave. Ky është një tregues shqetësues për vetë organizatat, që shtron për diskutim çështjen e efiçiencës së tyre, kapaciteteve menaxhuese dhe transparencës së veprimtarisë.

Qendrat rinore, të ngritura me entuziazëm menjëherë pas vitit 1999 me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, kanë luajtur për disa vite një rol të rëndësishëm në tërheqjen e të rinjve në veprimtari të përbashkëta. Tani entuziazmi ka rënë, veprimtaria e qendrave është kufizuar dhe shumë prej tyre tashmë janë mbyllur. Arësyeja kryesore është se askush nuk mendoi më parë për qëndrueshmërinë e tyre dhe shumica nuk mundën të mbijetojnë pas ndërprerjes së financimeve të donatorëve që i krijuan.

Kosova ka një përvojë të suksesshme shumë të veçantë vullnetarizmi, por ky është në rënie, veçanërisht tek të rinjtë. Sot, në kushtet e paqes, shumë prej elementëve nxitës dhe motivues të periudhës para vitit 1999 mungojnë dhe, mbi të gjitha, mungon një situatë kur shoqëria të ndjehet e rrezikuar. Nga institucionet nuk i është kushtuar kujdes, që kjo përvojë të evidentohet dhe t'i transmetohet të rinjve. Prandaj të rinjtë e njohin pak vullnetarizmin dhe shpesh e perceptojnë më tepër si aktivitet edukues se sa aktivitet shoqëror, që kontribuon për zhvillimin e komunitetit.

Edhe pjesëmarrja e rinisë në politikë është e kufizuar dhe për këtë të rinjtë ndajnë opinione të ndryshme. Disa e perceptojnë pjesëmarrjen në politikë si përkushtim, shpenzim kohe dhe sakrificë personale e familjare. Të tjerë e vlerësojnë si ambicje personale për të bërë karrierë, ku përfitimet janë motivi kryesor i përfshirjes. Ky perceptim i shumicës së të rinjve ndikon negativisht në dëshirën e tyre për të kontribuar në jetën politike të Kosovës. Por, nga ana tjetër, rinia nuk ka qasje të mjaftueshme në vendim marrjen politike dhe ndjehet e pa përfaqësuar sa duhet në të.

Ushtrimi i të drejtës për të votuar është një formë tjetër e pjesëmarrjes së të rinjve në demokraci. Në këtë aspekt, Kosova paraqet një model paksa të ndryshëm nga vendet e tjera të tranzicionit. Pjesëmarrja e të rinjve në votime është më e lartë dhe për zgjedhjet e ardhshme shprehet një interes edhe më i madh për të marrë pjesë.

Rritja e përgjegjësisë qytetare të të rinjve kërkon marrjen e disa masave, duke filluar nga shkolla, për nxitjen e kulturës së pjesëmarrjes. Plotësimi i kuadrit ligjor për përcaktimin e instrumenteve me anën e të cilave mund të ushtrohet pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje do të ndihmonte institucionet për të organizuar procese reale dhe të frytshme dialogu me të rinjtë. Përfshirja gjerësisht e të rinjve në monitorimin e zbatimit të politikave, që kanë lidhje me to, do të ndihmonte, gjithashtu, institucionet për të orientuar punën e tyre drejt rezultateve të dobishme për rininë.

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOTJPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PREMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

Një Kosove e re, për një gjenerate te re!

Prishtina nuk është ende qyteti me i ndërtuar ne rajon. Por pa dyshim, Prishtina është kryeqyteti më dinamik i Ballkanit. Këtë dinamike, Prishtinës dhe tërë Kosovës ia jep rinia e saj. Mbi 50% e popullatës sonë është nën moshën 25 vjeçare. Është gëzim për ne të kemi një popullatë te tille te re.

Është përgjegjësi e qeverisë që të punojë për tu siguruar këtyre te rinjve perspektivë të qartë zhvillimi dhe një te ardhme më të mirë. Përpara nesh janë dy opsione: ta shohim rininë tonë të frustrohet nga pamundësia për qasje në tregun e shkollimit dhe të punës ose të mobilizojmë te gjitha burimet tona dhe, përmes politikave të guximshme dhe vizionare, të bëjmë më të mirën për ta.

Kjo qeveri ka zgjedhur rrugën e dytë. Kjo qeveri shpalli prioritet të sajin vitin e kaluar atë që gjerësisht njihet "Platforma e 3E-ve", me edukimin si komponente esenciale. Angazhimi i qeverisë është reflektuar edhe në buxhetin për vitin 2007, ku kuota për arsimin është rritur për 7 milionë euro.

Qeveria ka bërë gjithashtu një hap të rëndësishëm me hartimin e dy strategjive afatmesme: *Planin Kosovar të Veprimit për Rini 2007-2010* dhe *Planit Aksional të Punësimit të të Rinjve 2007-2010*. Punësimi i te rinjve, promovimi dhe fuqizimi i OJQ-ve rinore, edukimi joformal, pjesëmarrja dhe integrimi i rinise, edukimi dhe parandalimi shëndetësor janë disa nga sferat e aktivitetit tone.

Megjithatë, shumë probleme mbeten ende të pazgjidhura. Papunësia e lartë është një ndër brengat kryesore. Dokumenti gjithpërfshirës që na ofron kësaj here UNDP-ja është një studim i mirëseardhur të cilin do ta konsultojmë me qëllim përmirësimin e politikave qeveritare duam një Kosove të re, për një brez të ri!

Agim Çeku
Kryeministër i Kosovës

Kapitulli 1

Sfida e Tranzicionit

1 Sfida e Tranzicionit

Kosova, vendi me popullsinë më të re në Evropë, është duke u përballur me sfidën e një tranzicioni të vështirë politik, ekonomik e social. Kjo është, para së gjithash, sfida e të rinjve, që sot me kurajo bëjnë përpjekje të kapërcejnë tranzicionin e tyre të moshës dhe që nesër do të jenë punëtorët, biznesmenët, prindërit, qytetarët dhe udhëheqësit e Kosovës. Të investosh sot tek rinia do të thotë të mendosh për të nesërmën e secilit, të nxitësh përparimin ekonomik e social të vendit dhe të përshpejtosh zbutjen e varfërisë në Kosovë.

1.1 Rinia, tranzicion i dyfishtë

Tranzicioni i moshës

Rinia është periudha e kalimit nga fëmijëria në pjekuri nëpërmjet një procesi ndryshimesh intensive fiziologjike, psikologjike, sociale dhe ekonomike, për ta njohur vetveten dhe për t'u njohur nga të tjerët si i rritur. Nga pikëpamja shëndetësore, rinia lidhet me moshën e pjekurisë fizike, më tipike në moshën midis 10 dhe 16 vjeç. Nga pikëpamja sociale, rinia karakterizohet nga fitimi i disa cilësive të të riturve të tilla si mbarimi i shkollës, punësimi, martesa etj., që zakonisht hasen pas të njëzetave. Në këtë moshë njeriu krijon identitetin e tij si individ, fillon të pranohet dhe dëgjohet jashtë familjes së tij dhe të ndërveprojë edhe me komunitetin e gjerë. Prandaj rinia është më shumë një stad i jetës se sa i moshës, që njihet edhe si periudhë e energjisë së madhe, entuziazmit dhe krijimtarisë së njeriut.

Deri rreth moshës 15 vjeçare të rinjtë janë të fokusuar kryesisht tek mësimi për të marrë shkollimin bazë. Në këtë moshë ata janë nën kujdesin, përgjegjësinë dhe drejtimin e plotë të prindërve të tyre, të cilët përpiqen t'i zgjidhin gjithçka ndërsa ata vetëm duhet të jenë nxënës të mirë dhe fëmijë të edukuar. Shkollimi vazhdon deri rreth moshës 18 - 20 vjeç, por në këtë periudhë vemendja fillon të zhvendoset gradualisht nga mësimi tek puna, e cila fillon e merr gjithnjë e më shumë rëndësi. Pas përfundimit të arsimit bazë fillon mosha e marrjes së vendimeve për të ndjekur shkollën e mesme e të lartë, hyrjen në tregun e punës, krijimin e familjes. Në këtë periudhë të rinjtë fillojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre të qytetarisë përmes pjesëmarrjes në votime. Në moshën 20 - 24 vjeç tek të rinjtë fillon të dominojë puna dhe familja.

Rinia e Kosovës e përballon tranzicionin e vet në kushtet e tranzicionit ekonomik e social të Kosovës. Si një tranzicion i dyfishtë, ai është i lidhur ngushtë me vështirësitë që kalon Kosova dhe i kushton rinisë më shumë energji. Por, njëkohësisht, kjo i krijon më shumë mundësi rinisë për të luajtur një rol më të madh dhe për të ndikuar në të ardhmen e Kosovës

Mosha e rinisë

Në shumë vende mosha e rinisë përcaktohet me ligj sepse lidhet me cakun se kur njeriu duhet konsideruar vetë përgjegjës për veprimet e tij, me moshën e fillimit të punës apo me grupmoshën që mund të përfitojë nga politikat mbështetëse insitucionale për rininë. Prandaj, në vende të ndryshme ka përcaktime të ndryshme për moshën e rinisë.

Kufiri i poshtëm i moshës së rinisë zakonisht është midis 12-18 vjeç, kurse kufiri i sipërm është midis 24 – 30 vjeç. Programi i Kombeve të Bashkuara për Rininë përcakton si të rinj njerëzit e moshës 15-24 vjeç. Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF konsiderojnë si të rinj ata të moshës 10-24 vjeç sepse shumë politika që ndikojnë tek të rinjtë, shpesh herë është e nevojshme të ndërmerren duke filluar nga mosha 10 vjeç.

Kutiza 1.1	***Përbërësit e tranzicionit të moshës***

Shkollimi, punësimi, shëndeti, aftesimi i familjes dhe të ushtruarit e qytetarisë janë përbërësit kryesorë të tranzicionit të moshës së rinisë. Koha kur shfaqet secili prej tyre dhe vështirësia për ta përballur me sukses varet shumë nga niveli i zhvillimit ekonomik e social i atij vendit ku rinia jeton. Vendimet që merren gjatë kësaj përballje janë vendimtare jo vetëm për vetë rininë por ato ndikojnë mjaft edhe në të ardhmen e atij vendi. Megjithëse në dukje të gjitha këto janë vendime personale apo deri diku familjare, menaxhimi i këtij tranzicioni lidhet ngushtë me familjen, shtetin dhe shoqërinë, si dhe me mjedisin e mundësitë që ato i ofrojnë të rinjve për të marrë vetë vendime të drejta.

Tabela 1.1: Grupmosha e rinisë në vendet e EJL[2]

	Grupmosha
Bosnja dhe Herzegovina	14-30
Bullgaria	15-25
IRJ Maqedonisë	15-24
Kosova	15-24
Kroacia	15-29
Mali i Zi	15-24
Moldavia	16-30
Rumania	14-29
Serbia	15-24
Shqipëria	15-25

Në (Tabelen 1.1) jepet grumpmosha e rinisë sipas përcaktimeve ekzistuese në vendet e Europës Jug-Lindore. Në Kosovë, megjithëse ende nuk është përcaktuar ligjërisht, të rinj konsiderohen ata që bëjnë pjesë në grupmoshën 15-24 vjeç[3].

Të rinjtë përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të popullsisë së Kosovës. Popullsia e përgjithshme vlerësohet të jetë ndërmjet 1.9 dhe 2.1 milion banorë, të cilët janë me banim në Kosovë[4]. Shqiptarët përfaqësojnë rreth 88% të popullsisë rezidente, serbët rreth 7% dhe grupet e tjera etnike, ku bëjnë pjesë boshnjakët, komuniteti RAE (Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët) dhe turqit, rreth 5%[5]. Popullsia nën moshën 25 vjeç përfaqëson mbi 50% të popullsisë së gjithëmbarshme të Kosovës. Sipas përcaktimit të mësipërm, të rinjtë e grupmoshës 14-24 vjeç zënë rreth 21% të popullsisë së saj, dhe këto të dhëna në Kosovë janë vetëm për grup moshën 14-24 vjeq. Me këtë tregues, Kosova është një nga vendet me popullsinë më të re në Europë.

Roli vendimtar i familjes

Të rinjtë e Kosovës janë tradicionalisht shumë të lidhur me familjet e tyre dhe këtu përfshihen edhe të rinjtë në moshën e të drejtës për punë. Rrjedhimisht, shumë karakteristika të moshës së rinisë dhe, në mënyrë të veçantë vendimmarrja, si më e rëndësishmja për aftësimin psikologjik e social të tyre, lidhen ngushtë me profilin shoqëror të familjes. Kur të rinjtë janë adoleshentë, vendimet më të rëndësishme për ta i marrin prindërit apo më të rriturit e familjes. Kur ata rriten, vendimmarrja kalon gradualisht nga prindërit dhe familja tek ata vetë. Shpejtësia e këtij kalimi varet shumë nga familja dhe vetë i riu, por po kaq shumë edhe nga niveli i zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Kështu, për vajzat ka raste që ky tranzicion karakterizohet prej kalimit të vendimmarrjes nga prindërit tek burri.

Figura 1.1: Vendimmarrja në familje



Kush i merr vendimet më të rëndësishme në familjen tuaj?

Ekonomitë familjare[6] të Kosovës janë tradicionalisht të mëdha dhe nganjëherë përbëhen nga më shumë se një familje. Rreth 59% e familjeve gjithsej kanë së paku 6 anëtarë. Më të mëdha janë familjet në zonën rurale, ku madhësia mesatare e tyre vlerësohet të jetë 6.4 anëtarë, ndërkohë që rreth 40% e familjeve kanë 7 ose më shumë anëtarë. Në qytet familjet janë me më pak anëtarë dhe vetëm rreth 27% e familjeve kanë më shumë se 6 anëtarë. Ekonomitë familjare me një familje të vetme (nukleus familje) zënë rreth 70% të familjeve gjithsej. Pjesa tjetër përbëhet nga 2 a më shumë familje te ngushta[7].

Familja drejtohet nga kryefamiljari, i cili është mashkull në pothuaj 93% të familjeve, si në fshat ashtu edhe në qytet. Familjet që drejtohen nga femrat përbëjnë kryesisht rastet kur kryefamiljari nuk jeton më dhe gruaja është e ve. Babai është ai që në më të shumtën e rasteve merr edhe vendimet më të rëndësishme të familjes (shih Figurën 1.1)[8].

Figura 1.2: Marrëdhëniet me prindërit



A keni pasur ndonjëherë mosmarrëveshje me prindërit?

Edhe pse jetojnë në familje me shumë pjesëtarë, përgjithësisht të rinjtë nuk kanë probleme me prindërit. Rreth 81% e të rinjve të intervistuar shprehen se nuk kanë pasur ndonjëherë probleme me prindërit (shih Figurën 1.2)[9]. Përkundrazi, ata mendojnë se jetesa brenda familjes është më shumë lehtësi se sa problem dhe e vlerësojnë sakrificën që bën familja për ta. Prandaj, përgjithësisht të rinjtë kanë dëshirë që, kur të fillojnë punë, të kontribuojnë për

familjen dhe aspirojnë t'ia shpërblejnë familjes mundin e saj, duke ndihmuar prindërit, vëllezërit dhe motrat. Nga ana tjetër, ata mendojnë se, duke qënë më të shkolluar se brezi i mëparshëm, jetesa e tyre brenda familjes ndikon pozitivisht në rritjen e nivelit të pjesëtarëve të tjerë më pak të shkolluar të familjes dhe ky ndikim është më i dukshëm në familjet fshatare[10].

Figura 1.3: Varësia financiare nga familja



Por, megjithatë, të rinjtë shprehin një shqetësim të madh, i cili ka lidhje me faktin se papunësia në Kosovë është aq e madhe dhe të ardhurat e familjes aq të pakta, sa që një personi, kur punësohet, i bie menjëherë barra të mbajë të gjithë familjen dhe, në këtë rast, ai mbetet peng i familjes së bashku me aspiratat e tij për të ardhmen[11].

Roli kaq i madh i familjes lidhet ngushtë me varësinë ekonomike të të rinjve nga familja. Më shumë se gjysma e të rinjve deklarojnë se janë tërësisht të varur financiarisht nga prindërit dhe vetëm 14.9% e tyre thonë se nuk varen aspak nga familja (shih Figurën 1.3). Varësia financiare nga familja është e dukshme pavarësisht përkatësisë etnike të të rinjve[12].

Shkëputja nga familja nuk është një vendim i lehtë për t'u marrë nga të rinjtë. *Nga njëra anë*, në mendësinë e familjes tradicionale të Kosovës, prindërit ndjehen përgjegjës për gjithçka që lidhet me fëmijët e tyre, pavarësisht moshës së të rinjve. Ata e kuptojnë pa mëdyshje si detyrë marrjen e çdo lloj vendimi që ka të bëjë me jetën e fëmijëve të tyre. Në mënyrë të veçantë kjo lidhet me vajzat, për të cilat, sipas kësaj mendësie, duan kujdes shumë më të madh. Prandaj edhe largimi nga familja për të jetuar vetëm, nuk pranohet me lehtësi nga prindërit, sidomos kur bëhet fjalë për vajzat. Megjithatë, familjet qytetare janë më toleruese në këtë aspekt, krahasuar me familjet në fshat. *Nga ana tjetër*, edhe kur prindërit e tolerojnë largimin e të rinjve nga familja, kjo nuk ka mundësi praktike të realizohet, sepse shumica e familjeve nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për t'i mbështetur ata financiarisht ose kanë nevojë për punën dhe kontributin financiar të tyre.

Kutiza 1.2 ***Pavarësia ekonomike***

"…Duke jetuar së bashku me familjen, shpesh herë ne jemi të privuar të marrim vetë vendimet më të rëndësishme të jetës sonë. Prandaj unë kam preferuar të jetoj vetëm dhe ndjehem e pavarur. Kjo nuk do të thotë aspak se unë nuk i respektoj prindërit. Përkundrazi, kam marrëdhënie mjaft të mira dhe shpesh konsultohem me ata për problemet që kam. Ata kanë filluar të kuptojnë se kjo pavarësi nuk ka asgjë të keqe dhe më përkrahin. Kam shumë shoqe që do të donin të jetonin të pavarura si unë por nuk munden sepse janë tërësisht të varura ekonomikisht nga prindërit…" – *Nga tryeza e debatit me të rinjtë në Mitrovicë, 30 nëntor 2006.*

Jetesa e të rinjve të ndarë nga familja nuk haset shpesh dhe lidhet më shumë me rastet kur familjet kanë një gjendje ekonomike të kënaqëshme dhe të rinjtë janë të punësuar. Megjithatë, dëshira për të marrë një vendim të tillë haset gjithnjë e më shpesh tek të rinjtë. Duke i kuptuar vështirësitë e mësipërme, me të cilat lidhet marrja e një vendimi të tillë, të rinjtë shprehen se mungesa e pavarësisë ekonomike është ajo që i pengon më shumë se sa mendësia e prindërve. Pyetjes se kur mendon të shkëputesh nga familja e prindërve, rreth 74% e të rinjve i përgjigjen se do të ndahen nga prindërit kur të gjejnë punë dhe të jenë financiarisht të pavarur, ndërkohë që vetëm 29% e tyre e lidhin ndarjen nga prindërit me krijimin e familjes së tyre (shih Figurën 1.4)[13].

Figura 1.4: Kur mendon të shkëputesh nga familja e prindërve?



Duke jetuar së bashku me prindërit, ndikimi i tyre tek të rinjtë është i madh edhe për vendime të tilla të rëndësishme siç është martesa. Madje, përgjithësisht, të rinjtë e konsiderojnë se është normale që ata të mos marrin një vendim të tillë pa u konsultuar me prindërit. Por, varësia e marrjes së vendimit për të krijuar familjen ka raste që kalon kufijtë e konsultimit. Kështu, rreth 20% e të rinjve shprehen se janë prindërit ata që vendosin për martesën e pjesëtarëve të familjes së tyre (shih Figurën 1.5)[14].

Nëse vendimin e marrim vetë, ku të shkojmë, nuk kemi as të ardhura e as shtëpi, ku të banojmë![15].

Marrja e një vendimi të tillë nga prindërit, veçanërisht në familjet, që banojnë në zonat rurale, jo gjithmonë mbështetet në dëshirën e të rinjve. Madje ka raste kur të rinjtë, sidomos vajzat, i martojnë pa e njohur njëri tjetrin më parë, ose thjesht ngaqë djali është nga një familje në gjendje të mirë ekonomike dhe prindërit mendojnë se kështu i krijojnë kushte të mira vajzës për të jetuar[16].

Figura 1.5: Vendimmarrja për martesë



Kush vendos për martesën e pjesëtarëve të familjes tuaj?

Në Kosovë, vetëm 56.5% e të rinjve shprehen se vendimin për martesë çdo pjesëtar i familjes së tyre e merr sipas dëshirës së tij. Ndërsa këtë vendim e marrin në mirëkuptim me prindërit rreth 23.4% e të rinjve[17]. Këta tregues janë më të ulët po të krahasohen me vende të tjera të rajonit. Kështu, për shembull, në Rumani, rreth 93% e femrave dhe 95% e meshkujve të moshës deri 24 vjeç deklarojnë se janë ata vete, që kanë ndikimin kryesor në vendimmarrjen për martesë[18]

Trafikimi, rreziku më ri i tranzicionit

Vështirësitë e tranzicionit nga shkolla në punë kanë shpesh herë pasoja në jetën dhe mirëqenien e të rinjve dhe këto lidhen, veçanërisht, me papunësinë dhe varfërinë. Të rinjtë janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të integrimit të vonuar në shoqëri, ekonomisë informale, përjashtimit social, diskriminimit gjinor dhe etnik, konflikteve, krimit të organizuar dhe trafikimit.

Pasiguria e ekspozimit ndaj trafiqeve, frika e përdorimit të drogës, euforia e rendjes pas gjerave pa vlerë, duke lënë mënjanë mësimet, përbëjnë sot edhe shqetësimet më të mëdha të prindërve për fëmijët e tyre. Ata konsiderojnë si zgjidhje trysninë ndaj fëmijëve për të kufizuar daljen e tyre nga shtëpia dhe për këtë përpiqen tu krijojnë kushte argëtimi nëpërmjet lojrave elektronike dhe internetit apo veprimtarive kolektive jashtëshkollore[19].

Trafikimi i vajzave është një nga dukuritë negative të përbashkëta të vendeve të Europës Jug-Lindore, që u shfaqën gjatë periudhës së tranzicionit. Rënia ekonomike, varfëria dhe papunësia e madhe thelluan pabarazinë që ekzistonte midis femrave dhe meshkujve. Diskriminimi social dhe ekonomik zgjeroi terrenin për trafikimin e femrave në këto vende. Në Kosovë, veprimtaria e krimit të organizur, që lidhet me trafikimin zhvillohet si në nivelin e grupeve të vogla, që është shumë vështirë të zbulohen për shkak të "kodit të heshtjes" së familjeve tradicionale, ashtu edhe në nivelin e grupeve të organizuara.

Kutiza 1.3	***Trafikimi-Rreziku me i ri i tranzicionit***

"…Kur vajza doli për herë të pare me shoqet dhe shokët e gjimnazit, i caktova si kufi për tu kthyer në orën nëntë të darkës, por ajo erdhi shumë më vonë dhe u mërzita shumë. Po më duket gjithnjë e më e vështirë ta bind mbi rreziqet që mbart dalja në orët e vona të natës. Më tmerrojnë ato që dëgjojmë për trafikimin e vajzave në Kosovë dhe në vendet e tjera përreth. Ky është një shqetësim i madh jo vetëm për mua por edhe për të gjithë prindërit…" – *D. M. prind në Prishtinë.*

Deri më sot nuk ka të dhëna zyrtare mbi trafikimin e femrave nga Kosova, por vetëm mbi femrat e trafikuara në Kosovë. Rreth 98% e këtyre femrave janë nga vendet e Europës Jug-Lindore dhe shumica e tyre hyjnë nga Serbia. Në Beograd dhe qytete të tjera serbe ka rrjete trafikantësh, që i lidhin femrat me "pronarë" nga Kosova. Çmimi për një vajzë të re është midis 750 dhe 2500 Euro. Pronarët i detyrojnë ato tu shërbejnë klientëve kundrejt një pagesë rreth 75 Euro për orë. Ndërkohë, viktimat paguhen shumë pak, rreth 50 Euro në muaj ose thjesht u sigurohet mbijetesa nga pronarët. Shumica e viktimave të trafikuara vijnë nga Moldavia (rreth 50%), Rumania (rreth 20%) dhe Ukraina (rreth 13%) dhe një numër i vogël i tyre janë nga Kosova. Rreth 60% e tyre janë vajza të moshës deri 24 vjeç dhe rekrutimi i shumicës prej tyre bëhet duke u premtuar punë.

Kutiza 1.4	***Rrëfimi i një vajze 26 vjeçare bullgare***

"…Pasi kaluam kufirin Rumun, ai më tha se më kishte blerë nga miku im, që më rregulloi pasaportën, dhe më premtoi se do të më ndihmonte. Unë u shokova por isha e pambrojtur. Që nga ajo kohë kam kaluar dorëpasdore, më kanë shitur e blerë disa herë, kam ndërruar apartamente, shtëpi, hotele gjersa përfundova në një bar në Ferizaj. Më morën pasaportën dhe më detyruan të bëhem prostitutë, nuk më linin të dilja jashtë e të komunikoja me njerëz, ushtronin dhunë dhe më detyronin të mos refuzoja klientët edhe kur isha e sëmurë. Unë dhe vajzat e tjera ishim pronë e tyre...." - *IOM Kosovë, Return and Integration Project-situation report 2000-2005, Prishtinë 2006 (raport i mbështetur në histori të vërteta të 474 viktimave të trafikimit)*

Për të luftuar trafikimin dhe asistuar viktimat e trafikut, ne vitin 2004 eshte pergatitur nje strategji e posaqme nga UNMIK-u. Një Grup Ndërministror, që përfshin zyrën e Kryeministrit dhe pesë Ministri, si dhe një numër i konsiderueshëm organizatash jo qeveritare, janë struktura mjaft aktive në këtë fushë. UNMIK-u ka vendosur, gjithashtu, rregulla strikte për stafin e tij që shkel Kodin e Sjelljes. Karta e Kombeve të Bashkuar përcakton se personeli i saj *"…duhet të sigurojë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes në vendin ku ushtron funksionet e tij, pa abuzuar apo shfrytëzuar individë të popullsisë lokale, veçanërisht femra dhe fëmijë…''.*

Toleranca ndëretnike

Marrëdhëniet sociale të të rinjve të sotëm janë qartazi të ndikuara nga e kaluara e Kosovës dhe konflikti i vitit 1999. Këto kanë lënë gjurmë të thella në tolerancën dhe bashkëpunimin midis të rinjve të komuniteteve të ndryshme etnike.

Figura 1.6: Marrëdhëniet ndëretnike midis të rinjve



Më të ndikuar nga kujtesa historike duket se janë të rinjtë shqiptarë, të cilët, përgjithësisht, shprehen më të kufizuar për miqësinë me të rinjtë e komuniteteve të tjera etnike. Kjo ka lidhje me faktin se familjet shqiptare ishin për një kohë të gjatë viktima të diskriminimit etnik. Ky kufizim është më i dukshëm në lidhje me të rinjtë e komunitetit serb dhe RAE, miqësinë me të cilët e refuzojnë përkatësisht rreth 65% dhe 62% e të rinjve shqiptarë (shih Figurën 1.6) [20]. Por kur pyetja shtrohet për të pranuar ose jo fqinjësinë me të rinjtë e komuniteteve të tjera, vetëm 54.6% dhe 51% e të rinjve shqiptarë nuk do ta donin këtë fqinjësi përkatësisht me të rinjtë e komunitetit serb dhe RAE.

Të rinjtë serbë shprehen më të moderuar mbi të njejtat çështje. Ata janë më të kufizuar ndaj miqësisë me të rinj të komunitetit turk dhe RAE, miqësinë me të cilët e refuzojnë përkatësisht 33% dhe 29% e të rinjve serbë. Ndërkohë që vetëm 25% e tyre refuzojnë të miqësohen me të rinjtë shqiptarë.

Të rinjtë e komuniteteve etnike RAE, turq dhe boshnjakë shprehen se kanë ndërtuar marrëdhënie të mira me fqinjët e shumicës shqiptare dhe mendojnë se është më mirë për ta që të vazhdojnë ta forcojnë këtë miqësi se sa të synojnë për të jetuar në zona të pastra etnike. Integrimi i krijon atyre avantazhe për zhvillimin ekonomik e social, ndërkohë që i vetmi avantazh që kanë duke jetuar të ndarë janë disa financime të donatorëve ndërkombëtarë për veprimtaritë e qendrave rinore[21].

Politikat rinore

Politikat shtetërore në favor të të rinjve zakonisht fokusohen në krijimin e mundësive për të rinjtë për të rritur nivelin e përvetësimit të njohurive bazë dhe për tu punësuar, si dhe në zhvillimin e aftësive të tyre për të marrë vendime të drejta dhe për të luajtur një rol aktiv në shoqëri. Fushat prioritare, që duhet të përfshihen në politikat shtetërore të vendeve evropiane në lidhje me rininë, janë: (i) Arsimi, mësimi gjatë gjithë jetës dhe lëvizshmëria; (ii) Punësimi; (iii) Integrimi social; (iv) Lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë; dhe (v) Autonomia e të rinjve. Çdo politikë, që i trajton këto fusha prioritare, duhet të respektojë dhe të mbështetet në parimin e pjesëmarrjes, përgjegjshmërisë, frutshmërisë dhe koherencës[22].

Figura 1.7: Fondet për politikat rinore



Në Kosovë, politikat rinore të Qeverisë së Kosovës janë përmbledhur në një projekt dokument të hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit[23], i cili është përgartitur me anë të një procesi konsultimesh e pjesëmarrjeje të gjerë të OJQ-ve rinore dhe institucioneve të ndryshme në nivel qendror e lokal. Ky dokument fokusohet

në gjashtë fusha: (i) Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje; (ii) Arsimimi; (iii) Punësimi; (iv) Shëndeti; (v) Siguria njerëzore; dhe (vi) Kultura, sporti e rekreacioni. Për secilën fushë janë parashikuar masa konkrete, si dhe buxheti i nevojshëm për zbatimin e tyre (shih Figurën 1.7). Pjesa më e madhe e fondeve mendohet të shpenzohet për nxitjen e punësimit dhe të pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.

1.2 Kosova, tranzicion pa Status

Përparimi i demokracisë

Kosova hyri në rugën e demokracisë pas ngjarjeve të vitit 1999. Po këtë vit, me anë të Rezolutës 1244, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përcaktoi ngritjen e një administrate të përkohshme ndërkombëtare në Kosovë, të quajtur Misioni i Përkohshëm Administrues i Kombeve të Bashkuara ne Kosovë (UNMIK), dërgimin e një Emisari të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me autoritet vendimmarrës dhe krijimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në nivel qendror dhe lokal. Me kalimin e viteve, përgjegjësitë qeverisëse janë transferuar shkallë shkallë nga UNMIK-u tek institucionet vendase, të cilat janë duke marrë atribute të plota qeverisëse. Transferimi më i ri i përgjegjësive është ai i dhjetorit 2005, që çoi në krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendëshme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Më pas u krijua edhe Këshilli Juridik i Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2003, Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi *Standardet për Kosovën*, të cilat përmbajnë kriteret, që garantojnë konsolidimin dhe përparimin e demokracisë dhe të sundimit të ligjit. Në vijim u hartua edhe *Plani i Zbatimit të Standardeve*[24], i cili përcakton objektiva e detyra të hollësishme për tu përmbushur nga institucionet e Kosovës në disa fusha kryesore:

(i) ***Funksionimi i institucioneve demokratike***, me theks të veçantë tek zgjedhjet, qeverisja qëndrore e lokale, mediat dhe shoqëria civile;
(ii) ***Sundimi i ligjit***, ku përfshihen plotësimi i kuadrit ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zbatimi me korrektësi i ligjeve, duke ngritur një sistem të paanshëm gjyqësor dhe të luftës kundër krimit, që respekton me korrektësi të drejtat e njeriut;
(iii) ***Liria e lëvizjes***, që u garanton të gjithë banorëve të Kosovës në mënyrë të barabartë jetesën, gjuhën, lëvizjen dhe të gjitha llojet e shërbimeve publike, pa qenë të kërcënuar dhe pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike;
(iv) ***Kthimet e qëndrueshme*** dhe të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre, duke garantuar kthimin e sigurtë e me dinjitet të të gjithë refugjatëve dhe të zhvendosurve, që kanë dëshirë të rikthehen në Kosovë;
(v) ***Ekonomia e tregut***, që nënkupton krijimin dhe respektimin me rigorozitet të një kuadri ligjor, që favorizon zhvillimin e biznesit privat, garanton konkurrencën e lirë e të ndershme dhe që mundëson investimet;
(vi) ***Të drejtat pronësore,*** duke garantuar me ligj dhe respektuar të drejtën e pronarëve legjitimë të banesave, bizneseve dhe tokës bujqësore në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet etnike.

Partitë politike, të gjitha institucionet publike dhe shoqëria civile e Kosovës i kanë kthyer këto standarde në objektiva prioritarë të punës së tyre. Zgjedhjet për organet e pushtetit lokal të viteve 2000 e 2002, si dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 ishin hapat e parë të Kosovës drejt demokracisë pluraliste, që, për herë të parë në historinë e Kosovës, i dhanë mundësi kosovarëve të shprehnin lirisht vullnetin e tyre politik. Zgjedhjet e dyta parlamentare u mbajtën në tetor të vitit 2004 dhe u vlerësuan nga vëzhguesit ndërkombëtarë si të lira, të ndershme dhe demokratike, edhe pse u bojkotuan nga shumica e qytetarëve serbë të Kosovë.

Partitë politike, ndonëse pa përvojën e duhur, kanë luajtur një rol gjithnjë e më të madh në udhëheqjen e vendit në rrugën e tranzicionit të vështirë e mjaft kompleks politik, ekonomik e social.

Kutiza 1.5 ***Përparimi i demokracisë***

"…Gjatë vitit të fundit, të gjithë pjesëtarët e spektrit politik të Kosovës kanë demonstruar vullnet e gatishmëri për një dialog konstruktiv dhe për të shmangur tensionet. Zgjedhja e presidentit të ri u arrit në rrugë demokratike e transparente. Funksionimi i Kuvendit të Kosovës është përmirësuar, megjithëse Komisionet e Kuvendit jo gjithmonë janë në gjendje të përmbushin rolin e tyre në proçesin legjislativ. Koalicioni qeverisës riafirmoi vendosmërinë për të përshpejtuar zbatimin e standardeve dhe për të krijuar marrëdhënie më konstruktive me serbët e Kosovës. Progresi i zbatimit të masave kundër korrupsionit ka qenë i ngadaltë dhe korrupsioni vazhdon të ketë përhapje të gjerë e në të gjitha nivelet. Serbët e Kosovës kanë vazhduar të refuzojnë të marrin pjesë në institucionet e përkohshme. Tetë nga dhjetë vendet e rezervuara në Kuvend për ta vazhdojnë të mbeten bosh në sesionet plenare. Edhe posti i ministrit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural i rezervuar për një ministër serb të Kosovës, vazhdon të jetë i pazënë. Strukturat paralele administrative, të sponsorizuara nga Beogradi, vazhdojnë të funksionojnë në shumicën e Komunave të dominuara nga serbët...„ – *nxjerrë nga CEC, Kosovo 2006 Progress Report, 8.11.2006.*

Gjatë viteve të fundit, është shënuar një përparim i dukshëm në respektimin e të drejtave të njeriut, lirisë dhe besimit fetar për të gjitha komunitetet fetare dhe lirisë së fjalës. Të drejtat e minoriteteve kanë qënë në një fokus të veçantë. Një ligj i posaçëm kundër diskriminimit është miratuar nga Kuvendi dhe, në zbatim të tij, është hartuar një plan veprimi i detajuar për periudhën 2005-2007, i cili po zbatohet me këmbëngulje nga të gjitha institucionet. Janë bërë përparime, gjithashtu, në plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional të ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e tregut privat.

Përparimi i demokracisë dhe vullneti i institucioneve të Kosovës vlerësohet si mjaft pozitiv nga institucionet ndërkombëtare dhe, megjithë mendimin e përgjithshëm të tyre se për plotësimin e standardeve mbetet ende shumë për tu bërë, në tetor 2005, Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi hapjen e bisedimeve për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Raundi i parë i tyre u mbajt më 21-22 shkurt 2006 në Vjenë, ku u takuan për herë të parë pas konfliktit të vitit 1999 përfaqësues të nivelit të lartë të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës dhe të Serbisë, në prani të përfaqësuesit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Megjithëse u vërejt njëfarë progresi, në këto bisedime dhe në raundet vijuese të tyre pozicionet e palëve mbetën të paafrueshme. Edhe pse ishte premtuar publikisht nga aktorët relevantë ndërkombëtar se zgjidhja e statusit do të bëhet gjatë vitit 2006, vendet e Grupit të Kontaktit, i dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin Marti Ahtisari dhe vetë Këshilli i Sigurimit i OKB-së u pajtuan të shtyjnë vendimin për statusin deri në përfundimin e zgjedhjeve në Serbi, që ishin paraparë për më 21 janar 2007. Një vendim përfundimtar mbi statusin është shpallur se mund të merret gjatë vitit 2007.

Qëndrueshmëri e brishtë ekonomike

Reformat e tranzicionit në Kosovë filluan pas vitit 1999 mbi një bazë mjaft të ulët ekonomike, të degraduar veçanërisht gjatë viteve '90-të. Në vitin 1988, prodhimi i përgjithshëm i Kosovës dominohej nga industria, e cila zinte rreth 50% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa bujqësia zinte vetëm rreth 20%. PBB për frymë e Kosovës ishte sa 28% e mesatares së Jugosllavisë dhe të ardhurat për frymë sa 67%, 44% dhe 74% të mesatares për frymë përkatësisht të Jugosllavisë, Sllovenisë dhe Serbise. Në vitin 1995 të ardhurat për frymë në Kosovë ranë deri në 400 USD[25].

Zhvillimi ekonomik gjatë periudhës 2000-2006 karakterizohet nga një rritje e vogël ekonomike në krahasim me bazën mjaft të ulët të fillimit të tranzicionit, si dhe nga tregues makroekonomikë përgjithësisht të paqëndrueshëm (shih Tabelën 1.2 dhe Figurën 1.8). Por saktësia e këtij përcaktimi është mjaft e diskutueshme sepse mungojnë të dhënat e sakta, që shërbejnë si bazë për llogaritjet, dhe metodikat kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme, gjë që lidhet veçanërisht me qasjet e ndryshme mbi ndikimin e pranisë së një numri të madh ekspertësh të huaj në lidhje me pagat e punonjësve lokalë, qiratë e shtëpive dhe shërbimet. Ndryshimet që rrjedhin nga këto llogaritje janë të konsiderueshme (shih Tabelën 1.3).

Rritja e menjëhershme e PBB deri në vitin 2002 është ndikuar mjaft nga shuma e madhe e kontributit të donatorëve ndërkombëtare, e cila arriti deri në rreth 900 milion Euro dhe u përqëndrua në rindërtimin e shtepive dhe të infrastrukturës të dëmtuara nga konflikti i vitit 1999. Më pas, kjo ndihmë është zvogëluar ndjeshëm dhe në vitin 2006 vlerësohet të jetë rreth dy herë më e vogël se në vitin 2002, duke dhënë ndikim të dukshëm në uljen e vlerave të PBB-së.

Figura 1.8: Evolucioni i disa treguesve makroekonomikë



Tabela 1.2: Disa tregues kryesorë makroekonomikë

	Vitet				
	2002	**2003**	**2004**	**2005**	**2006[26]**
Rritja reale e PBB (%)	9.6	8.3	2.1	0.3	3.0
Inflacioni (%)	3.6	1.2	-1.4	-1.4	0.7
Rritja e investimeve (%)	-9	-7	25.1	-26.0	29.4
Rritja e eksportit (%)	2.2	0.1	-8.7	-11.1	30.3
Rritja e importit (%)	-5.6	-4.5	1.0	9.4	13.3
Mbulimi i importit me eksport (%)	2.3	2.4	7.7	6.5	8.1
Dërgesat (mil Euro)	341.4	341.4	215.0	281.0	318.0
Ndihma nga jashtë (mil Euro)	897.5	698.7	565.0	491.0	465.0

Burimi: Për datat 2001-2003 IMF, Aide Memoire, May 2006
Për datat 2004-2006 IMF, Aide Memoire, February 2007

Tabela 1.3: Vlerat e llogaritura të PBB dhe PBB për frymë

Burimi	Vlerat sipas viteve (PBB në milion Euro dhe PBB për frymë në Euro)													
	2000		2001		2002		2003		2004		2005		2006	
	PBB	/frymë	PBB	/frymë	PBB	/frymë	PBB	/frymë	PBB	/frymë	PBB	/frymë	PBB	/frymë
FMN (2001)	1.291	692												
FMN (2002)	1.560	823	1.946	1.008										
FMN (2004)	1.063	584	1.625	870	1.735	913	1.797	930						
FMN (2006)	1.750	962	2.423	1.297	2.482	1.306	2.496	1.292	2.542	1.294	2.463	1.232		
FMN (2007)									2.282	1.161	2.238	1.120	2.270	1.17

Burimi: World Bank, Public Expenditure and Institutional Review, September 2006.
IMF, Aide Memoire, 19-27 February 2007

Adoptimi i Euro-s si monedhë kombëtare ka favorizuar politika të qëndrueshme monetare dhe të kursit të këmbimit. Inflacioni është ulur ndjeshëm dhe për periudhën afatmesme parashikohet të jetë i stabilizuar në rreth 1.8%.

Deficiti tregtar mbetet në nivele shumë të larta dhe në vitin 2005 arriti në rreth 45% të PBB-së. Eksportet janë të pakta dhe me luhatje të mëdha nga viti në vit, për shkak të kapaciteteve të kufizuara prodhuese për eksport dhe pamundësisë për të përballuar konkurrencën. Gjatë katër viteve të fundit vlerat e eksporteve kanë qënë gjithnjë më pak se ¼ e vlerave të importeve. Privatizimi i ndërmarrjeve me pronësi shoqërore ka qënë i ngadaltë dhe, me gjithë përparimin e viteve të fundit, nuk ka arritur të nxjerrë ende në efiçiencë potencialet ekzistuese prodhuese sepse në përgjithësi kanë munguar investimet e huaja dhe instrumentet e financimit për biznesmenët vendas. Pjesa e sektorit publik në ekonomi vazhdon të jetë shumë e rëndësishme dhe nuk ka rënë nën 48% të PBB-së.

Të ardhurat dhe shpenzimet publike janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, por në vlerë ato mbesin të ulta e të pamjaftueshme për të financuar programet e zhvillimit. Përgatitja për herë të parë në Kosovë e Kuadrit Afatmesëm të Shpenzimeve publike për periudhën tre vjeçare 2006-2008 shënoi një hap të rëndësishëm për programimin dhe kontrollin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore[27]. Sipas këtij dokumenti, të ardhurat janë rritur rreth dy herë gjatë periudhës 2000-2003, duke arritur në rreth 600 milion Euro, të ndikuara nga financimet e donatorëve ndërkombëtarë. Më pas rritja është më e ngadaltë dhe parashikimi i realizimit të të ardhurave për vitin 2006 është rreth 625 milion Euro.Te ardhurat a bugjetit kryesisht mblidhen në kufi si VAT (vlerë e shtuar e tatimit), si dhe me heçjen dhe shërbimet e taksës së doganës, deri sa mbledhja e taksës në Kosovë vazhdon të jetë e limituar.Të ardhurat e pushtetit lokal janë edhe më të ulëta, duke bërë që komunat të jenë tërësisht të varura nga buxheti qendror. Shpenzimet janë rritur më shpejt se të ardhurat dhe kjo lidhet me zgjerimin e institucioneve të vetëqeverisjes për shkak të transferimit të përgjegjësive nga UNMIK dhe rritjes së investimeve publike. Në vitin 2006 parashikohet që shpenzimet publike të jenë rreth 700 milion Euro.

Të gjitha këto të dhëna dëshmojnë se, megjithë tendencat pozitive, gjatë viteve të para të tranzicionit në Kosovë nuk është arritur një përmirësim i dukshëm i treguesve makroekonomikë e fiskalë, që të garantojë rritje të qëndrueshme ekonomike në vitet e ardhshme dhe një qëndrueshmëri fiskale të mbrojtur përballë rreziqeve afatmesme. Ekonomia e tregut është në faza fillestare të përparimit të saj dhe është kryesisht ekonomi e konsumit me zhvillim të shpejtë të sektorit të shërbimeve dhe prapambetje të dukshme të sektorit prodhues. Edhe vlerat më optimiste të të ardhurave dhe shpenzimeve publike deri në viti 2010 nuk janë në nivele që t'i përgjigjen siç duhet kërkesave të mëdha për ndryshime rrënjësore në Kosovë.

Kutiza 1.6 ***Parashikimi i zhvillimit makroekonomik***

Ekspertët kanë studjuar dy skenare të zhvillimit makroekonomik deri në vitin 2010 të mbështetura në hipoteza të ndryshme mbi qëndrueshmërinë politike dhe shkallën e zbatimit të programit të reformës ekonomike. Sipas skenarit të zhvillimit normal, rritja e PBB-së reale në vitin 2010 do të arrijë në 3.5%, të ardhurat në rreth 707 milion Euro dhe shpenzimet në rreth 775 milion Euro. Sipas një skenari të zhvillimit të shpejtë, rritja mund të arrijë në 5.2% dhe të ardhurat e shpenzimet përkatësisht në rreth 877 dhe 933 milion Euro. - *World Bank, Public Expenditure and Institutional Review, September 2006.*

Roli i dërgesave të emigrantëve

Emigrimi ka qënë në dekada nje tipar dallues i shoqërisë kosovare. Përgjatë shekullit të 20të shumë familje mbijetuan në sajë të parave të dërguara nga emigrantët e punësuar në vende të tjera. Diaspora Kosovare ka provuar shumë herë, gjithashtu, fuqinë e saj financuese në momente të vështira për Kosovën, veçanërisht gjatë viteve '90.

Emigrimi është edhe një tendencë e sotme, i ndikuar nga niveli i varfërisë dhe papunësia e lartë. Ai dëshirohet më shumë nga të rinjtë, dhe nga anketimet rezulton se këtë tendencë e kanë rreth 50% e tyre, pa ndonjë dallim të dukshëm për shkak të etnisë[28]. Arsyet ekonomike dhe mundësia për të siguruar një jetë më të mirë dallohen si arsyet më kryesore, që i shtyjnë të rinjtë për të emigruar (shih Figurën 1.9).

Figura 1.9: Arsyet e emigrimit të të rinjve



Zhvillimet politike dhe ekonomike të viteve të fundit jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet Europiane pranuese të emigrantëve Kosovarë, kanë ndikuar ndjeshëm si në madhësinë e emigracionit ashtu dhe në shumën e dërgesave. Megjithëse të dhënat e sakta mungojnë, nga institucione të ndryshme ndërkombëtare janë bërë përpjekje për të vlerësuar me metoda të përafërta shumën e dërgesave për Kosovën. Shifrat kanë qenë të ndryshme, por duke iu referuar FMN-së, vlerësohet se dërgesat në Kosovë në vitin 2006 kanë arritur ne rreth 318 milion Euro[29]

Në vendet në tranzicion, dërgesat konsiderohen të rëndësishme jo vetëm për të siguruar mbijetesën e familjeve, por edhe si një burim financimi investimesh në biznes. Në disa vende vlera e dërgesave është shumë më e madhe se vlera e Investimeve të Huaja Direkte apo e huave dhe granteve zyrtare.

Figura 1.10: Vendet në tranzicion me dërgesat më të larta



Burimi: *IMF, Vjetari i Bilancit të Pagesave, 2002*[30]

Kosova renditet e pesta ndër 10 vendet në tranzicion, që në vitin 2001 kishin nivelin më të lartë të dërgesave në përqindje të PBB-së (shih Figurën 1.10). Sot, dërgesat konsiderohen se janë pothuajse në nivelin e ndihmës së donatorëve ndërkombëtarë (shih Tabelën 1.2). Si të tilla, ato supozohet se luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e vështirësive të tranzicionit të Kosovës, duke u përdorur për rigjallërimin e frymës së ndërmarrësisë private, veçanërisht të bizneseve të vogla dhe balancuar deri diku

Kutiza 1.7 ***Paqartësia mbi dërgesat***

Megjithëse dërgesat e emigrantëve vlerësohen nga shumë studime të institucioneve ndërkombëtare si mjaft të rëndësishme për ekonominë e brishtë të Kosovës, të dhënat mbi dërgesat janë aq kontradiktore sa e lëkundin rëndë besimin mbi rolin real të tyre. FMN i vlerëson dërgesat e vitit 2001 rreth 610 milion Euro dhe ato të vitit 2003 rreth 720 milion Euro. Raporti vjetor i Autoritetit Bankar dhe Pagesave të Kosovës i vlerëson dërgesat e vitit 2003 rreth 568 milion Euro. Banka Botërore në Memorandumin Ekonomik të vitit 2004 i vlerëson dërgesat e periudhës 1999 – 2003 rreth 550 milion Euro në vit. Në vitin 2006 FMN i rivlerëson dërgesat nga 317 milion Euro në vitin 2001 deri në 347 milion Euro në vitin 2006. ESK në Anketën e Buxhetit të Familjes të vitit 2004 i vlerëson dërgesat e vitit 2003 rreth 166 milion Euro dhe ato të vitit 2004 rreth 123 milion Euro. Studimi i Varfërisë i Bankës Botërore i vitit 2005 vlerëson se dërgesat nuk zënë më shumë se 15% në strukturën e të ardhurave të ekonomive familjare të Kosovës. - (ESI-Cutting the life line, Migration families and the future of Kosovo, shtator 2006). Kjo paqartësi për një çështje kaq të rëndësishme dhe, sidomos, shifrat e ulta të nxjerra nga deklarimet e drejtpërdrejta të familjeve në dy dokumentet e fundit, hedhin dyshime mjaft shqetësuese mbi saktësinë e vlerësimeve të sotme për ekonominë e Kosovës dhe mbi skenarët afatmesëm të zhvillimit të saj, të cilat nuk duhen nënvlerësuar.

qasjen shumë të ulët të bizneseve në tregun e kreditimit. Edhe pse ka vlerësime se dërgesat në Kosovë kanë pësuar rënie pas vitit 1999, raporti i FMN-së tregon për një ritje të lehtë të dërgesave gjatë dy viteve të fundit[31]. Këto dërgesa kanë filluar të shërbejnë më shumë për të përballuar jetesën e përditshme të familjeve të varfra se sa si një instrument për të nxitur zhvillimin ekonomik. Në favor të këtij argumenti janë: (i) Rritja e numrit të emigrantëve të kthyer vitet e fundit në Kosovë me dëshirë apo për arsye të rregullave më të shtrënguara të vendeve të Europës Perëndimore për emigrimin në përgjithësi dhe atë të kosovarëve në veçanti[32]; (ii) Pakësimi i dërgesave për arsye të stabilizimit të emigrantëve në vendet pritëse së bashku me familjet; (iii) Mendësia e emigrantëve se Kosova tashmë e kaloi gjendjen e emergjencës dhe ka më pak nevojë për ndihma të posaçme; (iv) Numri i kufizuar i familjeve që raportohet se përfitojnë nga dërgesat; dhe (vi) Treguesit ekonomikë të Kosovës pas pakësimit të ndihmës së donatorëve ndërkombëtarë.

Këto kundërshti tregojnë se është koha për një vlerësim serioz e më realist të rolit të dërgesave të emigrantëve për të ardhmen e zhvillimit të Kosovës.

Thellimi i varfërisë

Kosova është vendi më i varfër në Ballkan dhe nga vendet më të varfra në Evropë. Varfëria është e përmasave të mëdha dhe e shtrirë në gjithë Kosovën, dominohet nga varfëria në të ardhura dhe niveli i saj të paktën vazhdon të mbetet në nivelin që kishte në fillimin e tranzicionit. Zbutja e varfërisë mbetet një prej sfidave më të rëndësishme e më të vështira për t'u kapërcyer.

Nga analiza e varfërisë[33] në të ardhura vlerësohet se në vitin 2002 rreth 37% e popullsisë jetonte nën linjën e varfërisë prej 1.42 Euro në ditë për frymë ndërsa 15.2% nën linjën e varfërisë së skajshme prej 0.93 Euro në ditë[34]. Të moshuarit, ekonomitë familiare me kryefamiliar femër, familjet me fëmijë, personat me aftësi të kufizuara dhe të papunët janë grupet më të prekura nga varfëria.

Varfëria e skajshme është e përhapur më shumë tek fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 24 vjeç. Të gjithë së bashku ata zënë rreth 57% të të varfërve të skajshëm gjithsej ndërsa vetëm të rinjtë e grupmoshës 15-24 vjeç zënë 22.4% (shih Figurën 1.11). Rreth 15.8% e të rinjve të grupmoshës 15-24 vjeç, jetojnë në varfëri të skajshme.

Kutiza 1.8 ***Shpërfillja e statistikave***

Sistemi statistikor ka bërë përparime të dukshme në Kosovë. ESK është zhvilluar dhe ka forcuar lidhjet me institucionet e ndryshme brenda vendit dhe ka përfituar nga mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë. Si rezultat, statistika të reja i janë shtuar programit statistikor, disa statistika egzistuese janë përmirësuar dhe një seri botimesh periodike mbulojnë me të dhëna statistikore fusha të ndryshme.

Megjithatë, ndaj statistikave ka një shpërfillje të dukshme. Për të dhëna statistikore thelbësore si popullsia e përgjithshme dhe sipas grupmoshave, Prodhimi i Brendshëm Bruto, rritja ekonomike, kontributi i sektorëve të ndryshëm në të ardhurat e vendit, shkalla e regjistrimit të nxënësve në nivele të ndryshme arsimi, vdekshmëria e foshnjeve, papunësia, madhësia e ndihmës së donatorëve ndërkombëtarë, numri i bizneseve aktive etj. të dhënat mungojnë, përpunohen e publikohen me vonesë ose kanë mospërputhje të mëdha. Shpesh herë, institucionet publike gjejnë si rrugë më të lehtë, më të përshtatshme apo më të sigurtë përdorimin e të dhënave të institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Të dhënat huazohen nga dokumenti në dokument aq sa bëhet e vështirë të identifikohet edhe burimi i saktë. Nga ana tjetër, shumë prej institucioneve ndërkombëtare preferojnë të kenë të dhënat e tyre statistikore ose t'i referohen burimeve të njëri tjetrit. Treguesit makroekonomikë të FMN-së, ato të tregut të punës të OBP-së etj. mund të gjenden në çdo dokument të institucioneve ndërkombëtare dhe atyre të Kosovës, ndërkohë që ESK dhe strukturat përkatëse vendore nuk kanë të dhënat e tyre.

Vakumi i krijuar nga këto mungesa është e keqja më e vogël. Çështja është më serioze per faktin se një numër i madh dokumentesh, që përcaktojnë politikat dhe strategjitë e zhvillimit, jo gjithmonë bazohen në të dhëna të sakta e të përditësuara. Është vështirë, për shembull, të hartosh një strategji të suksesshme punësimi, pa ditur me saktësi forcën aktive punuese, numrin e të papunëve dhe strukturën e tyre në nivel vendi dhe komunash. Po kështu, në arsim nuk mund të parashikohen masa efiçiente për rritjen e pjesëmarrjes në arsim, pa të dhëna statistikore të sakta mbi numrin e nxënësve që frekuentojnë shkollën për çdo grupmoshë dhe për çdo nivel arsimi, gjininë, vendbanimin e tyre etj. Në shëndetësi nuk mund të luftohet vdekshmëria e foshnjeve, po të konsiderosh të njëjtën shifër për 5 vitet e fundit në të gjitha komunat e Kosovës dhe cilat janë shkaqet e vdekshmërisë së lartë në komuna të veçanta.

Pa të dhëna të tilla të plota, në kushtet e ekonomisë së brishtë të Kosovës, është e vështirë të përcaktohen diagnozat e sakta, të jepen këshillat e duhura dhe të përzgjidhen politika efiçiente. Dhe, kur politikat nuk bazohen në të dhëna të sakta, është i pranishëm rreziku që të shpenzohen shumë para dhe kohë deri sa të gjendet rruga e duhur, që për një vend të vogël si Kosova janë mjaft të çmueshme.

Figura 1.11: Varfëria e skajshme sipas grup-moshave[35]



Shqiptarët përbëjnë shumicën e të varfërve të skajshëm, duke zënë gjithsej 86.1% të numrit të tyre gjithsej, serbët 5.8% dhe komunitetet e tjera etnike 8%. Por, në varfëri të skajshme jetojnë 14.6% e shqiptarëve dhe 13.9% e serbëve, ndërkohë që grupet e tjera etnike e kanë treguesin e varfërisë së skajshme 31%, apo mbi dy herë më të lartë se serbet dhe shqiptaret, që do të thotë se në këto komunitete afërsisht në çdo tre banorë njëri jeton në varfëri të skajshme.

Varfëria e skajshme është e përhapur në gjithë Kosovën. Shkallën më të lartë e ka rajoni i Ferizajt, ku rreth 29% e popullsisë jetojnë me më pak se 0.93 Euro në ditë dhe pas tij vijnë Mitrovica dhe Peja, ku ky tregues është përkatësisht 24.2% dhe 22.6%. Në çdo 4 njerëz që jetojnë në varfëri të skajshme në Kosovë, një banon në Mitrovicë.

Megjithëse rreth 70% të të varfërve të skajshëm jetojnë në fshat, shkalla e varfërisë së skajshme është më e lartë në zonat urbane, duke përjashtuar Prishtinën. Arsyeja lidhet me papunësinë e lartë, që konsiderohet edhe shkaku kryesor i varfërisë urbane në Kosovë. Në fshat, varfëria lidhet me faktin se ekonomitë familjare mbijetojnë me prodhimet bujqësore e blegtorale, të cilat, për arsye të sasisë mjaft të pakët dhe cilësisë jo konkurruese, më së shumti shërbejnë vetëm për konsum familjar dhe jo për treg. Ky dallim del i qartë nga analiza e strukturës së të ardhurave të ekonomive familjare të zonës urbane të Kosovës.

Në përgjithësi, të ardhurat nga puna janë burimi kryesor i të ardhurave për të gjithë popullsinë e Kosovës. Ato përfaqësojnë rreth 60% të të ardhurave te gjithëmbarshme të ekonomive familjare, ndërkohë që të ardhurat nga dërgesat e emigrantëve zënë vetëm 15.2%. Në qytete, të ardhurat nga puna përfaqësojnë rreth 66.5% të të ardhurave të gjithëmbarshme të ekonomive familjare dhe të ardhurat nga dërgesat e emigrantëve zënë vetëm 11.4% (shih Figurën 1.12)[36]. Kjo tregon se zonat urbane, dhe veçanërisht qytete të tilla si Mitrovica e Peja kanë shkallën më të lartë të varfërisë së skajshme sepse mundësitë e punësimit i kanë mjaft të pakta.

Figura 1.12: Struktura e të ardhurave në zonën urbane



Rrjedhimisht, zbutja e varfërisë dhe veçanërisht e varfërisë së skajshme lidhet ngushtë me ecurine e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe shumë pak me dërgesat e emigrantëve nga jashtë. Baza e zhvillimit është puna e kosovarëve që banojnë në Kosovë dhe përpjekjet e tyre për të gjallëruar ekonominë e për të vënë në efiçiencë burimet e konsiderueshme që zotëron vendi.

Domosdoshmëria e Statusit

Statusi është kryefjala e çdo bisede në Kosovë. Sipas një anketimi të opinionit publik[37], që përfshin shqiptarët dhe serbët e Kosovës, arritja e një marrëveshjeje të përhershme për statusin e ardhshëm të Kosovës brenda vitit 2006 konsiderohet si një çështje me rëndësi të madhe dhe shumë të madhe për rreth 98% të shqiptarëve të Kosovës dhe rreth 86% të serbëve me banim në Kosovë ose të zhvendosur nga Kosova. Për të njejtat grupe, çështjet më të rëndësishme për t'u zgjidhur në Kosovë janë Statusi, zhvillimi ekonomik e papunësia. Mbi 90% e shqiptarëve mendojnë se është thelbësore që Kosova të jetë shtet i pavarur me kufijtë e tanishëm. Ndërsa rreth 80% e serbëve të Kosovës konsiderojnë se për ta thelbësore është mbetja e Kosovës si krahinë me autonomi të gjerë brenda Serbisë.

Por domosdoshmëria e Statusit e tejkalon dukshëm çdo aspiratë patriotike të shqiptarëve të Kosovës dhe çdo debat politik që bëhet rreth tij. Ndërsa në mendësinë e të rriturve dominon dëshira e të qënit shtet i pavarur, si një shenjë e qartë e ndarjes përfundimtare me të kaluarën e trishtë, që kulmoi me një spastrim etnik tronditës për të gjithë botën e qytetëruar. Tek të rinjtë, statusi shihet edhe si një instrument integrimi, pa të cilin tranzicioni do të jetë mjaft i vështirë, i tejzgjatur dhe me kosto shumë më të lartë. Të rinjtë Statusin e lidhin me shumë me të ardhmen se sa me të shkuarën. Ata mendojnë se zgjidhja e Statusit

do të ketë ndikim në progresin ekonomik, do të krijojë mundësine për përfitimin e investimeve private si dhe qasjen në organizatat ndërkombëtare, dhe në përgjithësi do të ndikojë për mirë në përmirësimin e gjendjes të shumicës së popullsisë[38].

Mungesa e një Statusi të qartë e përfundimtar për Kosovën paraqet njëren ndër pengesat për zhvillimin e saj në përgjithësi dhe për kapërcimin e periudhës së tranzicionit në veçanti. Pa Status nuk mund të ketë investime të huaja, shumë sektorë nuk përfitojnë sa duhet nga bashkëpunimi ndërkombëtar dhe nuk mund të ketë kreditim të biznesit. Ekonomia mbetet e mbërthyer në ngërçin e mungesës së financimit, të investimeve të pamjaftueshme, të mosshfrytëzimit të burimeve potenciale, të papunësisë tepër të lartë dhe të pamundësisë për të zbutur varfërinë.

Kutiza 1.9 ***Ngërçi i financimeve***

"…Derisa të zgjidhet çështja e statusit përfundimtar të Kosovës, Investimet e Huaja Direkte, qasja në tregjet e kapitaleve dhe financimet nga huatë koncesionale do të mbeten të kufizuara…" - World Bank, Public Expenditure and Institutional Review, September 2006

Mungesa e Statusit të qartë e përfundimtar për Kosovën po kompromenton shumicën e strategjive dhe planeve të zhvillimit të hartuara deri më sot, të cilat po mbesin në letër. Plani hapësinor i Kosovës[39] është një nga shembujt e kësaj dukurie. Zbatimi i tij mbështetet në rritjen thelbësore të investimeve publike e private (vendase e të huaja), të cilat për periudhën pesëvjeçare 2004-2008 duhet të jenë përkatësisht në nivelin e rreth 216 milion Euro dhe 495 milion Euro në vit. Realizimi i tri viteve të para është shumë larg këtyre parashikimeve.

Përkohshmëria është gjithashtu pengesë për forcimin e vendit dhe për qartësimin e përgjegjësive qeverisëse. Të rinjtë konsiderojnë se mungesa e Statusit i pengon ata për të thënë fjalën e tyre mbi dobësitë e qeverisjes dhe fenomenet negative në Kosovë. Ata ndiejnë t'u jetë imponuar mendësia e vetëkontrollit nga druajtja se debatet dhe protestat mund të ndikojnë për keq në vendimin për Statusin. *Kemi ulur kokën dhe presim me shpresë*[40].

Të gjitha analizat e mësipërme mbi gjendjen ekonomike të Kosovës teknikisht dëshmojnë se po të vazhdohet pa inpute financiare, të cilat janë të lidhura ngushtë me një Status të qartë e përfundimtar për Kosovën, përparimi ekonomik do të jetë i vështirë, treguesit realë do të jenë qartazi më të ulët dhe, pavarësisht nga të dhënat e paqarta të papunësisë, apo ndryshimet në metodikat e llogaritjes së treguesve, ndërtimi i skenarëve optimistë të zhvillimit të ardhshëm ekonomik do të jetë gjithnjë e më pak i lehtë.
Në anën tjetër me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës nuk duhet te pritet një ndryshim i menjëhershëm i situatës ekonomike. Duhet te merret parasysh se Statusi do te sjellë vetem nje mundësi më të madhe të përfshirjes së të rinjëve si dhe mundësive jetesore, por nuk do te ndryshojë menjëherë situaten në të mirë.

1.3 Niveli i zhvillimit njerëzor

Përmirësim apo përkeqësim?

Niveli i zhvillimit ekonomik të një vendi nuk përcakton drejtpërdrejt nivelin e zhvillimit njerëzor të tij. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor konsiderohet si më i përshtatshëm, pasi merr në konsideratë edhe tregues të tjerë që karakterizojnë zhvillimin.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor për Kosovën u llogarit për herë të parë në vitin 2001 dhe, më pas, në vitin 2004[41]. Ai u mbështet në përcaktimin e tre indekseve:

Kutiza 1.10 ***Matja e zhvillimit njerëzor***

Mënyra e matjes së zhvillimit njerëzor me anë të Indeksit të Zhvillimit Njerëzor u përdor për herë të parë nga UNDP në vitin 1990. Ajo shkon më tej se matja tradicionale e bazuar në nivelin e të ardhurave, duke i konsideruar ato si një aspekt thelbësor por jo i mjaftueshëm për matjen e zhvillimit. Kjo mënyrë matjeje bazohet në konceptin se qëllimi i zhvillimit është mirëqënia ndërsa rritja ekonomike është mjeti për ta realizuar këtë qëllim. Prandaj, përveç të ardhurave, ajo konsideron edhe të dhëna të tjera që karakterizojnë zhvillimin, siç janë arsimimi dhe jetëgjatësia. Llogaritja e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor për vende të ndryshme ka krijuar mundësine e krahasimit të nivelit të zhvillimit njerëzor të tyre dhe të frytshmërisë së politikave që ato zbatojnë për përparimin e këtij zhvillimi.

(i) ***Indeksi i të Ardhurave***, i matur me Prodhimin e Brendshëm Bruto për frymë të popullsisë, të shprehur me paritetin e fuqisë blerëse (PPP në US$);
(ii) ***Indeksi i Arsimimit***, i matur si kombinim i numrit të të rriturve që dinë të shkruajnë e të lexojnë dhe i normës së frekuentimit të arsimit fillor, të mesëm dhe universitar;
(iii) ***Indeksi i Jetëgjatësisë,*** i llogaritur në bazë të jetëgjatësisë mesatare të popullsisë.

Tabela 1.4: Të dhënat për llogaritjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës

Indeksi	Treguesi	Shpeshtësia e matjes	Saktësia e vlerës
Indeksi i të Ardhurave	Prodhimi i Brendshëm Bruto	Çdo vit	Metodikat e llogaritjes së PBB kanë ndryshuar disa here.Dhe FMN ka bërë disa vlerësime të PBB
	Popullsia	Çdo dhjetë vjet nga regjistrimi i popullsisë dhe përditësimi vjetor me llogaritje nga ESK.	Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është bërë në vitin 1981 dhe ESK nuk ka mundësi përditësimi të saktë sepse lëvizja demografike ka qënë shumë e madhe.
Indeksi i Arsimimit	Përqindja e të rriturve mbi 15 vjeç që dinë të shkruajnë e të lexojnë	Çdo 2-3 vjet nga anketa e vlerësimit të standardit të jetesës	Një anketë e tillë është zbatuar nga UNDP në vitin 2004. ESK nuk e ka përfshirë ende në programin statistikor këtë lloj ankete.
	Norma e frekuentimit të arsimit fillor, të mesëm dhe universitar	Çdo vit	Të dhënat për çdo vit jepen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, por pa ditur numrin e saktë të popullsisë për çdo grupmoshë. ESK ka kalkuluar nivelin e regjisrimit për vitin 2004
Indeksi i Jetëgjatësisë	Zgjatja mesatare e jetës	Çdo vit	Nuk mund të llogaritet e saktë sepse mungojnë të dhënat e popullsisë për secilën grupmoshë 5 vjeqare dhe numri i saktë i vdekjeve për çdo vit sipas grupmoshave

Burimi: ZSK, 2005

Të dhënat për llogaritjen e këtyre indekseve në Kosovë nuk janë ende të plota e të sakta (shih Tabelën 1.4). Në mënyrë të veçantë ndikon mosnjohja e saktë e popullsisë së Kosovës, ngaqë regjistrimi i fundit i popullsisë është bërë rreth 25 vjet më parë, dhe kjo bëhet pengesë kryesore për përafrimet e të dhënave. Ndikon, gjithashtu, ndryshimi disa herë i vlerave të PBB-së, që me metodikën e tanishme të llogaritjes, ka ndryshuar edhe vlerën e marrë për bazë në Raportin e Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2004. Prandaj edhe vlerat e përdorura për llogaritjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të vitit 2006 janë vetëm orientuese dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të nxjerrë përfundime të besueshme në lidhje me përkeqësimin apo përmirësimin e zhvillimit njerëzor në Kosovë gjatë dy viteve të fundit[42].

Indeksi i të Ardhurave [43]

Vlera e përafërt e llogaritur e këtij indeksi e mbështetur në vlerën e PBB-së së përcaktuar nga institucionet ndërkombëtare dhe në projeksionet e përafërta të popullsisë është 0.603. Kjo vlerë është pak më e ulët se ajo e llogaritur në vitin 2004 për shkak se PBB e parashikuar për vitin 2006 është më e ulët (shih Tabelën 1.2). Me këtë tregues Kosova renditet e fundit midis vendeve të Ballkanit (shih Figurën 1.13).

Indeksi i Jetëgjatësisë

Në mungesë të të dhënave të përditësuara është ngritur hipoteza se gjatë dy viteve të fundit nuk kanë ndodhur ndryshime të tilla në Kosovë, që të mund të ndikonin dukshëm në vlerën e këtij treguesi. Si rrjedhim, për llogaritjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor është përdorur vlera e Indeksit të Jetëgjatësisë e llogaritur në vitin 2004. Me këtë

Figura 1.13: Indeksi i të ardhurave i vendeve të rajonit të Ballkanit[44]



vlerë Kosova renditet e fundit midis vendeve të Ballkanit, në nivel të njejtë me Turqinë (shih Figurën 1.14).

Indeksi i Arsimimit

Vlera e përafërt e llogaritur e këtij indeksi e mbështetur në të dhënat e vitit 2005 mbi normat e frekuentimit të arsimit

Figura 1.14: Indeksi i Jetëgjatësisë së vendeve të rajonit të Ballkanit



fillor, të mesëm dhe universitar në Kosovë është 0.88 . Me këtë vlerë Kosova renditet e shtata midis vendeve të Ballkanit (shih Figurën 1.15).

Figura 1.15: Indeksi i Arsimimit i vendeve të rajonit të Ballkanit



Indeksi i Zhvillimit Njerëzor

Në bazë të vlerave të llogaritura për secilin nga indekset e mësipërme, Indeksi i Zhvillimit Njerëzor për vitin 2006 rezulton të jetë 0.740 apo pak më i lartë se ai i vitit 2004, i ndikuar pozitivisht nga rritja e lehtë e vlerës së Indeksit të Arsimimit (shih Tabelën 1.5).

Tabela 1.5: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës[45]

Viti	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
2001	0.721
2004	0.734
2006	0.740

Me këtë vlerë Kosova renditet e fundit midis vendeve të Ballkanit (shih Figurën 1.16).

Indeksi i Varfërisë Njerëzore 2006

Ky indeks shërben për matjen e varfërisë njerëzore dhe shprehet nëpërmjet dy përbërësave:

(i) ***IVNJ-1***, që pasqyron shkallën e privimit të njerëzve nëpërmjet vlerave të jetëgjatësisë, të matur me probabilitetin për të mos jetuar më shumë se 40 vjeç, të diturisë, të matur me normën e analfabetizmit për të rritur, dhe të standardit të jetesës, të matur me përqindjen e popullsisë, që nuk përdor burime ujore të sigurta, dhe përqindjen e fëmijëve nën peshë;

(ii) ***IVNJ-2***, shpreh privimin e njerëzve, duke i shtuar vlerave të mësipërme edhe disa tregues të margjinalizimit të tyre[46].

Figura 1.16: Renditja e vendeve të Ballkanit sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor



Nga këto dy përbërësa, IVNJ-1 është tregues tipik që përdoret për vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Kosova, ndërsa IVNJ-2 përdoret për vendet e zhvilluara.

Për llogaritjen e IVNJ-1 është konsideruar se gjatë dy viteve të fundit rreth 8.5% e pjesës së popullsisë që kanë vdekur kanë qënë nën moshën 40 vjeç[47], shkalla e analfabetizmit për të rritur është 5.8% (po ajo e vitit 2004), rreth 26% e popullsisë është pa qasje në ujin e pijshëm[48] dhe treguesit shëndetësor janë po ata të vitit 2004. Me këto të dhëna vlera e IVNJ-1 për vitin 2006 është 9.1 (shih Tabelën 1.6).

1.4 Politika dhe masa prioritare

Politika të posaçme apo të integruara?

Krijimi i kushteve optimale dhe i të gjitha mundësive të domosdoshme për të rinjtë për të marrë vendimet e drejta gjatë fazave të ndryshme të tranzicionit të moshës dhe për të marrë pjesë aktive në punën e gjithanshme për transaftesimin e vendit janë objektiva të përgjithshme madhore të politikave të zhvillimit të Kosovës.

Përmbushja e këtyre objektivave lidhet me politika e masa shumësektoriale, disa prej të cilave nuk janë posaçërisht për rininë. Kështu, sigurimi i rritjes ekonomike të vendit, nëpërmjet përshpejtimit të reformave, vënies në efiçiencë të burimeve potenciale të tij, zhvillimit të shpejtë të sektorit privat, rritjes së investimeve të huaja,

Tabela 1.6: Indeksi i Varfërisë Njerëzore (IVNJ-1) të Kosovës[49] në %

Viti	Përqindja e popullatës që nuk mbijetojnë deri në 40 vjeq	Norma e analfabetizmit	Pjesa e popullsisë pa qasje në ujin e pijshëm	Vdekshmëria foshnjore	Përqindja e fëmijëve nën peshë	IVNJ-1
2001	25.3	6.5	--	3.5	4.1	17.6
2004	6.8	5.8	27.4	3.5	4.0	9.7
2006	8.5	5.8	26	3.5	4.0	9.1

shtimit të fuqisë investuese të buxhetit publik apo përmirësimit të bilancit tregëtar, kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mirëqënien e të gjithë popullsisë së Kosovës. Në këtë këndvështrim, rinia nuk duhet veçuar por duhet konsideruar si pjesa e shoqërisë me energjinë, entuziazmin dhe kapacitetin më të madh për ndryshim, që ka nevojë të nxitet, të përfshihet dhe të mbështetet për ta shpalosur këtë potencial.

Përmbushja e këtyre objektivave lidhet edhe me politika e masa të posaçme sektoriale, disa prej të cilave janë integruar në projektin e përgatitur të Politikës Rinore të Kosovës. Integrimi social dhe autonomia e të rinjve janë dy komponentë të politikave rinore veçanërisht të rëndësishme për rininë e Kosovës dhe si të tilla do të ishte me shumë vlerë të përfshiheshin në këtë dokument strategjik. Masa që ndihmojnë aftesimin e të rinjve mbi çështjet, që lidhen me vendimet që ata duhet të marrin; ndërgjegjësimin e familjeve, veçanërisht në fshat, për të lejuar e nxitur pavarësinë e vendimmarrjes nga të rinjtë; apo që kultivojnë tek të rinjtë respektin për njëri tjetrin dhe tolerancën ndaj bashkëmoshatarëve me përkatësi të ndryshme etnike, mund t'i shërbenin zbatimit të këtyre politikave.

Si politikat e përgjithshme ashtu edhe ato të veçanta, duhet të konsiderohen dhe integrohen në Strategjinë e Zhvillimit të Kosovës 2007-2013, që është duke u përgatitur. Kostoja e financimit të masave prioritare, të paktën pjesa e parashikuar për t'u financuar nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, duhet të përfshihet në Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme 2006-2008 për të krijuar mundësi reale zbatimi, sepse në këtë dokument nuk janë parashikuar financime për masa të tilla për vitin 2007 dhe 2008.

Çdo i ri në shkollë ose në punë!

Për një vend si Kosova, me popullsinë më të re në Evropë, sigurimi i kushteve që çdo i ri të jetë në shkollë ose në punë, duhet të jetë në qendër të politikave prioritare të zhvillimit[50]. Që kjo të bëhet e mundur, arsimimi i të rinjve dhe lehtësimi i tranzicionit të tyre nga shkolla në punë, nëpërmjet krijimit të mundësive të punësimit, duhet të jenë pjesë e përbashkët e programeve politike të të gjitha instancave qeverisëse të Kosovës. Ato duhet të konsiderohen si politika prioritare kombëtare, që kërkojnë mbështetjen e plotë të institucioneve të Kosovës dhe të donatorëve ndërkombëtarë. Kjo mbështetje lidhet me përgatitjen e një kuadri ligjor, që garanton shkollimin dhe nxit punësimin, me rishikimin e strategjive ekzistuese të reformave të sektorit të arsimit dhe të punësimit, duke përcaktuar tregues të qartë e të matshëm afatmesëm dhe afatgjatë mbi shkallën e arsimimit dhe mundësitë e punësimit, dhe me sigurimin në vazhdimësi të financimeve të nevojshme.

Statistikat, domosdoshmëri për politika efiçiente

Vonesa e pashpjegueshme e riaftësimit të plotë të sistemit statistikor duket se është më shumë një çështje mendësie se sa burimesh financimi. Ngritja sa më parë e një sistemi të ri e të përparuar të dhënash nuk duhet kuptuar thjesht si një reformë sektoriale. Pa këtë sistem nuk mund të realizohen reformat për forcimin e sundimit të ligjit, zbutjen e varfërisë, përmirësimin e shëndetit të popullsisë etj. Mosriaftesimi i këtij sistemi duhet kuptuar si një pengesë serioze për përparimin e Kosovës. Zhvillimi i gjithanshëm i Kosovës kërkon politika dhe strategji efiçiente zhvillimi, të cilat nuk mund të jenë të tilla nëse nuk mbështeten në realitetin e Kosovës dhe nuk mund të jenë realiste pa të dhëna statistikore të sakta. Prandaj është më mirë që të ndërtohen disa kilometra rrugë më pak dhe të investohet në ngritjen e një sistemi të përparuar statistikor.

Monitorimi i zbatimit të politikave

Masat prioritare në dobi të rinisë, të integruara në strategjitë e përgjithshme dhe sektoriale të zhvillimit, kanë nevojë të verifikohen dhe përditësohen gjatë periudhës së zbatimit për të përcaktuar vlefshmërinë e tyre, shkallën e angazhimit të institucioneve përgjegjëse, efiçiencën e fondeve që shpenzohen dhe rezultateve që arrihen. Prandaj është e domosdoshme që ky proçes të monitorohet nga struktura të posaçme të institucioneve publike, veçanërisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe nga shoqëria civile, ku roli i shoqatave të të rinjve ka një rëndësi të veçantë.

Meditation

Kapitulli 2

E drejta dhe mundësia për t'u Arsimuar

2 E drejta dhe mundësia për t'u Arsimuar

Pajisja pa dallim e të rinjve me njohuri, aftësi e kompetenca bashkëkohore për të përballuar me sukses jetën dhe punën, është një e drejtë themelore e tyre dhe një detyrim për shoqërinë dhe institucionet e Kosovës. Të rinjtë cilësisht të arsimuar janë garancia për të ardhmen e përparuar e të qytetëruar të Kosovës dhe për përmbushjen e aspiratës europiane të saj.

2.1 Arsimi parauniversitar

Një dekadë e vështirë për arsimin

Zhvillimet politike të viteve '90 e kushtëzuan mjaft ecurinë e arsimit në Kosovë. Cënimi i autonomisë së Kosovës në fushën e arsimit dhe i vendimmarrjes së autoriteteve Kosovare për procesin arsimor çoi në krijimin e sistemit paralel të shkollimit të popullsisë shqiptare në të gjitha nivelet, përfshirë edhe nivelin universitar. Rreth 360 mijë nxënës të arsimit bazë, 81 mijë nxënës të arsimit të mesëm të lartë dhe rreth 30 mijë studentë të Universitetit të Prishtinës e braktisën sistemin formal të arsimit[51]. Në sistemin paralel, mësimi kryhej jashtë mjediseve shkollore, zakonisht nëpër shtëpi, ndërsa financimi bëhej i mundur nga të ardhurat nga një taksë jo zyrtare, që popullsia shqiptare e Kosovës paguante për këtë qëllim, si dhe nga kontributi i diasporës Kosovare. Procesi mësimor në sistemin paralel ishte me mangësi të mëdha. Njohuritë e marra nga nxënësit ishin shumë modeste dhe programi mësimor përqëndrohej vetëm në disa lëndë kryesore. Shkollimi në gjuhën shqipe kishte përparësi ndaj cilësisë së aftesimit të nxënësve. Sistemi paralel i shkollimit vazhdoi deri në vitin 1999.

Shumica e të rinjve të sotëm i ndiejnë drejtpërdrejt pasojat e këtij sistemi sepse fëmijët, që kanë hyrë për herë të parë në shkollë pas vitit 1991, sot janë ende të përfshirë në grupmoshën e rinisë. Një pjesë e tyre kanë pasur njohuri të pamjaftueshme për vazhdimin e mëtejshëm të shkollës së mesme ose të lartë, ndërsa një pjesë tjetër nuk kanë marrë njohuritë e duhura për të qënë të suksesshëm në tregun e punës.

Pas përfundimit të konfliktit, sistemi paralel i shkollimit u zyrtarizua dhe rindërtimi i infrastrukturës shkollore së dëmtuar u shndërrua në një kërkesë parësore për rifillimin normal të punës së sistemit arsimor. Nevoja urgjente për këto investime ishte rezultat i lënies pas dore të shkollave deri në vitin 1999 dhe shkatërrimeve të luftës. Rreth 45% e shkollave vlerësoheshin të shkatërruara plotësisht ose të dëmtuara rëndë nga lufta dhe vetëm 17% e tyre ishin të pacënuara fare. Në shumicën e shkollave mungonte furnizimi me ujë dhe pajisjet sanitare. Po kështu, rreth 200 shkolla kishin zonën përreth tyre të minuar dhe nuk mund të shfrytëzoheshin për mësim pa u çminuar më parë[52]. Si rrjedhim, gjatë periudhës 1999-2001 në Kosovë u ndërtuan ose u riparuan rreth 1000 objekte shkollore të goditura nga lufta.

Kutiza 2.1 ***Cilësia e kapitalit njerëzor***

Sistemi i arsimit ka ndikim të dukshëm në cilësinë e kapitalit njerëzor, i cili karakterizohet nga aftësitë e lindura, kualifikimet dhe njohuritë e fituara përmes arsimit formal, kompetenca dhe përvoja e fituar përmes punës. Cilësia e kapitalit njerëzor ka ndikim të drejtpërdrejt në rritjen ekonomike të një vendi. Nga pikëpamja makroekonomike, evidenca empirike sugjerojnë se një vit shtese e arsimimit të popullsisë sjell rritjen e PBB-së rreth 5% për një periudhë afatshkurtër dhe rreth 2.5% për një periudhë afatgjatë. Kjo lidhet me produktivitetin më të lartë të punëtorëve më të kualifikuar dhe shkallën më të lartë të përdorimit të teknologjisë prej tyre. Cilësia e kapitalit njerëzor është e rëndësishme, veçanërisht, për vendet në tranzicion sepse ju krijon atyre mundësi për të përballuar konkurrencën në tregun global të punës. (European Commission Report, 2002). Në këtë këndvështrim, krijimi i mundësive për arsimimin cilësor të të rinjve të sotëm, që janë pjesë e fuqisë punëtore të nesërme, është një investim me shumë vlerë dhe me pasoja afatgjate për Kosovën.

Zëvendësimi i strukturës tradicionale të sistemit të arsimit 4+4+4 me strukturën e re 5+4+3/4, të krahasueshme me shumë vende të Bashkimit Europian, ishte edhe hapi i parë që u ndërmor gjatë periudhës 2000 – 2003 për riaftesimin e sistemit arsimor të Kosovës. Sistemi i ri përfshin 9 vite të arsimit të detyruar, nga të cilët 5 vitet e para janë arsimi fillor dhe 4 vitet në vazhdim janë arsimi i mesëm i ulët, dhe 3 deri

në 4 vite të arsimit të mesëm të lartë [53]. Karakteristika më kryesore e fillimit të kësaj reforme ishte zbatimi i menjëhershëm i ndryshimit të sistemit pa u paraprirë ose shoqëruar me ndryshimet e nevojshme të përmbajtjes së tij.

Arsimi i mesëm përfshin arsimin e mesëm të përgjithshëm, i cili zgjat 3 ose 4 vite dhe i jep mundësi nxënësve të vazhdojnë më tej studimet universitare, dhe arsimin e mesëm profesional, i cili zgjat 3 ose 4 vite. Sistemi 3 vjeçar i arsimit profesional përgatit punëtorë të kualifikuar për në tregun e punës, ndërsa sistemi 4 vjeçar i jep mundësi nxënësve edhe për të vazhduar studimet universitare.
Këto ndryshime të shpejta bëjnë që, përgjithësisht, perceptimi i të rinjve për cilësinë e niveleve të ndryshme të sistemit të arsimit të jetë pozitiv (shih Figurën 2.1)[54] Megjithatë, në këtë perceptim vihen re dallime. Cilësia e arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë vlerësohet si *e mirë, shumë e mirë* dhe *e shkëlqyer* nga përkatësisht 47%, 43% dhe 42% e të rinjve. Po t'i shtohet këtij vlerësimi edhe përqindja e të rinjve, që e konsiderojnë cilësinë e arsimit si *relativisht të mirë*, atëhere vlerësimet sipas niveleve të sistemit të arsimit janë përkatësisht rreth 78%, 76% dhe 66%, ku dallohet një rezervim më i madh i të rinjve ndaj cilësisë së arsimit të lartë.

Në këto vlerësime duhet konsideruar, gjithashtu, se perceptimi i të rinjve ndikohet edhe nga krahasimi që ata bëjnë me gjendjen e sistemit të arsimit paralel që trashëguan deri në viti 1999.

Interesi për t'u shkolluar

Të dhënat statistikore zyrtare nuk japin mundësi të gjykohet saktë për çdo vit shkollor mbi shkallën e interesit të fëmijëve dhe të rinjve për të ndjekur mësimet në arsimin parauniversitar. Kjo vjen nga mungesa e të dhënave të popullsisë sipas grupmoshave. Megjithatë, numri i nxënësve gjithsej ka mbetur afërsisht në nivele të njejta (shih Tabelën 2.1). Numri më i vogël i nxënësve në arsimin e mesëm sipas viteve është më së shumti për llogari të rritjes së numrit të nxënësve në arsimin e detyrueshëm nga ndryshimi i sistemit arsimor.

Figura 2.1: Përceptimi mbi cilësinë e niveleve të ndryshme të sistemit të arsimit të mesëm të lartë



Tabela 2.1: Numri i nxënësve në arsimin parauniversitar sipas viteve

Niveli i arsimit	Numri i nxënësve për çdo vit shkollor			
	2001/2002	2002/2003	2003/2004	2004/2005
I detyrueshëm	307.517	315.089	339.680	327.618
I mesëm	93.502	86.830	72.635	70.183
Gjithsej	401.019	401.919	412.315	397.801

Burimi: MASHT, 2005

Në vitin shkollor 2004-2005 në Kosovë vijuan arsimin parauniversitar, përfshirë edhe atë parashkollor, 422 746 nxënës në gjithsej 1091 shkolla gjithsej (shih Tabelën 2.2). Mbi 99% e tyre u regjistruan në shkollat publike dhe vetëm një numër shumë i vogël në shkollat private, të cilat janë të përqëndruara kryesisht në Prishtinë. Numri i shkollave private të arsimit parauniversitar është ende shumë i vogël sepse:

(i) ***Familjet kanë të ardhura të pakta*** dhe kanë vështirësi të përballojnë pagesat për këto shkolla, të cilat sot janë në nivelin e mbi 100 Euro në muaj**;**

(ii) ***Cilësia perceptohet se është e ulët*** në krahasim me shkollat publike. Prindër, që i kanë mundësitë financiare dhe kanë regjistruar fëmijët në shkolla të tilla, shprehen të pakënaqur sepse vlerësimi i nxënësve është subjektiv dhe notat e larta merren me lehtësi nga nxënësit[55]. Po kështu, vetëm 1 në çdo 3 të rinj të pyetur shprehet se cilësia e shkollave private (përfshirë dhe universitetet) është *e mirë* dhe *shumë e mirë*[56].

komunitetin shqiptar dhe serb, por për komunitetet e tjera etnike norma e regjistrimit është shumë më e ulët, e ndikuar, veçanërisht nga pjesëmarrja më e pakët e fëmijëve të komunitetit RAE.

Rritja e normës së regjistrimit në arsimin bazë mbetet një detyrë parësore e reformës së sistemit të arsimit në Kosovë. Ajo duhet të synojë t'i afrohet vendeve të përparuara perëndimore[57], sepse është një tregues që lidhet drejtpërdrejt me fenomenin e analfabetizmit. Sot Kosova ka një shkalle analfabetizmi 5.8%, e cila mund të konsiderohet e lartë, megjithëse analfabetizmi është i përqëndruar më shumë në popullsinë mbi 65 vjeç, e cila ka pasur qasje të kufizuara në arsim. Norma e analfabetizmit është mjaft e lartë tek komuniteti RAE, rreth 24.4%, që është rezultat kryesisht i përfshirjes së pakët të tyre në arsimin bazë[58]. Rrjedhimisht edhe mundësitë e të rinjve të këtij komuniteti për tu përfshirë më pas në tregun e punës apo për tu shkolluar më tej në nivelet e tjera të arsimit janë shumë të kufizuara.

Tabela 2.2: Numri i nxënësve dhe shkollave të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2004/2005

Niveli i arsimit	Nxënësit			Shkollat		
	Arsimi publik	Arsimi privat	Shuma	Publike	Private	Shuma
Parashkollor	24.672	273	24.945	32	5	37
I detyrueshëm	327.207	411	327.618	944	3	947
I mesëm i lartë	69.760	423	70.183	103	4	107
Gjithsej	421.639	1.107	422.746	1.079	12	1.091

Burimi: MASHT, 2005

Baza për shkollimin e mëtejshëm

Ndjekja e arsimit në fëmijëri, ecuria e mirë dhe njohuritë e fituara gjatë arsimit të detyrueshëm janë kushte të rëndësishme që të rinjtë të kenë sukses në fazat e mëtejshme të arsimimit të tyre. Në këtë këndvështrim, hedhja e bazave për shkollimin e mëtejshëm mbështetet në disa faktorë themelorë, që lidhen me frekuentimin e arsimit bazë dhe përmirësimin e cilësisë, nëpërmjet zbatimit të metodave të reja, që vendosin në qendër nxënësin, si dhe përgatitjen dhe zbatimin e programeve mësimore bashkëkohore dhe rritjen e cilësisë së mësuesve.

Përfshirja në arsimin e detyrueshëm

Duke analizuar të dhënat e arsimit të detyrueshëm në Kosovë, vërehet që ai karakterizohet nga norma të mira të regjistrimit. Në vitin 2003 ishin të regjistruar në këtë nivel 95.4% e popullsisë së grupmoshës përkatëse (shih Tabelën 2.3). Vlerat më të larta të këtij treguesi janë për Megjithatë, studimet pasqyrojnë të dhëna shumë më shqetësuese për analfabetizmin në Kosovë, duke përfshirë në këtë fenomen edhe të rinjtë. Kështu, në zonën rurale, rreth 9.5% e vajzave të grupmoshës 16-19 vjeç rezultojnë se janë analfabete, ndërkohë që atje një ndër katër të reja kanë njohuri shumë të pakta shkrimi e leximi [59].

Tabela 2.3: Shkalla e regjistrimit në arsimin fillor (2003/2004)

Përkatësia etnike	Norma e rregjistrimit në %
Shqiptarë	96.6
Serbë	95.2
Të tjerë	86.6
Të gjithë	95.4
Raporti i vajzave ndaj djemve	92.0

Burimi: ESK, 2004

Ky nivel mjaft i ulët zhvillimi, përveçse përkeqëson pozitën e tyre sociale, ka implikime të drejtpërdrejta në aftësitë prindërore të të rejave, që ndikon më pas tek zhvillimi i fëmijëve të tyre.

Braktisja e shkollës

Megjithëse të dhënat e sakta mbi braktisjen e shkollës mungojnë, në analiza të ndryshme rreth sistemit arsimor në Kosovë vlerësohet se ky fenomen është i pranishëm në arsimin bazë, sidomos në zonën rurale.

Kështu, të dhënat e (tabelës 2.3) tregojnë se numri i vajzave të regjistruara është më i vogël se ai i djemve, gjë që shprehet në vlerën e raportit të regjistrimit të vajzave ndaj djemve që është 0.92. Analiza më e thellë e kësaj dukurie tregon se regjistrimi i vajzave është pothuajse në të njejtin nivel me të djemve në vitet e para të arsimit bazë. Më pas në 2-3 vitet e fundit, veçanërisht në shkollat e zonës rurale, ky numër fillon e zvogëlohet, i ndikuar më shumë nga tradita zakonore se sa nga dëshira e vajzave për të mos shkuar në shkollë. Kjo mund të konsiderohet si një pengesë e rëndësishme për vajzat që të vashdojnë më tej shkollën në arsimin e mesëm.

Nga të dhënat e një vrojtimi, gjithashtu, rezulton se rreth 1.17% apo 4,141 nxënës të arsimit fillor e kanë braktisur

Kutiza 2.2 ***Cilësi e ulët e arsimit fillor në vendet në zhvillim***

Megjithë përparimin e arsimit fillor në vendet në zhvillim, përgatitja e rinisë për tregun e punës dhe për të përballuar jetën rezulton të jetë shumë e ulët. Kjo vjen ngaqë kërkesat për aftësi dhe njohuri në një treg gjithnjë e më global janë në rritje të shpejtë dhe nuk ndiqen dot nga ritmet e riaftesimit të arsimit bazë. Nga ana tjetër, objektivat e deritanishme të vendeve në zhvillim janë përqëndruar më tepër në rritjen e numrit të nxënësve të përfshirë në arsim se sa në rritjen e nivelit të njohurive të tyre, për të zhvilluar aftësi të tilla që do të mundësonin përgatitjen e tyre për punë dhe për të përballuar jetesën në të ardhmen. (WB, World Development Report 2007)

mësimin[60]. Largësia e shkollës nga vendbanimi i nxënësve, vështirësitë e transportit, nevojat e familjes për të përfshirë djemtë në punët e fermave private, perceptimi i disa prindërve dhe të rinjve se shkolla nuk të krijon ndonjë avantazh të rëndësishëm në punë, renditen si shkaqet më të dukshme të braktisjes së arsimit bazë nga ana e nxënësve.

Braktisja e fshehtë, që karakterizohet nga mungesa e aftësisë për shkrim e lexim të nxënësve që vazhdojnë të ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm, është një fenomen tjetër me pasoja negative në të ardhmen e të rinjve, për të cilin mungojnë pothuajse plotësisht të dhënat. Ai vjen kryesisht nga mungesa e motivimit të nxënësve për të mësuar, mjedisi i papërshtatshëm për nxënësin në klasë, interesimi i pakët i mësuesve dhe mungesa e kujdesit nga ana e prindërve. Pasojat e këtij fenomeni shfaqen drejtpërdrejt në rritjen e shkallës së analfabetizmit.

Numri i nxënësve për klasë

Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e detyrueshëm në Kosovë është 24.5. Ky numër është mjaft më i madh në zonat urbane dhe veçanërisht në qytetet me përqëndrime të mëdha nga lëvizjet demografike të popullsisë. Klasat janë të mbingarkuara me nxënës dhe shpesh herë numri i tyre arrin në mbi 40 nxënës për klasë. Sipërfaqja mesatare për nxënës në vitin 2005 në Kosovë ishte 0.4-0.8 m^2/nxënës krahasimisht me 1.8m^2/nxënës që është standardi i Kosovës. Të dhënat provojnë që në 50% të shkollave, kjo arrin edhe në 0.2-0.4 m^2/nxënës. Në një numër të konsiderueshëm shkollash mësimi zhvillohet me 3-4 turne, megjithëse udhëzimet e MASHT përcaktojnë që mësimi të organizohet në jo më shumë se dy turne.

Zbatimi i sistemit të ri të arsimit të detyrueshëm e zgjati kohën e qëndrimit të nxënësve në shkollat e arsimit bazë, të cilat ishin të papërgatitura për të përballuar mbingarkesën. Kjo ka bërë që shumë shkolla të funksionojnë me dy a më shumë turne në ditë dhe të dëmtohet rëndë cilësia e mësimit. Zgjidhja që po zbatohet në disa shkolla, duke e transferuar klasën e nëntë në ndërtesat e shkollave të mesme është një zgjidhje e pjesshme, që jo gjithmonë ka qenë e frytshme, sepse shkollat e mesme janë më të rralla dhe vështirësia e zhvendosjes së nxënësve, veçanërisht e vajzave, nxit braktisjen e shkollës.

Gjendja aktuale e infrastrukturës shkollore, gjithashtu, nuk i përgjigjet tendencave të lëvizjeve demografike. Vlerësohet që investimet në infrastrukturën shkollore janë shoqëruar me mungesë të theksuar vëmendjeje për të krijuar një mjedis psikosocial të mirë në shkolla, çka po ndikon negativisht në cilësinë e të mësuarit.

Debati për riaftësimin e kurrikulave

Përmbajtja e programit shkollor është një nga çështjet më themelore të arsimit parauniversitar të Kosovës. Largimi nga forma tradicionale e arsimit, që bazohet në llojet dhe numrin e lëndëve që zhvillohen në shkolla, për t'u përshtatur me format e përparuara, që bazohen në rezultatet apo në vlerësimin e cilësisë së dijeve të marra, filloi me vendosjen e sistemit 9 vjeçar të arsimit të detyrueshëm.

Por ky transformim e ka vënë Kosovën përpara sfidash të mëdha, që lidhen me përmbajtjen dhe mësimdhënien.

Kutiza 2.3 ***Dy qasje të ndryshme për reformën e kurrikulave***

Përgatitja e Kornizës Kurrikulare të Kosovës ngjalli debatin mbi dy çështje kryesore: (i) Nga duhet të fillojë reforma kurrikulare, nga klasa e nëntë apo nga klasa e parë. Procesi i hartimit të kurrikulave lëndore filloi me klasën e nëntë në vitin shkollor 2002/2003, ka vazhduar me kurrikulat e klasave 1, 6 dhe 10 dhe në vitin shkollor 2005/2006 arriti në kurrikulat e klasave 4, 5 dhe 13. Ekspertë të fushës së arsimit e konsiderojnë paradoksal vendimim për të ndjekur këtë renditje. Sipas tyre, shtrirja horizontale dhe vertikale e përmbajtjeve kurrikulare të përgatitura në këtë mënyrë nuk është koherente dhe përmbajtjet përsëriten nga klasa në klasë. (ii) Cili duhet të jetë institucioni i ngarkuar për realizimin e kësaj reforme? Procesi i riaftesimit të kurrikulave është koordinuar nga Grupi i Kurrikulit në MASHT. Kurrikulat janë hartuar kryesisht nga 3 ekspertë, dy prej të cilëve pedagogë të lëndës në Universitet dhe një arsimtar i përfshirë drejtpërdrejt në mësimdhënie. Ekspertë të fushes se arsimit konsiderojnë se kjo reformë duhet të koordinohet nga Ministria por duhet të jetë përgjegjësi e një institucioni të posaçëm, i cili do të drejtojë, zbatojë dhe vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme reformën kurrikulare, duke siguruar që ajo të përputhet me reformat europiane. Edhe Këshilli Kombëtar i Planprogrameve dhe Teksteve mësimore, i parashikuar në Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, nuk është krijuar ende për mungesë fondesh.

Përqëndrimi i vëmendjes fillimisht në zëvëndësimin e sistemit paralel të shkollimit dhe më pas në rindërtimin e infrastrukturave shkollore ka bërë që riaftesimi i kurikulave dhe elementëve të tjerë të procesit mësimor të mbeteshin pas në axhendën e prioriteteve të MASHT.

Përgatitja e Kornizës së re Kurrikulare të Kosovës në vitin 2001 ishte edhe hapi i parë konkret për vënien në jetë të sistemit të ri arsimor në Kosovë. Procesi i riaftesimit të arsimit të detyrueshëm u mbështet në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit në Kosovë për periudhën 2002-2007. Ky dokument strategjik synon të orientojë sistemin arsimor nga përmbajtja dhe cilësia e të nxënit, duke i fokusuar reformat në katër shtylla kryesore: kurrikulat, tekstet shkollore, trajnimi i mësuesve dhe vlerësimi. Megjithëse ende nuk e ka marrë miratimin e MASHT, Korniza e re Kurrikulare është konsideruar dokument cilësisht i mirë që përcakton qëllimet, objektivat, parimet kurrikulare dhe ndërkurrikulare për zhvillimin e arsimit.

Korniza Kurrikulare përcakton hollësisht temat mësimore, në përputhje me objektivat dhe rezultatet e të nxënit, duke u lënë më pak hapësirë mësuesve në përcaktimin e temave dhe kohës për secilën temë. Ajo përcakton se rreth 80% e përmbajtjes së kurrikulave do të jetë e përqëndruar, ndërsa shkollave u lihet autonomi vetëm për rreth 10 deri 20 % të përmbajtjes.

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare aktualisht përballet me tri vështirësi kryesore, ende të pazgjidhura:

(i) ***Stafi mësimdhënës është i pa trajnuar*** për të zbatuar me cilësi kurrikulat e reja dhe për të zhvilluar vetë kurrikula në mënyrë të pavarur;

(i) ***Mungesa e fondeve***. Delegimi i përgjegjësisë për përgatitjen në shkollë të kurrikulave të lëndëve me zgjedhje nuk është shoqëruar me transferimin e buxhetit të nevojshëm për të paguar ekspertët, që do të përfshihen në këtë proces;

(iii) ***Subjektivizmi i përzgjedhjes së lëndëve***. Shpesh herë përzgjedhja kushtëzohet me mbajtjen në punë të stafit pedagogjik ekzistues dhe kjo bëhet pengesë për futjen e lëndëve të reja. Kjo favorizohet edhe nga mungesa e mjediseve dhe mjeteve mësimore për disa lëndë, që kërkohen më shumë nga nxënësit, siç është, për shembull, rasti i informatikës. Kjo vjen edhe ngaqë Zyrat Rajonale për Zhvillimin e Arsimit nuk kanë zbatuar si duhet detyrën e tyre ligjore për përcaktimin e një kornize plan programi për lëndët me zgjedhje.

Kutiza 2.4 ***Sa është real vlerësimi i dijeve të nxënësve?***

Sipas statistikave rajonale, kalueshmëria mesatare e vitit shkollor 2002 – 2003 në klasat 1-5 në Kosovë është rreth 89.14%, në klasat 6-9 është 75.04% dhe në klasat 10-12 është 86.08%. Po kështu, kalueshmëria mesatare për të tre nivelet së bashku është rreth 83.42%. Këto shifra pasqyrojnë nivele të larta nxënie. Por po të krahasohen këto vlerësime me testin kombëtar në përfundim të klasës së nëntë të vitit shkollor 2002-2003 dhe 2003-2004 vihet re se rezultatet e testeve arrijnë deri në 30% më të ulta. Kjo tregon se problemi i vlerësimit jo real të nxënësve është qartazi gjerësisht i pranishëm. Kjo lidhet me shkallën e ulët të standardizimit të vlerësimit të dijeve të nxënësve, nivelin e pamjaftueshëm profesional të mësuesve dhe motivimin e pakët të tyre në detyrën që kryejnë. (Të dhënat janë nxjerrë nga drafti i Plan- Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 2007-2013, përgatitur nga MASHT, 2006.

Ajo që bie menjëherë në sy është se ky debat bëhet midis specialistësh të arsimit dhe nëpunësish të institucioneve publike, pa përfshirë të rinjtë, që janë aktualisht pjesë ose e kanë përfunduar arsimin e detyruar. Nga njëra anë, kjo vjen nga mendësia e gabuar e vendimmarrësve se kurrikulat janë çështje teknike dhe vetëm ekspertë me përvojë mund të japin mendime e të vendosin për to, dhe, nga ana tjetër, nga mosangazhimi i vetë të rinjve, të cilët nuk e konsiderojnë veten pjesë të debatit mbi cilësinë e arsimit dhe të procesit të riaftesimit të kurrikulave.

Në punë ose në universitet

Pas mbarimit të arsimit të mesëm të lartë, të rinjtë mendohet se janë të aftësuar për të kaluar nga shkolla në punë apo e kanë përgatitjen bazë për të ndjekur më tej studimet universitare. Arsimi i mesëm i lartë konsolidon e zhvillon më tej njohuritë e marra gjatë viteve të arsimit të detyrueshëm, nxit dëshirën për të përzgjedhur një profesion të ardhshëm dhe ndihmon për krijimin e kapacitetit të nevojshëm vendimmarrës të të rinjve për ta përmbushur këtë dëshirë.

Megjithatë, shpesh herë, arsimi i mesëm i lartë vazhdon të konsiderohet thjesht si një urë lidhëse e arsimit të detyruar me arsimin universitar. Kjo mendësi haset në shumicën e vendeve në zhvillim, ku vlerësohet se në arsimin e mesëm të përgjithshëm regjistrohen rreth 78% e numrit të përgjithshëm të nxënësve të arsimit të mesëm dhe se arsimi i mesëm i përgjithshëm është ende shumë i orientuar drejt përgatitjes së të rinjve për të ndjekur arsimin e lartë, duke i lënë një vend mjaft të vogël përgatitjes së tyre për të hyrë në tregun e punës.

Kosova bën përjashtim nga kjo tendencë e përgjithshme e vendeve në zhvillim. Në vitin shkollor 2005-2006 ndoqën arsimin e mesëm të lartë rreth 70 mijë nxënës në 107 shkolla të mesme (shih Tabelën 2.2) dhe 56% e tyre ishin të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm profesional. Ky është një tregues mjaft i mirë dhe, të paktën nga ana sasiore, shpreh orientimin e sistemit arsimor drejt përgatitjes së të rinjve për tregun e punës. Por në anën tjetër, ky tregues mund të shikohet edhe nga këndi i vlerësimit të klases së nëntë si metodë monitoruese për aritjet e ulëta të nxënësve në mënyre që ti orientojë ata nga drejtimet teknike apo praktike

Pabarazia e përfshirjes në arsimin e mesëm të lartë

Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë në vitin shkollor 2003 – 2004 ishte 75.2% (shih Tabelën 2.4). Ky tregues është shumë më i lartë se ai i vitit shkollor 2000 – 2001, kur shkalla e regjistrimit ishte vetëm 59.5%[61], dhe shpreh rritjen e shpejtë të interesit të të rinjve për tu arsimuar dhe një mendësi të re të familjeve mbi rëndësinë e shkollës së mesme për fëmijët e tyre. Megjithatë, raporti i vajzave ndaj djemve në këtë nivel arsimor është shumë më i ulët se ai i arsimit të detyruar (0.79 kundrejt 0.92) dhe kjo dëshmon për dallime të rëndësishme gjinore, veçanërisht në zonat rurale, që vijnë nga tradita zakonore e familjeve ose nga martesat e hershme.

Sipas grupeve etnike, norma e regjistrimit të të rinjve të komunitetit serb është 96.3% dhe kjo është një vlerë shumë e lartë, që shpreh rëndësinë që ky komunitet i kushton arsimimit të të rinjve. Vlera më e ulët e përfshirjes së të rinjve shqiptarë në arsimin e mesëm të lartë, që është rreth 78.3%, mund të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e kapacitetit të kufizuar të sistemit të arsimit për të ofruar mundësi për të gjithë, si në aspektin e shtrirjes gjeografike të rrjetit të shkollave ashtu edhe në aspektin e profileve që ato ofrojnë.

Tabela 2.4: Shkalla e e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë (2003/2004)

Përkatësia etnike	Shkalla e regjistrimit në %
Shqiptarë	78.3
Serbë	96.3
Të tjerë	41.7
Të gjithë	75.2
Raporti i vajzave ndaj djemve	79.0

Burimi: ESK, 2004

Përfshirja shumë e pakët në arsimin e mesëm të lartë e të rinjve të komuniteteve të tjera është një çështje mjaft shqetësuese. Në vitin shkollor 2003-2004 ajo ishte vetëm 41.7%. Kjo do të thotë se më shumë se gjysma e të rinjve të grupmoshës përkatëse nga këto komunitete etnike nuk frekuenton arsimin e mesëm apo se përfshirja e tyre në arsimin e mesëm të lartë është rreth dy herë më e ulët se përfshirja e të rinjve shqiptarë dhe serbë. Vlera shumë e ulët e këtij treguesi ndikohet mjaft nga ajo e komunitetit RAE dhe arsyet e këtij dallimi të madh lidhen me:

(i) ***Shkallën më të ulët të përfshirjes*** së fëmijëve të këtij komuniteti në arsimin e detyrueshëm dhe braktisjen e lartë në vitet e arsimit të mesëm të ulët. Kjo ndikohet nga niveli kulturor i familjeve, nevoja ekonomike e tyre për të përfituar nga puna e fëmijëve dhe mendësia tradicionale se shkollimi nuk sjell asnjë avantazh për fëmijët e tyre;

(ii) ***Cilësinë e nxënies*** në arsimin e detyrueshëm. Megjithëse të dhënat statistikore mungojnë, në favor të këtij argumenti janë vlerësimet se kjo cilësi është shumë më e ulët për nxënësit e komunitetit RAE dhe krijon pak mundësi për të vazhduar shkollën më tej;

(iii) ***Martesat e hershme,*** të cilat janë shumë më tipike për familjet e këtij komuniteti.

Numri i nxënësve për mësimdhënës dhe për klasë

Kosova, treguesin e numrit mesatar të nxënësve për mësimdhënës në arsimin e mesëm të lartë e ka të përafërt me vendet e tjera (shih Tabelën 2.5). Edhe numri mesatar i nxënësve për klasë është 29.2, që është një nivel i mirë.

Tabela 2.5: Krahasimi i treguesit nxënës/mësues

	Treguesi nxënës/mësues sipas niveleve të arsimit		
	Parashkollor	**Fillor**	**I mesëm**
Mesatarja e OECD	14.9	17	13.9
Kosova	33	20	14
Hungaria	11.4	11.3	12.5
Rumania		15	12.9
Shtetet e Bashkuara	14.9	16.3	14.8

Burimi: OECD, Education at a Glance, 2005. Global Education Digest 2005.

Megjithatë, ndryshimet midis shkollave të mesme dhe, veçanërisht, midis atyre në qendrat e mëdha e të mbipopulluara urbane dhe në zonat rurale janë shumë të mëdha. Në qytete ka klasa të shkollës së mesme me më shumë se 40 nxënës, gjë që ndikon negativisht në zhvillimin e një procesi mësimor normal dhe në nivelin e përvetësimit të njohurive nga nxënësit.

Cilësia e mësimdhënies

Korniza e re Kurrikulare e Kosovës ka filluar të zbatohet gjerësisht edhe në sistemin e arsimit të mesëm të lartë, duke filluar nga viti shkollor 2003-2004 për klasën e dhjetë dhe parashikohet që ky proces të përfundojë në vitin 2007 për vitin e katërt. Megjithatë, ndikimi i këtij procesi në cilësinë e këtij niveli arsimi është shumë më i ngadaltë. Një nga arsyet kryesore është se modernizimi i kurrikulave ka përparuar shumë më shpejt se riaftesimi i metodave të mësimdhënies. MASHT dhe një numër i konsiderueshëm donatorësh ndërkombëtarë organizojnë trajnime për mësuesit dhe gjatë katër viteve të fundit rreth 60% e mësuesve kanë qënë përfitues të këtyre trajnimeve[62]. Problemi qëndron në llojin dhe cilësinë e trajnimeve, si dhe në faktin se ato më së shumti janë trajnime të përgjithshme dhe nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimet kurrikulare.

Cilësia e mësimdhënies është e lidhur ngushtë edhe me motivimin financiar të mësimdhënësve. Paga mesatare e mësimdhënësve është më e ulëta e pagave të sektorit buxhetor. Kështu, paga mesatare e mësimdhënësve e vitit 2004 ishte 166 Euro në muaj kundrejt 189 Euro në muaj që ishte paga mesatare e buxhetorëve gjithsej[63]. Ajo është pak më e lartë se paga mesatare në sektorët bujqësi e pylltari[64], të cilët përfaqësojnë edhe pagën më të ulët të sektorëve jobuxhetorë.

Përfshirja në arsimin profesional

Sistemi i arsimit profesional në Kosovë përbëhet nga 56 shkolla të mesme profesionale me programe 3 dhe 4-vjeçare. Programet 3-vjeçare përgatisin punëtorë gjysëm të kualifikuar dhe ato 4-vjeçare punëtorë të kualifikuar. Kalimi nga sistemi 3 në 4-vjeçar varet nga rezultatet në mësime. Megjithëse pas përfundimit të programit 3-vjeçar nxënësit kanë të drejtë të aplikojnë për të vazhduar studimet e larta në universitet, në vitin akademik 2006-2007 filloi të zbatohet një program 4-vjeçar i shkollave profesionale, për të përgatitur nxënës me më shumë aftësi për sistemin e maturës mundësinë e regjistrimit në univerzitet. që sapo ka hyrë në sistemin arsimor të Kosovës.

Numri i të rinjve të regjistruar në arsimin e mesëm profesional në Kosovë është i konsiderueshëm krahasuar me numrin e pergjithshem të të rinjve gjithsej në arsimin e mesëm (shih Tabelën 2.6). Rënia e dukshme e numrit të nxënësve në vitin 2003-2004, lidhet kryesisht me futjen e sistemit 9-vjeçar në arsimin e detyrueshëm.

Tabela 2.6: Nxënësit në arsimin e mesëm dhe në arsimin profesional 2002-2005

	Numri i nxënësve sipas viteve shkollore			
	2002-2003	**2003-2004**	**2004-2005**	**2005-2006**
Profesional	47.024	43.162	36.275	40.819
Arsimi profesional në %	54.2	59.4	51.7	54.5

Burimi: ESK, 2006

Në vitin shkollor 2005-2006 u regjistruan rreth 41000 nxënës në 8 profile të veçanta dhe një profil të përzier. Numri më i madh i nxënësve u regjistrua në shkollat e profilit teknik, rreth 46%, dhe në shkollat e profilit ekonomik, rreth 22.7% (shih Figurën 2.2). Rreth 35% e të rinjve të regjistruar në arsimin e mesëm profesional janë femra. Bie në sy numri i pakët i të rinjve që mësojnë në profilin bujqësor, ndërkohë që bujqësia përfaqëson një sektor ku punësohet pjesa më e madhe e popullsisë rurale. Kjo shpjegohet me zhvillimin dhe modernizimin shumë të ngadaltë të bujqësisë, me nivelin ende të ulët të shkollës bujqësore krahasimisht me kërkesat e tregut

Figura 2.2: Nxënësit në arsimin profesional sipas profileve



Burimi: ESK 2006

të punës por edhe me një tendencë të përgjithshme të të rinjve për profesione, që krijojnë më shumë mundësi punësimi në qytet se sa në fshat.

Gjatë këtyre viteve janë bërë përpjekje për të përshtatur më mirë arsimin profesional me kërkesat e tregut të punës, duke bërë përmirësime në strukturat e lëndeve dhe përmirësuar kurrikulat me synimin e rritjes së mundësive të të rinjve pas mbarimit të shkollës për tu punësuar ose për të vijuar studimet universitare. Janë përcaktuar 12 fusha profesionale dhe janë zhvilluar kurrikulat për 60 profile[65]. I është kushtuar kujdes për të siguruar më shumë qasje të shkollave në komunitet dhe në ekonomi, duke hapur llogari bankare të vetat që ato, në bashkëpunim me sektorin privat dhe komunitetin, të zbatojnë projekte për të siguruar vetë të ardhura dhe t'i përdorin ato për përmirësimin e kushteve në shkollë.

Me gjithë përparimet e derisotme, sistemi i arsimit profesional në Kosovë ka ende disa mangësi të dukshme:

(i) Sistemi i arsimit profesional vazhdon të jetë një sistem tradicional i fokusuar më shumë në inpute se sa në rezultatet e mësimit;
(ii) Lidhjet me tregun e punës janë ende të dobëta dhe roli i partnerëve socialë në të është i pandjeshëm. Këtu ndihet mungesa e dialogut me sektorin privat.
(iii) Arsimi profesional financohet kryesisht nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe deri tani nuk ka të dhëna për burime të tjera financimi nga fonde private apo partneritete të ndryshme;
(iv) Shkollat profesionale private të liçensuara, që financohen nga tarifat e studentëve, janë të pakta në numër dhe kontributi i sektorit privat është mjaft i ulët, ngaqë përgjithësisht arsimi profesional nuk është tërheqës për këtë sektor;
(v) Nuk ka ende institucione për aftësimin profesional të nxënësve, që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm, që t'u krijojë atyre lehtësi për të hyrë në tregun e punës. Shkollat e larta të arsimit profesional, që shërbenin si të tilla, duke ofruar kurse 2-vjeçare, janë transformuar në fakultete 3-vjeçare të shkencave të aplikuara në Universitetin e Prishtinës dhe përgatisin studentë të diplomuar si çdo fakultet tjetër i arsimit të lartë[66];
(vi) Arsimimi dhe aftësimi profesional i të rriturve është shumë i kufizuar. Kuadri ligjor lejon shkollat e mesme profesionale të zhvillojnë kurse për të rriturit me pagesë, por këto shërbejnë më shumë si mundësi për të marrë një diplomë nga ana e nxënësve që kanë ndërprerë shkollën më parë se sa si mundësi e të rinjve për t'u përgatitur për profile të ndryshme[67].

Kutiza 2.5 ***Politikat Europiane të Kualifikimeve***

Në vitin 2000, mbledhja në Lisbonë e Këshillit të Europës u caktoi si objektiv shndërrimin deri në vitin 2010 të ekonomisë së Bashkimit Europian në ekonominë më konkurruese e më dinamike në botë, të bazuar në njohuri. Duke u nisur nga parashikimi se në vitin 2010 vetëm 15% e kërkesave për vende pune në Bashkimin Evropian do të jenë për persona me arsim bazë dhe rreth 85% për ata që kanë kualifikime të nivelit të arsimit të mesëm dhe universitar, reformimi i sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) u konsiderua si një masë prioritare për të përmbushur këtë objektiv. Si prioritete kryesore u përcaktuan investimi për rritjen e cilësisë së AAP-së, rritja e numrit të profesionistëve me kualifikim të lartë, nxitja e aftësimit profesional të vazhdueshëm, që është edhe hallka më e dobët në procesin e të nxënit gjatë gjithë jetës, trajnimi i fuqisë punëtore me kualifikim të ulët dhe rritja e lëvizshmërisë së fuqisë punëtore në tregun europian të punës. Procesi i Bolonjës dhe ai i Kopenhagenit ishin dy instrumentet për reformimin përkatësisht të arsimit universitar dhe të AAP-së. Krijimi i Kornizës Europiane të Kualifikimeve u përcaktua si një masë e domosdoshme me objektiv lehtësimin e transferimit dhe njohjes së kualifikimeve. Korniza ka funksion të jetë si një pikë e përbashkët reference për rezultatet e të nxënit, nivelin e kompetencave të fituara dhe për sigurimin e cilësisë, si dhe të krijojë mundësi për krahasimin e rezultateve të të nxënit. Për këtë qëllim ajo ka 8 nivele reference të bazuara në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e veçanta të secilit nivel. Korniza Europiane e Kualifikimeve është neutrale ndaj Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, por përputhja ose harmonizimi i tyre është në të mirë të secilit vend.

2.2 Arsimi i lartë

Pjesëmarrje e ulët e të rinjve

Universiteti i Prishtinës është universiteti kryesor në Kosovë, i themeluar në vitin 1970. Aty zhvillohet mësimi në 17 fakultete, që përgatisin specialistë në 57 fusha. Studime pasuniversitare ofrojnë 14 fakultete në rreth 30 fusha. Vitet e fundit është ngritur, gjithashtu, një universitet në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut dhe rreth 10 universitete private në Prishtinë.

Numri i studentëve në arsimin e lartë ka ndryshuar mjaft sipas viteve (shih Figurën 2.3). Ai ka pasur një zvogëlim të madh gjatë periudhës 1990-1999, që përkon me periudhën e funksionimit të sistemit paralel të arsimit. Më pas, numri i studentëve është rritur dukshëm çdo vit.

Në vitin shkollor 2003-2004, numri i studentëve të rregjistruar arriti në rreth 25200 studentë, apo rreth 1440 studentë për 100 mijë banorë. Ky tregues është sa

Figura 2.3: Numri i studentëve sipas viteve[68]



¼ e Sllovenisë, më pak se ½ e Maqedonisë dhe sa 2/3 e Shqipërisë. Ky numër përfaqëson, gjithashtu, rreth 12% të popullsisë së grupmoshës 18-25 vjeç në po këtë vit, duke qënë një normë përfshirjeje në arsimin e lartë rreth 4 herë më e ulët se ajo e vendeve të OECD-së[69].

Figura 2.4: Pranimet në universitet



A janë të bazuara pranimet në universitet në njohuritë e kandidatëve?

Norma e ulët e përfshirjes në arsimin e lartë, në një kohë kur ka evidencë të qartë të rritjes së interesit të të rinjve për tu regjistruar në universitet, lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin e kufizuar të institucioneve të arsimit të lartë. Numri i aplikuesve për një vend të lirë në Universitetin e Prishtinës është mesatarisht tri herë më i madh se numri i studentëve të pranuar, gjë që tregon qartë se 2/3 e numrit të të rinjve që dëshirojnë të vijojnë studimet në arsimin e lartë në Universitetin e Prishtinës janë të privuar nga kjo mundësi. Ky kufizim kaq i madh ka krijuar kushte të favorshme për subjektivizëm në pranimin e kandidatëve që regjistrohen në universitet. Mesatarisht, rreth 53.8% e të rinjve mendojnë se pranimet në universitet nuk janë të bazuara tek njohuritë e kandidatëve (shih Figurën 2.4). Këtë mendim e kanë rreth 84% e të rinjve të komunitetit serb dhe rreth 80% e të rinjve të komunitetit RAE[70].

Figura 2.5: Pranimet me pagesa informale



A ofrojnë rushfet studentët për tu pranuar në universitet?

Të rinjtë mendojnë, gjithashtu, se shpesh herë për tu pranuar në universitet duhet të paguash ryshfet dhe këtë perceptim e kanë rreth 57.2% e tyre (shih Figurën 2.5). Por përqindja e të rinjve të komunitetit serbë dhe RAE që e kanë këtë perceptim është shumë më e vogël, përkatësisht rreth 28% dhe 34% e të rinjve të pyetur[71]. Të rinjtë shprehen se edhe pse vitet e fundit ka disa përmirësime në procesin e pranimeve në universitet, favoret vazhdojnë të jenë problem dhe se e keqja më e madhe është se studentët e pranuar me favore vazhdojnë t'i gëzojnë ato edhe gjatë viteve të universitetit, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e studentëve të diplomuar[72].

Mundësitë e pakta financiare të familjeve janë një tjetër kufizim për të rinjtë me banim jashtë Prishtinës për të ndjekur mësimet në Universitetin e Prishtinës. Prindërit shprehen se mund të përballojnë financiarisht shkollimin e fëmijëve deri në mbarim të shkollës së mesme. Më pas kjo bëhet shumë e vështirë sepse të ardhurat e tyre nuk i kalojnë 120 Euro në muaj dhe nuk mund të përballojnë shpenzimet që i duhen një studenti në Prishtinë[73]

Numri i të diplomuarve çdo vit në arsimin e lartë ka pësuar gjithashtu luhatje të mëdha si rrjedhojë e vështirë-

Kutiza 2.6 ***Procesi i Bolonjës***

Procesi i Bolonjës për reformimin e arsimit të lartë mbështetet në këto parime kryesore: (i) Përshtatja e sistemit krahasues të gradave shkencore, në mënyrë që ato të njihen lehtë kudo; (ii) Adaptimi i një sistemi të bazuar në dy cikle kryesore universitare (sistemi 3+2) që përfundon me diplomën *Bachelor* për ciklin e parë dhe me gradën *Master* për ciklin e dytë; dhe (iii) vendosja e sistemit të krediteve në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve, si një instrument i përshtatshëm për lëvizjen e lirë të studentëve nga një universitet në tjetrin.

sive për të ndjekur arsimin e lartë gjatë sistemit paralel të arsimit. Numri i të diplomuarve u zvogëlua gjatë kësaj periudhe nga rreth 2200 të diplomuar në vit që ishte gjatë periudhës 1989-1990 në rreth 1000 të diplomuar në vit.

Hyrja gjatë kësaj periudhe në tregun e punës e rreth 10 mijë të rinjve të diplomuar më pak dhe cilësia e ulët e arsimimit të atyre që u diplomuan në sistemin paralel kanë pasur ndikim të rëndësishëm në cilësinë e forcave të punës së Kosovës. Prandaj kjo është cilësuar edhe si "periudha e gjeneratës së humbur"[74]. Aktualisht popullsia e moshës 25-64 vjeç në Kosovë është me nivel më të ulët arsimor krahasuar me të gjitha vendet e rajonit sepse vetëm rreth 13% e saj është me arsim të lartë, apo 18% e meshkujve dhe 8% e femrave[75].

Sfidat e reformimit

Vizioni i ri për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë është integrimi i tij në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik[76]. Për përmbushjen e këtij misioni, arsimi i lartë përballet me dy sfida kryesore:

(i) ***Rritja e kapacitetit***, për t'i krijuar të rinjve mundësi më të mëdha për vazhdimin e studimeve universitare në kushte të një infrastrukture të plotë e funksionale dhe për të kompensuar me shpejtësi numrin e pakët të të diplomuarve gjatë më shumë se një dekade;

(ii) ***Riaftësimi i thellë i përmbajtjes dhe përmirësimi rrënjësor i cilësisë,*** për t'i përshtatur ato me kërkesat e reja të tregut të punës dhe integruar në sistemin europian të arsimit të lartë, në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës.

Kutiza 2.7 ***"…Marrëdhëniet student-pedagog***

"…Marrëdhëniet student-pedagog duhet të ndryshojnë. Studentët duhet të kenë më shumë hapësira për të shprehur mendimet dhe komentet e tyre për lëndën, sugjerime mbi procesin mësimor dhe kushtet e mësimit. Ne ndiejmë nevojën të mësojmë gjëra që i shërbejnë praktikës së punës, sepse nuk jemi konkurrues në tregun e punës. Ne studiojmë shumë gjëra në fakultetin e ekonomisë, por na duket se pak prej tyre janë të aplikueshme në praktikë. Universitetet private e realizojnë më mirë këtë gjë. Studentët aty mësojnë edhe si të përgatisin një CV dhe si të përgjigjen në një intervistë për t'u punësuar, të cilat janë gjëra që nuk mësohen në universitetin publik…".- *Nga tryeza e debatit me studentët e Universitetit të Prishtinës, gusht 2006.*

Domosdoshmëria e rritjes së cilësisë dhe e përshtatjes së shpejtë me kërkesat e tregut të punës lidhet drejtpërdrejt me mundësitë e studentëve të diplomuar për tu punësuar. Përfaqësues të komunitetit të biznesit shprehen se në përgjithësi cilësia e studentëve të sotëm nuk i përgjigjet sa duhet kërkesave të biznesit. Kjo vjen edhe sepse niveli i vetë pedagogëve nuk është i kënaqshëm. Ndërsa në universitetet private po vihet re tendenca e interesimit më shumë për numrin e studentëve se sa për cilësinë e tyre[77].

Suksesi i përmbushjes së këtij misioni kushtëzohet mjaft nga përmirësimi i menaxhimit të arsimit të lartë dhe sigurimi i burimeve financiare të nevojshme.

Studimet jashtë Kosovës

Një numër i pa evidentuar saktë studentësh e ndjekin arsimin e lartë jashtë Kosovës, shumica e të cilëve në universitetet e vendeve perëndimore. Perceptimi i të rinjve është se në përzgjedhjen e tyre bëhen favore dhe ka diskriminim. Këtë mendim e shprehin mesatarisht rreth 56% e të rinjve të pyetur.

Figura 2.6: Cilësia e përgatitjes së studentëve



A janë më të përgatitur studentët e diplomuar jashtë Kosovës se ata të UP?

Figura 2.7: Mundësia për tu punësuar



A kanë më shumë shansë për tu punësuar të diplomuarit jashtë?

Por shumica e të rinjve mendojnë se studentët e diplomuar jashtë janë më të përgatitur se ata që diplomohen në Universitetin e Prishtinës dhe se kanë më shumë mundësi për t'u punësuar në Kosovë (shih Figurën 2.6 dhe 2.7)[78].

Minoritetet, integrim apo ndarje

Kutiza 2.8 ***Lehtësi për arsimin e minoriteteve***

Që prej vitit 1999 janë marrë një sërë masash që mundësojnë arsimimin e minoriteteve. Duke filluar nga viti 1999 është mundësuar mësimi në gjuhën boshnjake në arsimin fillor dhe të mesëm, duke siguruar edhe tekstet e nevojshme nga Bosnje dhe Hercegovina dhe duke ia shpërndarë ato falas nxënësve. Në Shtator 2005 janë shpallur tekstet për klasën e 9-të për mësimin në gjuhën boshnjake në bazë të plan programeve të reja mësimore të Kosovës dhe janë shtypur shtatë tekste në gjuhën turke nga lëndët e grupit kombëtar. Në vitin shkollor 2002-2003 është hapur Fakulteti i Biznesit në Pejë në gjuhën Boshnjake. Në vitin shkollor 2003-2004 është hapur Fakulteti i Edukimit ne Prizren në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke. Prej vitit 2004-2005, është lehtësuar regjistrimi në Universitetin e Prishtinës nëpërmjet vendosjes së kuotave për minoritetin boshnjak, turk dhe RAE.

Mësimi në Kosovë zhvillohet në 5 gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe kroate. Minoritetet ndjekin mësimin në gjuhën e zonës në të cilën banojnë. Si rrjedhim, pjesa më e madhe e tyre ndjek mësimin në gjuhën shqipe dhe një numër i vogël në gjuhën serbe dhe boshnjake. Komuniteti Serb nuk është i integruar në sistemin arsimor të Kosovës. Të dhënat e fundit për arsimin e minoritetit serb i përkasin vitit akademik 2003-2004 dhe pas kësaj periudhe shkollat e këtij minoriteti nuk raportojnë të dhëna tek institucionet e Kosovës[79].

Universiteti i Mitrovicës është themeluar në vitin 2001. Ai kaloi një periudhë të begatë, për shkak të investimeve të konsiderueshme për të ngritur infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e tij dhe për një sërë reformash arsimore. Kjo zgjati deri në vitin 2004, vit në të cilin Universiteti i Mitrovicës duhej të integrohej në kornizën ligjore të Kosovës. Por, në fakt, po këtë vit, Universiteti i Mitrovicës shkëputi çdo lloj lidhje me Institucionet arsimore dhe Qeverinë e Kosovës. Prej asaj kohe, ky universitet vuan pasojat e izolimit ndërkombëtar. Sot ai ka 4-5 mijë studentë dhe numri i fakulteteve është ulur nga 14 në 10 me synimin që më pas të arrijnë deri në 6 fakultete. Ai financohet nga Qeveria e Serbisë dhe çdo lidhje institucionale e mban me Beogradin. Ndërkohë, të rinjtë e komunitetit serb nuk studjojnë në Universitetin e Prishtinës.

Universiteti i Mitrovicës është përballë me nevojën për një zgjidhje të shpejtë e të qëndrueshme, që të sigurojë integrimin e tij në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës, duke respektuar vendimin e vetë minoritetit Serb dhe ruajtur marrëdhëniet me Serbinë. Kthimi i tij në Universitet publik Kosovar, që funksionon sipas kornizës ligjore të Kosovës me shkallën e autonomisë që kjo siguron, ruajtja e statusit të tanishëm, duke u trajtuar si institucion privat i financuar nga donatorë (në këtë rat Serbia) ose konsiderimi si universitet publik me një shkallë shumë të lartë autonomie, janë disa nga zgjidhjet e mundshme për këtë universitet[80].

Në kushtet e burimeve të kufizuara financiare të Kosovës dhe të nevojave të mëdha buxhetore të arsimit të lartë, është e nevojshme që kjo zgjidhje të udhëhiqet edhe nga efiçienca e shpenzimeve, duke konsideruar se Universiteti i Mitrovicës sot kushton po aq sa Universiteti i Prishtinës, ndërsa i shërben vetëm 7-8% të popullsisë.

Për tju përgjigjur më mirë interesave dhe kërkesave të të rinjve minoritarë, arsimi i lartë, sikundër edhe i gjithë sistemi arsimor i Kosovës, është e nevojshme të zhvillohet duke u orientuar më shumë drejt integrimit se sa ndarjes, sigurisht duke respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e minoriteteve. Kjo do t'i shërbente më mirë se deri tani përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike, rritjes së kohezionit social, dhe krijimit të mundësive të barabarta të të rinjve për tu punësuar në të gjitha nivelet e administratës publike dhe në sektorin privat, pavarësisht përkatësisë etnike.

2.3 Investimi për arsimimin e të rinjve

Shpenzimet për arsimin

Sistemi i arsimit në Kosovë financohet nga gjashtë burime: (i) Buxheti qendror përfshirë transferet në komuna; (ii) Donatorët ndërkombëtarë nëpërmjet Programit të Investimeve Publike dhe fondeve të tjera për projekte (iii) Kontributet e prindërve, (iv) Të ardhurat nga tarifat e regjistrimit të nxënësve dhe studentëve; (v) Transferet nga Beogradi për shkollat ku studiojnë pjesëtarët e pakicës serbe të Kosovës dhe (vi) burimi i gjashtë janë të hyrat vetanake të komunave. Buxheti i konsoliduar i Kosovës është sot burimi kryesor i financimit të sistemit të arsimit në Kosovë, i cili mbulon 97.2% të shpenzimeve. Burimi i këtyre fondeve për rreth 99% të këtij financimi është nga të ardhurat e mbledhura në nivel qendror dhe vetëm 1% vijnë nga të ardhurat vetanake të komunave[81].

Shpenzimet e përgjithshme për arsimin gjatë periudhës 2000-2004 nuk kanë pasur ndonjë rritje të dukshme. Në vitin 2004 ato kanë arritur në nivelin e rreth 108 milion Euro (shih Tabelën 2.7). Në këto vlera kanë ndikuar dy faktorë të rëndësishëm:

Tabela 2.7: Shpenzimet për arsimin sipas viteve (në milion Euro dhe në %)

Burimi i financimit	Shpenzimet sipas viteve				
	2000	2001	2002	2003	2004
Buxheti i konsoliduar i Kosovës%	55.74	59.35	69.47	85.19	105.16
Grantet nga Donatorë %		1.79	1.61	0.60	0.71
Programi i Investimeve Publike%	40.61	26.63	24.56	9.87	2.15
Gjithsej%	96.35	87.76	95.64	95.66	108.02
Në përqindje të PBB%	5.51	3.62	3.85	3.83	4.25
Buxheti i konsoliduar i Kosovës%	3.19	2.45	2.8	3.41	4.14
Grantet nga Donatorë%		0.07	0.06	0.02	0.03
Programi i Investimeve Publike%	2.32	1.10	0.99	0.40	0.08

Burimi: MEF, 2006

(i) Zvogëlimi drastik i kontributit të donatorëve ndërkombëtarë. Ndihma e tyre në vitin 2004 arriti në vetëm 2.15 milion Euro apo rreth 20 herë më e vogël se ajo e vitit 2000. Kjo ka lidhje me faktin se kontributi i donatorëve ndërkombëtarë u fokusua në eliminimin e pasojave të luftës, duke i dhënë rëndësi investimeve për krijimin e infrastrukturave shkollore;

(ii) Rritja e madhe e kontributit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Në vitin 2004 ky kontribut ishte rreth 105 milion Euro apo rreth 2 herë më i madh se në vitin 2000, duke balancuar pakësimin e kontributit të donatorëve ndërkombëtarë.

Megjithë këtë rritje të kontributit të buxhetit të konsoliduar, shkalla e prioritetit, që Qeveria e Kosovës i ka dhënë zhvillimit të sistemit arsimor, është një çështje e debatueshme sepse, në realitet, pesha e tyre në shpenzimet e përgjithshme qeveritare është ulur nga rreth 20%, që ishte në vitin 2000, në rreth 14% në vitin 2004. Sigurisht që kjo ulje është rezultat i nevojës së përballimit, nga ana e buxhetit të Kosovës, të shpenzimeve të tjera prioritare që lidhen me zbatimin e shumë reformave për përmbushjen e standardeve, por, në këndvështrimin e riaftesimit të sistemit të arsimit, ky është një zvogëlim i investimit të Qeverisë së Kosovës për të rinjtë. Por gjithashtu duhet te mirret parasysh fakti se në raport me vitin 2000 është shtuar numri i sektorëve qeveritarë që financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Shpenzimet për arsimin në raport me PBB në vitin 2004 u ulën në 4.25% kundrejt 5.51% që ishin në vitin 2000 (shih Tabelën 2.7). Ky është një nivel i kënaqshëm shpenzimesh krahasuar me vendet e anëtarësuara vitet e fundit në Bashkimin Europian[82], të cilat shpenzojnë për arsimin mesatarisht 4% deri në 5% të PBB-së në vit. Edhe pesha e shpenzimeve për arsimin ndaj shpenzimeve gjithsej të buxhetit publik, që është në nivelin e rreth 14%, është e kënaqshme kur krahasohet me mesataren e këtyre vendeve, që është rreth 13%. Megjithatë, për shkak se Kosova ka shkallën më të madhe të popullatës së moshës shkollore në Europë, Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 parasheh që pjesëmarrja e shpenzimeve për këto nivele arsimi të rritet në 16% deri në vitin 2009.

Por çështja është se objektivi i këtyre shpenzimeve nuk është aspak i njejtë. Ndërsa në këto vende investohet për të ruajtur e përmirësuar nivelin e një sistemi arsimor qindravjeçar e të konsoliduar, në Kosovë bëhet fjalë për të ngritur një sistem thuajse tërësisht të ri. Po kështu, financimet nga buxheti i shtetit në këto vende janë vetëm një pjesë e shpenzimeve të sistemit arsimor sepse atje funksionojnë skema financimesh nga partneritete publike-private apo sistemi jo publik i arsimit. Në Kosovë këto janë në hapat e para dhe bëhet fjalë vetëm për kontribute shumë modeste.

Përballë nevojave të mëdha të riaftesimit të plotë të sistemit arsimor të Kosovës, niveli i sotëm i shpenzimeve duket se është i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur kërkesave të tij prioritare.

Financim mbijetese apo zhvillimi

Analiza e strukturës së shpenzimeve në sektorin e arsimit parauniversitar tregon se rreth 95.6% e tyre janë për shpenzime operative (shih Figurën 2.8 dhe Tabelën 2.8). Brenda shpenzimeve operative, rreth 86.6% i zënë pagat e punonjësve të arsimit.

Në vendet që janë anëtarësuar në Bashkimin Europian vitet e fundit, shpenzimet operative zënë mesatarisht 92.5% të shpenzimeve të përgjithshme dhe, brenda tyre, pagat

Figura 2.8: Struktura e shpenzimeve të arsimit



Burimi: MEF, 2005

zënë mesatarisht rreth 72.9%. Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë investimet kapitale në sistemin arsimor janë mjaft të ulëta, në një kohë që nevojat për zgjerimin e infrastrukturës shkollore janë të mëdha, veçanërisht në zonat e mbipopulluara urbane.

Megjithëse shumica e fondeve shpenzohet për të mbajtur në punë punonjësit e sistemit të arsimit, pagat e tyre janë mjaft të ulta, gjë që rezulton me pasoja negative në motivimin e tyre. Veçanërisht i ulët është motivimi i pedagogëve të arsimit të lartë, pjesa e pagave të të cilëve në shpenzimet operative zë vetëm 48.9% (shih Tabelën 2.8). Kjo gjë ka sjellë fenomenin e punësimit të njëkohshëm të tyre edhe në dy apo tri punë të tjera, duke ndikuar negativisht në cilësinë e angazhimit të tyre ne Universitetin e Prishtinës dhe duke ulur pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë kërkimore shkencore[83].

Shpenzimet për të ndërmarrë reforma rrënjësore për të rritur cilësinë e arsimit dhe forcimin e kapaciteteve të mësimdhënies janë shumë të vogla. Kjo strukturë shpenzimesh ngjanë më shumë me një financim mbijetese se sa me një financim zhvillimi.

Tabela 2.8: Struktura e shpenzimeve publike për arsimin

	Shpenzimet operative %	Shpenzimet kapitale %	Pagat në % të shpenzimeve operative	Shpenzime tjera operative si % e shpenzimeve operative
Treguesit e arsimit parauniversitar				
Kosova (2004)	95.6	4.4	86.6	13.4
BE-15 (2002)	92.7	7.3	81.5	18.5
Vendet e posa anëtarësuara në BE (2004)	92.5	7.6	72.9	27.1
Treguesit e arsimit të lartë				
Kosova (2004)	82.1	17.9	48.9	51.1
BE-15 (2002)	88.6	11.4	68.2	31.8
Vendet e posa anëtarësuara në BE (2004)	89.0	11.0	56.9	43.1

Burimi: MEF, OECD 2005

Shpenzimet sipas niveleve të arsimit

Në tabelën 2.9 krahasohen shpenzimet e Kosovës për nivele të ndryshme të arsimit me ato të vendeve në tranzicion dhe të vendeve të përparuara perëndimore. Siç shihet, Kosova shpenzon 79.7% të buxhetit të sistemit të arsimit për arsimin parauniversitar, që është një tregues më i lartë krahasimisht me këto vende, ku ky tregues është përkatësisht 76.6% dhe 71.4%. Po kështu, pjesa e shpenzimeve për arsimin e lartë është shumë më e ulët se e vendeve në fjalë.

Tabela 2.9: Shpërndarja e shpenzimeve sipas niveleve arsimore, 2003

	Parashkollor dhe i detyrueshëm	I mesëm	I lartë
Kosova		79.7	14.5
Vendet në tranzicion	32.7	43.9	19.4
Vende me ritme të larta rritjeje	35.8	35.6	24.5

Burimi: UNESCO, 2005

Në Kosovë, shpenzimet për arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm nuk raportohen të ndara. Njësimi u bë në vitin 2002, kur përgjegjësia për arsimin parauniversitar i kaloi komunave. Kjo mënyrë evidentimi shpenzimesh nuk i jep mundësi institucioneve për të analizuar siç duhet nevojat dhe mbështetjen për secilin nivel arsimor dhe nuk përputhet me standardet që përdorin sot shumica e vendeve të tjera.

Efiçienca e shpenzimeve

Përdorimi i frytshëm i shpenzimeve publike për arsimin në Kosovë është një çështje e ditës, e cila merr rëndësi të veçantë në kushtet e burimeve të kufizuara të financimit.

Kostoja për nxënës në arsimin parauniversitar në Kosovë variron nga 150 në 200 Euro në zonat e populluara kryesisht nga popullsia shqiptare. Ajo rritet në 250-450 Euro në komunat e vogla, disa prej të cilave të populluara kryesisht nga minoriteti serb. Numri i nxënësve për mësues është ai që ka ndikim përcaktues në këtë kosto. Standardet e sotme për efekt financimi janë 19:1 për shkollat e shumicës shqiptare dhe 14:1 për shkollat në zonat e pakicave etnike. Ndryshime të mëdha ka edhe në raportet nxënës/staf arsimor mbështetës në shkollat e shumicës shqiptare me ato të pakicave etnike. Por këta janë vetëm tregues mesatarë dhe vlerat e tyre ndryshojnë shumë midis zonave urbane dhe atyre rurale, madje edhe nga shkolla në shkollë.

Këto të dhëna janë një nga aspektet e problemit të efiçiencës së sistemit arsimor të Kosovës. Aspekte të tjera janë thellimi i decentralizimit të arsimit, rritja e autonomisë së institucioneve arsimore dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre menaxhuese.

Në periudhën 1974-1990 sistemi arsimor ka qënë relativisht i decentralizuar. Në përgjegjësi të shkollës ishin mjedisi, cilësia e mësimdhënies etj. dhe shkolla e menaxhonte vetë buxhetin. Në përgjegjësi të komunave ishin sistemi parashkollor dhe fillor, ndërsa shkollat e mesme vareshin nga niveli qëndror. Në vitin 2000 u krijua Departamenti për Arsim dhe Shkencë dhe sistemi filloi të centralizohej. Shkollave iu hoq e drejta e menaxhimit financiar, përgjegjësia e emërimit të drejtorëve të shkollave i kaloi një komiteti me shumicë anëtarësh nga MASHT, ndërsa emërimi i mësimdhënësve bëhet nga drejtoritë komunale të arsimit. Shkollat nuk kanë përgjegjësi konkrete e të drejtpërdrejta për cilësinë e shkollimit. Në aspektin financiar, komunave nuk u transferohet buxheti i llogaritur në bazë të numrit të nxënësve, përbërjes etnike dhe dendësisë së popullsisë. Në këto kushte, si shkollat ashtu edhe komunat nuk janë të nxitura për rritjen e efiçiencës së shpenzimeve.

2.4 Politika dhe masa prioritare

Përgjegjësia për arsimimin e të rinjve

Dituria është pasqyrë e emancipimit të përgjithshëm shoqëror të një vendi. Përpjekjet që bëhen për të rritur shkallën e arsimimit janë para së gjithash përpjekje për përparimin e atij vendi. Prandaj çështja e arsimit nuk duhet konsideruar thjesht si përgatitje e të rinjve për tregun e punës dhe si përgjegjësi e tyre, e familjeve dhe e disa institucioneve për t'ia lehtësuar atyre hyrjen e suksesshme në këtë treg. Arsimimi i të rinjve është një çështje primare dhe kërkon ndërgjegjësimin e të gjithë shoqërisë dhe anagazhimin e plotë të strukturave qeverisëse për të përmbushur përgjegjësinë që kanë për tj'u garantuar të rinjve të drejtën dhe mundësitë për t'u arsimuar.

Numër i madh strategjishë për arsimin

Strategjia e arsimit parauniversitar 2007-2017; Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015; Strategjia për arsimin e popullsisë rurale; Strategjia e çështjeve gjinore; Politika Rinore e Kosovës; dhe Strategjia dhe plani i zhvillimit të Kosovës 2007-2013 janë të gjitha dokumente strategjikë të përgatitura vitet e fundit posaçërisht për arsimin ose që përmbajnë kapituj të plotë mbi arsimin. Midis këtyre dokumenteve ka mjaft ndryshime, nganjëherë edhe thelbësore e konceptuale. Në përgjithësi mungon koordinimi midis tyre dhe efekti i politikave që propozohen të vihen në jetë është, në shumicën e rasteve, i pamatshëm. Më shumë se sa për strategji të tjera, reforma e sistemit të arsimit ka nevojë për vendosjen e një renditjeje të masave prioritare, të treguesve se deri ku do të arrihet çdo vit dhe të kostos financiare përkatëse. Përzgjedhja duhet të bëhet me pëlqimin e shumicës së specialistëve të fushës dhe me mirëkuptimin e të gjitha institucioneve përkatëse për të qënë e zbatueshme nga të gjithë.

Cilësia dhe përfshirja

Prioritetet e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor në Kosovë nuk janë të njëjta. Por sigurimi i cilësisë së arsimimit të të rinjve është prioriteti i përbashkët i tyre. Megjithëse në dukje përfshirja nuk është prioritare për arsimin e detyrueshëm, ajo kërkon, gjithashtu, vemendje të madhe për të garantuar përfshirje të barabartë e me trajtim të njëjtë për fëmijët e të gjitha komuniteteve, veçanërisht për komunitetin RAE.

Cilësia dhe përfshirja janë prioritete për arsimin e mesëm dhe të lartë. Riaftesimi i thellë i përmbajtjes për ta përshtatur me kërkesat e tregut të ri të punës, harmonizimi i kurrikulave me ato të vendeve të përparuara europiane, dhe rritja e qasjes së të rinjve, nëpërmjet zgjerimit të hapësirave shkollore dhe një shpërndarjeje më optimale të shkollave të mesme, janë masa prioritare për përmirësimin e treguesve në këto dy nivele të sistemit arsimor.

Reforma gjithëpërfshirëse

Riaftesimi i sistemit të arsimit nuk duhet parë si detyrë vetëm e institucioneve arsimore dhe e mësuesve e pedagogëve. Aktorë të tjerë po kaq të rëndësishëm duhet të përfshihen në këtë process: të rinjtë të konsiderohen si aktorë kryesorë dhe si pjesa më dinamike e riaftesimit, ndësa komuniteti i biznesit të jetë pjesë e vlerësimit të frytshmërisë së metodave e kurrikulave që propozohen.

Sistemi i vlerësimit të cilësisë

Vlerësimi i cilësisë në sistemin e arsimit duhet të institucionalizohet. Ngritja e një Qendre Kombëtare Vlerësi-

mi do të ishte një zgjidhje efiçiente, afatgjatë dhe e qëndrueshme për hartimin dhe administrimin e testeve dhe instrumenteve të tjerë të vlerësimit të nxënësve, kualifikimeve të mësuesve dhe specialistëve të arsimit në fushën e vlerësimit, dhe botimin e raporteve dhe rezultateve të vlerësimeve dhe testeve të maturës, duke garantuar vlerësim transparent e të njësuar në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Me këtë rast, vlerësimi i nxënësve apo studentëve të Kosovës do të mund të bëhej edhe përmes Programit per Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA). Po i njejti program do të verifikonte të arriturat e studentëve të Kosovës kundrejtë atyre të vendeve të rajonit, dhe të njëjtat metoda do të mund të përdoreshin më pas edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës si mjet verifikimi se reformat e inicuara kanë pasur ndikim në të nxënit e dijes.

Kuadri Kombëtar i Kualifikimeve

Edhe pse draft-ligji për krijimin e Kornizës Kombëtare për Kualifikime të harmonizuar me Kornizën Europiane të Kualifikimeve, është në procedurë e siper, zbatimi i tij në praktikë do të ndihmonte koordinimin e të gjitha sistemeve të arsimit e të kualifikimit të të rinjve, në shkollat publike e private, pavarësisht shpërndarjes gjeografike të institucioneve përkatëse, si dhe vendosjen e një sistemi të njësuar e transparent standardesh cilësie dhe vlerësimi. Kjo do të krijonte kushte për krahasueshmërinë e kompetencave në tregun e punës, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Mësimi formal dhe joformal

Koncepti i të mesuarit jashtë sistemit arsimor formal duhet të fillojë të konsiderohet nga institucionet e arsimit në Kosovë, për t'i paraprirë përfshirjes në procesin e Kopenhagenit, ndërgjegjësimit gradual të publikut, grupeve të interesit dhe niveleve vendimmarrëse, si dhe përgatitjes së kuadrit ligjor të nevojshëm, që i hap rrugë vlefshmërisë së kësaj mënyre të nxëni dhe trajtimit të barabartë e të njëjtë të të gjithë individëve. Kjo do të ndihmojë në zbutjen e kufizimeve që kanë sot të rinjtë për të fituar njohuritë e nevojshme nëpërmjet sistemit formal të arsimit, të cilat lidhen me mungesën e kapaciteteve të institucioneve arsimore apo me pamundësitë financiare të të rinjve.
Por nuk duhet anashkaluar edhe lidhshmërinë midis të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe sistemit të trajnimit të të riturve, por edhe mungesën e kapaciteteve që kanë institucionet e Kosovës në përmirësimin e ndikimit te ketij koncepti.

Rritja e financimit dhe e efiçiencës

Rritja e pjesës së financimeve, që ka lidhje të drejtpërdrejt me forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe motivimin e tyre, si dhe me masa të tjera që ndikojnë në cilësinë e mësimit, duhen konsideruar më shumë se deri më sot në përgatitjen e projekt buxheteve afatmesme.

Në kushtet e mundësive të kufizuara të financimit nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, nxitja e partneritetit publik-privat është, gjithashtu, një masë me shumë mundësi për sukses. Në këtë rast është i nevojshëm një kuadër ligjor i posaçëm, që t'i bëjë të dy palët të interesuara për ta vendosur këtë bashkëpunim.

Studimi i shpërndarjes optimale të shkollave fillore e të mesme dhe i ngarkesës së mësuesve për t'i përafruar me tregues më optimalë të shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore dhe të infrastrukturës mund të çojë në një rishpërndarje më efiçiente të burimeve ekzistuese financiare.

Mundësi për plotësimin e dijeve

Për nxënësit që braktisin shkollën është e nevojshme të parashikohen sisteme kursesh, që plotësojnë njohuritë, për t'i krijuar atyre *shansin e dytë* për të studjuar dhe për të hyrë në tregun e punës. Në mënyrë të veçantë ky sistem është i domosdoshëm për të rinjtë që kanë filluar shkollën në sistemin paralel dhe nuk kanë nivelin e duhur të njohurive për të vazhduar studime të mëtejshme. Ky është i nevojshëm, gjithashtu, për të rinjtë e komunitetit RAE, të cilët tregojnë afinitet të lartë të braktisjes së shkollimit dhe jane të ekspozuar ndaj analfabetizmit ose i kanë shumë të kufizuara mundësitë për të vazhduar ciklin e plotë të studimeve, për shkak të nivelit të ulët të nxënies në arsimin fillor.

Kapitulli 3

Nga Shkolla në Punë

3 Nga Shkolla në Punë

"..Ne jemi ata që duhet të ndryshojmë Kosovën, jo Kosova ne. Ne nuk duhet ta lëmë vendin në kërkim të punësimit pikërisht kur ai ka nevojë për ne. Tani po ikën rinia, gjaku dhe truri i Kosovës, kur Kosova ka nevojë të ndërtohet prej saj. Bëni gjithcka që të rritet punësimi dhe ne të mos largohemi nga Kosova!...."[84]

3.1 Tranzicion i vështirë

Rritje e interesit për t'u shkolluar

Të rinjtë janë në moshën e kalimit nga shkolla në tregun e punës. Në mënyrë të përafërt, për vendet evropiane, në grupmoshën 15-19 vjeç rreth 70% e të rinjve vijojnë shkollën dhe rreth 30% janë në punë ose kërkojnë punë.

Figura 3.1: Pjesa e të rinjve punëkërkues



A keni punuar muajin e fundit për të siguruar të ardhura?

Këta të fundit konsiderohen si të rinjtë në tranzicion nga shkolla në punë. Ndërsa në grupmoshën 20-24 vjeç ky raport ndryshon rrenjesisht: rreth 30% e të rinjve janë në universitet dhe rreth 70% në punë ose kërkojnë punë. Në Kosovë rreth 40% e të rinjve të grupmoshës 15-19 vjeç dhe rreth 69% e atyre të grupmoshës 20-24 vjeç janë aktivë në tregun e punës (shih Tabelën 3.1). Rezultatet e anketës së RZHNJ 2006 tregojnë se rreth 69% e të rinjve të intervistuar nuk kanë kërkuar muajin e fundit ndonjë punë për të siguruar të ardhura (shih Figurën 3.1). Arsyeja kryesore është se pak më shumë se gjysma e numrit të të rinjve tashmë janë të angazhuar me kohë të plotë në nivelet e ndryshme të sistemit arsimor dhe nuk kanë qenë të interesuar ose nuk e kanë pasur të mundur që të punojnë për shkak të shkollës. Në këta tregues nuk ka dallime thelbësore midis të rinjve të etnive të ndryshme[85].

Përbërja e grupit të të rinjve në tranzicionin nga shkolla në punë është studiuar më në thellësi[86], duke konsideruar të rinjtë e papunë, të punësuar përkohësisht, të punësuar por që duan të ndërrojnë vendin e punës ose ti rikthehen studimeve, si dhe të rinjtë që janë inaktivë dhe nuk ndjekin shkollën, por kanë në plan të punojnë më vonë. Një pjesë e rezultateve përmblidhet në Tabelën 3.1.

Tabela 3.1: Pjesa e rinisë në tranzicionin nga shkolla në punë %

	Gjithsej	Të shkurajuar	Në shkollë, por që kërkojnë punë	Të papunë	Në punë por mendojnë të ndërrojnë vendin e punës	Të tjerë
Gjinia						
Femra	43.3	2.7	3	21.6	10.6	5.5
Meshkuj	56.7	1.3	4.4	26.2	13.3	11.5
Grup-mosha						
15-19	30.6	1.8	3.0	17.2	4.9	3.7
20-24	69.4	2.2	4.4	30.5	18.9	13.4

Siç shihet, në grupin e të rinjve në tranzicion dominojnë të rinjtë e grupmoshës 20-24 vjeç, të cilët përfaqësojnë rreth 69.4% të të rinjve të këtij grupi, ndërkohë që shumica e të rinjve të grupmoshës 15-19 vjeç janë ende në shkollë. Kjo pasqyron tendencën e të rinjve për të hyrë në tregun e punës për tu punësuar vetëm pasi kanë mbaruar nivelet më të uleta të shkollimit. Arsyet që i shtyjnë për të mos vazhduar më tej studimet janë të ndryshme, por më të dukshmet janë nevojat ekonomike të familjes, përgjegjësitë për familjen dhe rritjen e fëmijëve dhe mendësia për mosvazhdimin e shkollimit të vajzave pas njëfare moshe. Megjithatë, kjo tendencë nuk është e njejtë për meshkujt dhe për femrat. Meshkujt përbëjnë shumicën e të rinjve në tranzicion, rreth 57%, dhe vajzat janë më shumë të prirura se meshkujt për të mos hyrë në tregun e punës pa mbaruar deri në fund studimet që kanë filluar. Ndërsa arsyet që çojnë në nivele të ulta të regjistrimit në universitet janë ato të analizuara në kapitullin e dytë (shih 2.2).

Ajo që tërheq vemendjen në këto të dhëna është edhe se dominon grupi i të rinjve që nuk punojnë sepse janë të

papunë, krahasuar me të gjitha grupet e tjera. Ata përfaqësojnë rreth 47.7% të të rinjve në tranzicion dhe shumica e tyre i takojnë grupmoshës 20-24 vjeç.

Hyrja në tregun e punës

Shumë të rinjë përballen me vështirësi të mëdha për të hyrë në tregun e punës. Kjo shprehet me kohën e gjatë që u duhet të presin deri në gjetjen e punës së parë të stabilizuar[87]. Në vendet e zhvilluara vlerësohet se kjo kohë është mesatarisht 1.4 vjet, ndërsa në vende pak të zhvilluara arrinë deri në 4 vjet.

Në Kosovë të dhëna të tilla statistikore mungojnë. Megjithatë, është vlerësuar se në vitin 2004 rreth 43% e të rinjve ishin në kërkim të punës për më shumë se një vit[88]. Po kështu, numri i madh i të rinjve të papunë dhe vlerësimet e vrojtimeve[89] tregojnë se koha deri në gjetjen e punës së parë është shumë e gjatë. Të rinjtë shprehen se kjo nuk lidhet aspak me pretendime të tyre për të gjetur vende pune me paga të larta. Ata pranojnë të punojnë edhe me pagat e uleta, sepse e konsiderojnë të domosdoshme të fillojnë të punojnë e të krijojnë përvojë. Arsyeja kryesore që ata janë të papunë është se ka shumë pak vende pune dhe se nuk mund të gjesh punë pa ndërhyrjen e dikujt. Kjo gjë po bëhet gjithnjë e më shumë e zakonshme në të gjitha sektorët dhe institucionet[90].

Të rinjtë vlerësojnë se më të ekspozuar ndaj pengesave për të gjetur punën e parë janë të rinjtë e pakualifikuar dhe të moshuarit ndërsa ata me diploma universitare kane me shume perparesi. Prandaj edhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët (komuniteti RAE), si më pak të arsimuar, janë më të diskriminuar krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Për boshnjakët disavantazhi vjen vetëm nga gjuha sepse ata nuk mund të konkurrojnë me shqiptarët. Në Pejë, për shembull, në administratën publike ata mund të punësohen vetëm në vende pune *të rezervuara për minoritarët*.

Punësimi për herë të parë i të rinjve në Kosovë ndikohet dukshëm nga disa faktorë, që e kushtëzojnë vendimin për t'u punësuar:

(i) ***Cilësia jo e përshtatshme e shkollimit***. Përfundimi i shkollës dhe fillimi i punës pa marrë njohuritë e duhura, që përputhen me kërkesat e reja të tregut të punës, i kufizojnë mjaft mundësitë e të rinjve për të përzgjedhur një punë të qëndrueshme;

(ii) ***Kërkesa e ulët e tregut të punës për forca pune*** për shkak të përparimit të ngadaltë ekonomik të Kosovës dhe nivelit të ulët të zhvillimit të biznesit privat, veçanërisht të atij prodhues. Rrjedhimisht edhe mundësitë që ofrohen për punësim janë të kufizuara;

(iii) ***Nevoja e madhe për t'u punësuar sa më parë***. Nisur nga përmasat e mëdha të varfërisë në Kosovë, shumica e të rinjve nuk mund të presin që të përzgjedhin punët që mund tu ofrohen dhe janë të ngutur vetë dhe nga presioni i familjeve që të pranojnë ofertën e parë që u paraqitet;

(iv) ***Punësimi në punë pak të paguara***, që, gjithsesi, varen nga niveli i shkollimit të të rinjve dhe ndryshojnë nga rreth 157 Euro në muaj për të rinje me arsim fillor deri në rreth 272 Euro në muaj për të rinj, që janë diplomuar në Universitet[91];

(v) ***Punësimi në tregun informal të punës***. Megjithëse në Kosovë mungojnë të dhënat mbi ekonominë informale, është vlerësuar se në vitet 2003-2005 rreth gjysma e të punësuarve gjithsej kanë qenë të punësuar në ekonominë informale.[92]

(vi) ***Lëvizshmëria e lartë nga një punë në tjetrën***. Kjo konsiderohet si normale po të mendosh se në këtë moshë të rinjtë kanë tendencë të eksperimentojnë vende të ndryshme pune deri në përzgjedhjen e një pune që i përshtatet më shumë kërkesave të tyre. Në rastin e Kosovës, lëvizshmëria, nga njëra anë, nxitet nga fakti se punësimi i parë është ndikuar nga nevoja e madhe ekonomike e të rinjve apo e familjeve të tyre, dhe, nga ana tjetër pengohet nga mundësitë e kufizuara të të rinjve për të shkuar të punojnë larg vendbanimit të tyre.

Inaktiviteti në tregun e punës

Në grupin e të rinjve inaktive në tregun e punës përfshihen të rinjtë që vazhdojnë shkollën dhe ata që nuk janë as në shkollë dhe as në tregun e punës. Në grupin e dytë përfshihen të rinjtë që janë jashtë forcës së punës sepse janë me paaftësi të përkohshme ose të përhershme, kanë përgjegjësi për familjen apo shëndetin e fëmijëve, apo nuk dinë si të kërkojnë punë dhe nuk besojnë se mund të gjejnë punë.

Inaktivët zënë rreth 60% të të rinjve të grupmoshës 15-19 vjeç sepse shumica në këtë grupmoshë janë në moshën e shkollës dhe e vazhdojnë shkollën. Ata zënë, gjithashtu, rreth 31% të të rinjve të grupmoshës 20-24 vjeç, sepse në këtë grupmoshë shumica e të rinjve mbarojnë shkollën dhe përfshihen në tregun e punës.

Problemet e shëndetit dhe paaftësia për punë janë arsyet që dominojnë inaktivitetin tek djemtë. Vajzat janë më inaktive se djemtë dhe si arsye u shtohen përgjegjësitë familjare dhe kujdesi për fëmijët që lindin. Për të rinjtë RAE inaktiviteti është më i madh dhe lidhet më shumë me nivelin e ulët të arsimimit, ndërsa për vajzat e këtij ko-

muniteti ndikon mendësia se vajzat nuk duhet të punojnë por të kujdesen për familjen.

Veçimi nga numri i të rinjve inaktivë në tregun e punës i të rinjve që janë në shkollë krijon mundësinë e përcaktimit të numrit të të rinjve të shkurajuar. Në këtë grup bëjnë pjesë ata të rinj që nuk vazhdojnë të kërkojnë më punë sepse mendojnë se nuk ka vende pune të lira. Këta të rinj kanë humbur besimin se mund të punësohen. Një në katër të rinje inaktivë të grupmoshës 15-19 vjeç dhe një në pesë të rinjë inaktivë të grupmoshës 20-24 vjeç janë të shkurajuar.

3.2 Mundësitë për tu punësuar

Pjesëmarrje e ulët në tregun e punës

Sipas të dhënave zyrtare, me një popullsi rezidente prej rreth 2 milione banorë, Kosova ka një forcë aktive punuese prej rreth 0.92 milione vetë, që i përgjigjet shkallës së pjesëmarrjes prej rreth 46.2% (shih Tabelën 3.2). Ky tregues është mjaft i ulët krahasuar me mesataren e Bashkimit Europian, por edhe më i ulët se të gjitha vendet e Ballkanit, në të cilat shkalla e pjesëmarrjes zakonisht nuk zbret nën 60%. Pranimi i kësaj vlere bazohet në këto argumente kryesore:

(i) **Popullsia e Kosovës është shumë e re** dhe pjesa e popullsisë nën moshen 25 vjeç është rreth 50% e popullsisë gjithsej. Hyrjet në tregun e punës nga kjo pjesë e popullsisë janë gjithnjë e më të pakta, sepse vihet re një tendencë e qartë e rritjes së interesit për të vazhduar studimet në shkollën e mesme dhe në universitet;

(ii) **Daljet nga tregu i punës para moshës së pensionit janë rritur**, sepse punëtorë të moshuar, të nxjerrë nga puna gjatë procesit të tranzicionit shkurajohen nga mungesa e ofertes për profesionet e tyre *të vjetra* dhe nga pamundësia për të gjetur punë;

(iii) **Pjesëmarrja e femrave është shumë e ulët** e ndikuar nga tradita e angazhimit të femrës në punët brenda familjes dhe shkurajimi i saj për shkak të mundësive shumë të pakta për punësim që i ofron tregu i punës.

Megjithatë, një ndikim të rëndësishëm por ende të pamatshëm ndaj këtij treguesi duhet të ketë edhe prania e dukshme e ekonomisë informale në Kosovë.

Të rinjtë zënë rreth 21% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Shkalla e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës ndryshon në varësi të moshës. Deri në moshën 19 vjeç, më shumë se gjysma e të rinjve, rreth 60%, janë më shumë

Tabela 3.2: Treguesit kryesorë të tregut të punës % *(2004)*[93]

Treguesi	Kosova		Bashkimi Europian	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shkalla e pjesëmarrjes	46.2	25.3	70.4	62.6
Shkalla e punësimit	27.9	9.9	64.1	56.5
Shkalla e papunësisë	39.7	60.7	8.9	9.8

të interesuar për vazhdimin e shkollës dhe janë pasivë në tregun e punës (shih Tabelën 3.3). Duke filluar nga mosha 20 vjeç, shumë të rinj nuk vazhdojnë më tej studimet ose i mbarojnë ato në të gjitha nivelet dhe janë aktivë në tregun e punës. Numri i tyre vlerësohet se zë rreth 69% të numrit te përgjithshëm të të rinjve.

Tabela 3.3: Të rinjtë në tregun e punës % *(2004)*[94]

Treguesi	Grup mosha	
	15-19 vjeç	20-24 vjeç
Shkalla e pjesëmarrjes	40.2	69.1
Shkalla e pasivitetit	59.8	30.9

Punësimi në sektorin privat

Ndërmarrjet private janë gjithnjë e më shumë baza e punësimit në Kosovë, por numri i tyre po rritet shumë ngadalë. Në numrin e bizneseve të regjistruara tatimpaguese deri në muajin tetor të vitit 2006 dominojnë Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme me deri në 5 punonjës, të cilat zënë rreth 88.3% të numrit të përgjithshëm të bizneseve (shih Figurën 3.2). Rreth 99% e tyre janë biznese familjare me 1-2 të punësuar. Bizneset që punësojnë mbi 5 punonjës janë shumë më të paktë në numër dhe zënë vetëm rreth 11.7% të numrit të përgjithshëm të bizneseve.

Figura 3.2: Bizneset sipas numrit të punonjësve



Burimi: ESK, 2005

Numri më i madh i bizneseve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët jo prodhues. Rreth 62% e bizneseve janë në tregti dhe hoteleri, 10% në transport, 4% në ndërtim

dhe vetëm 9% në sektorin prodhues. Numri më i madh i bizneseve është në Prishtinë, rreth 20% e bizneseve gjithsej dhe rreth 26% e bizneseve me më shumë se 5 punonjës.

Figura 3.3: Punësimi i të rinjve sipas sektorëve



Edhe punësimi i të rinjve ndjek pothuajse të njejtën shpërndarje (shih Figurën 3.3)[95]. Shumica e të rinjve, rreth 45%, deklarohen se janë punësuar në shërbime e tregti, ku janë edhe numri më i madh i bizneseve. Numri i të rinjve në sektorin e industrisë, ku përfshihen edhe minierat e agro-përpunimi, është shumë më i vogël. Në përgjithësi, një shpërndarje e ngjajshme vihet re për të rinjtë e të gjitha komuniteteve etnike, me ndryshimin se rreth 39% e të rinjve të komunitetit serb janë të punësuar në ferma bujqësore, kundrejt vetëm 7.4% të të rinjve shqiptarë dhe 7.7% të të rinjve të komunitetit RAE.

Kutiza 3.1 ***Plani akcional i punësimit të të rinjve në Kosovë – 2007-2010***

Ky plan specifik është përgatitur me mbështetjen e OBPsë për të rritur punësimin e të rinjve dhe koordinon veprimtarinë e disa Ministrive. Ai ka një kosto totale të masave prioritare prej rreth 13 milion Euro nga të cilat rreth 1/3 parashikohet të mbulohen nga buxhetet vjetore të shtetit dhe pjesa tjetër nga mbështetja e donatorëve. Masat kryesore që parashikohen të ndërmerren për nxitjen e punësimit janë: (i) Zvogëlimi i shkallës së braktisjes në arsimin fillor (rreth 2.5 milion Euro); (ii) Rritja e përfshirjes në arsimin profesional (1.89 milion Euro); (iii) Rritja e mundësive për aftësim profesional (2.0 milion Euro); (iv) Përmirësimi i qasjes për informim, edukim dhe orientim në karrierë (2.39 milion Euro); (v) Rritja e numrit të ndërmarrjeve të krijuara (rreth 1.87 mil Euro); (vi) zvogëlimi i përqindjes së të rinjve të punësuar në ekonominë informale (rreth 1.53 milion Euro); (vii) Rritja e numrit të të rinjve të rregjistruar në shërbimin publik të punësimit (rreth 0.76 milion Euro); dhe (viii) Rritja e përqindjes së të rinjve të punësuar në zhvillimin e infrastrukturës (rreth 0.05 milion Euro).

Punësimi në administratën publike

Në mungesë të regjistrit të administratës publike, në Kosovë nuk ka të dhëna të plota mbi grupmoshat e punonjësve buxhetorë dhe shkallën e kualifikimit të tyre. Ajo që dihet me saktësi është numri i përgjithshëm i punonjësve, që paguhen nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe që në fund të vitit 2004 ishte 74.008 punonjës[96].

Të rinjtë, veçanërisht ata që mbarojnë studimet universitare ne Kosovë ose në universitetet jashtë vendit aspirojnë të punojnë në administratën publike. Ata mendojnë se kjo është në të mirë të tyre, sepse fillojnë një karrierë profesionale të qëndrueshme, por kjo është edhe në të mirë të Kosovës, e cila ka nevojë të krijojë një administratë publike të përparuar dhe të përshtatur më mirë me kërkesat e kohës[97]. Megjithëse përgjithësisht pranohet se të rinjtë janë përshtatur më mirë e më shpejt me ndryshimet e sotme, përfshirja e tyre në administratën publike nuk është e lehtë dhe përballet me disa barriera kryesore[98]:

(i) **Konservatorizmi dhe mosbesimi i punonjësve ekzistues të administratës publike ndaj te rinjeve, veçanërisht i vendimmarrësve**. Në shumicën e rasteve preferohen të merren në punë punonjës në moshë të pjekur, për shkak të përvojës së punës ose të lidhjeve familjare apo shoqërore. Të rinjtë shpesh nuk vlerësohen si të domosdoshëm për të hedhur bazat e një administrate publike bashkëkohore;

(ii) **Nuk ka ende proçedura rigoroze rekrutimi në bazë të përshkrimit të vendit të punës dhe cilësive të kandidatit**. Në procedurat e rekrutimit zakonisht theksohen dy kritere përcaktuese: shkalla e përvetësimit të gjuhës angleze dhe njohja e kompjuterit. Këto lloj rekrutimesh bëhen më shumë nga stafi ndërkombëtar dhe në shumë raste kanë të bëjnë me vende pune që shërbejnë për të asistuar ekspertët e huaj dhe që nuk kërkojnë kualifikime në profesione të posaçme. Për këtë arsye edhe arsimimi jashtë shtetit shpesh herë konsiderohet si kriter lehtësues punësimi për të rinjtë, por vetëm se lidhet me zotërimin e gjuhës angleze dhe jo me njohuritë e fituara atje: *Pa anglishten jeni i bllokuar-shprehen prerazi shumica e të rinjve*[99];

(iii) **Numri i të rinjve në detyra menaxheriale vazhdon të jetë shumë i kufizuar**. Megjithëse në shumë institucione numri i të rinjve është rritur, shumë pak prej tyre janë në detyra drejtuese dhe përgjithësisht në detyra të tilla janë punonjës të moshës mbi 35 vjeç;

(iv) **Të rinjtë e punësuar në administratën publike përfshihen shumë pak në marrjen e vendimeve.** Në përgjithësi atyre ju është krijuar një mjedis bashkëpunues pune, por kur është fjala për marrjen e vendimeve mbi nivelet operacionale, vendimet merren nga menaxherët e vjetër, që shpesh i nën-

vlerësojnë më të rinjtë, sidomos femrat. Kjo është e vërtetë edhe për punonjësit e huaj, të cilët në shumë raste e monopolizojnë marrjen e vendimeve strategjike dhe, në përgjithësi, nuk vlerësojnë punën e të rinjve lokalë, veçanërisht kur këto janë femra. Të rinjtë, nga ana e tyre, mendojnë se kanë bërë progres në vendet e punës që kanë, dhe shprehen të sigurtë se mund të japin kontribut shumë më të madh se deri sot në marrjen e vendimeve strategjike

Kutiza 3.2 ***Në administratën publike kërkohet mendësi e re***

"...Administrata publike është shumë e ngadaltë në marrjen e vendimeve dhe mjaft byrokratike. Procesi i vendimmarrjes duhet të jetë shumë më fleksibël, gjithëpërfshirës, më pak i përqëndruar në nivelet më të larta dhe shumë më pak byrokratik. Aty përdoren metoda pune të prapambetura, të trashëguara nga administrata e vjetër, të cilat ndrydhin iniciativën e specialistëve dhe nuk përshtaten me kërkesat e reja të një administrate moderne. Ndryshimi dhe përparimi është shumë i ngadaltë dhe has pengesat e mendësisë së administratorëve të vjetër. Ne trajtohemi mirë prej tyre, por ne kemi nevojë të ndihmohemi e trajnohemi më shumë, që të përparojmë me shpejtësi. Ne marrim vlerësime shumë të mira prej tyre, por ne kemi ambicie për shumë më tepër, të mësojmë sa më shumë dhe të dëgjohet më shumë mendimi ynë. Ne ndiejmë shumë më tepër kënaqësi kur na merret mendim se sa kur shkruhen fjalë të mira vlerësimi nga eprorët...." *(nga tryeza e debatit në Prishtinë me të rinj që punojnë në administratën publike – 4 shtator 2006*)

Përshtatja me teknologjitë e reja

Impakti i teknologjive të reja, veçanërisht i teknologjisë së informacionit, është i madh tek të rinjtë. Ai forcon kapacitetin e tyre për të marrë vendime të drejta dhe rrit shkallën e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi pasojat e vendimeve që marrin.

Shkalla gjithnjë e më e lartë e përshtatjes së të rinjve të Kosovës me teknologjinë e aftesimit është, gjithashtu, një avantazh potencial për ta në tregun e punës. Interneti i ka mundësuar të rinjve krijimin e lidhjeve me botën e përparuar dhe ka filluar të ndikojë dukshëm në shtimin e njohurive të reja, të cilat po plotësojnë gjithnjë e më shumë njohuritë e mangëta ose jo të përditësuara, që të rinjtë marrin në shkollë. Në kushtet kur sistemi i sotëm arsimor është shumë i ngathët në adoptimin e qasjeve moderne, të rinjtë komunikojnë dhe përfitojnë nga përvoja e moshatarëve të tyre në botë.

Interesi në rritje i të rinjve për kompjuterin dhe internetin pasqyrohet qartë edhe në rezultatet e anketës se RZHNJ-2006[100]. Megjithëse numri i të rinjve që kanë kompjuter është ende i vogël, shumica e të rinjve

Figura 3.4: Përdorimi i internetit nga të rinjtë %



kanë njohuri për kompjuterin dhe mesatarisht në çdo 4 të rinj 3 përdorin internetin. Vihet re, gjithashtu, se djemtë janë përdorues më të shumtë se vajzat. Është mjaft inkurajues fakti që interneti shfrytëzohet edhe nga shumë të rinj në zonën rurale dhe, në këtë aspekt, dallimi me të rinjtë e zonës urbane nuk është shumë i madh (shih Figurën 3.4).

Numri i të rinjve që kanë lidhje interneti në shtëpi vazhdon të jetë mjaft i kufizuar. Vetëm rreth 16% e të rinjve e kanë sot këtë mundësi. Mundësitë më të pakta i kanë të rinjtë që banojnë në zonat rurale, ku vetëm 10% e të rinjve deklarohen se e kanë internetin në shtëpi, kundrejt rreth 22% në zonën urbane. Kufizimi kryesor vjen ngaqë vetëm më pak se gjysma e numrit të të rinjve që shfrytëzojnë internetin kanë kompjuter në pronësi apo në përdorim. Mosmbulimi i të gjithë zonave të banuara me këtë shërbim dhe kostoja e shërbimit vazhdojnë të jenë, gjithashtu, kufizime për lidhjen me internet të shtëpive. Rrjeti i shërbimit të internetit i ofruar nga kompanitë private është në një proces zgjerimi për të mbuluar të gjitha qendrat e banuara të Kosovës, duke synuar përmirësime thelbësore teknologjike[101].

Megjithëse numri i të rinjve që shfrytëzojnë internetin është relativisht i madh, si në qytet ashtu edhe në fshat, është me interes të njihet se përse ai shfrytëzohet më shumë. Nga anketimi rezulton se në çdo katër të rinjë, tre e përdorin internetin për komunikim me *e-mail*, 2 e përdorin për dialog, ndërsa vetëm 1 e përdor për të plotësuar njohuritë e shkollës. Numri i të rinjve që e shfrytëzojnë internetin për qëllime pune nuk kalon 15% të numrit të përgjithshëm të të rinjve gjithsej.

Të dhënat e kësaj ankete nuk pasqyrojnë dallime të dukshme e sistematike midis komuniteteve të të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike.

Femrat, të drejta më pak të rrespektuara në tregun e punës

Korniza kushtetuese e Kosovës ju garanton të gjithë personave të Kosovës të drejtat njerëzore dhe liritë themelore pa diskriminim dhe në kushtet e barazisë së plotë[102]. Në vijim, Akti i Barazisë Gjinore[103] përcakton se punëdhënësi duhet të ofrojë pagesë të barabartë për femrat dhe meshkujt për punë më vlerë të njëjtë dhe duhet të ofrojë punësim, kushte dhe të drejta të barabarta pune. Megjithatë femrat rezultojnë të kenë disavantazhe në tregun e punës në krahasim me meshkujt: 60% e grave janë të papuna dhe këto janë dyfishi i grave që punojnë.

Në Kosovë nuk ka të dhëna statistikore dhe studime të plota për dallimet në tregun e punës midis femrave dhe meshkujve dhe as për statusin e grave të punësuara apo të vetëpunësuara. Gratë në sektorin publik kanë më shumë të drejta se në sektorin privat, kjo për arsye të punësimit joformal në sektorin privat. Gratë e vetëpunësuara dhe ato të papuna nuk kanë qasje në skemat kontribuese të mbrojtjes sociale dhe kuadri ligjor në Kosovë nuk përputhet me standarde te BE-së për këtë kategori punonjësish.

Publiku është pak i informuar dhe i ndërgjegjësuar mbi këto të drejta. Po kështu edhe punëdhënësit. Punëdhënësit nganjëherë specifikojnë preferencën e tyre lidhur me seksin e punonjësit që duan të punësojnë. Edhe kur kjo nuk thuhet zyrtarisht, në shumë raste lihet të nënkuptohet qartë. Nga ana tjetër, për arsye tradite dhe mendësie, poste të veçanta pune dhe profesione lidhen me femrat (pastruese, infermiere, mësuese, sekretare etj). Për të evituar këto është e domosdoshme që posti i punës të lidhet me aftësitë profesionale dhe nivelin arsimor dhe jo me gjininë.

Dallime ka edhe në paga. Pagat mesatare të femrave janë mesatarisht më të ulta se ato të meshkujve dhe ky ndryshim rritet me rritjen e nivelit të shkollimit. Për të diplomuarit në universitet ndryshimi mesatar i pagës është rreth 20%[104]. Një nga arsyet e këtij dallimi është se femrat janë shumë më pak të punësuara në poste menaxheriale dhe përgjithësisht kanë shumë vështirësi të punësohen në këto poste.

Për të rinjtë nuk ka të dhëna dhe analiza të sakta në lidhje më dallimet në pagesë, por vlerësohet se ruhen të njejtat tendenca si ato të mësipërmet.

3.3 Nivele shqetësuese të papunësisë

Rritje e vazhdueshme e papunësisë së të rinjve

Kosova ka një shkallë shumë të lartë papunësie, që, nga burime të ndryshme, për vitin 2005 vlerësohet se sillet prej 35% deri 44%, apo edhe më e lartë[105]. Sipas të dhënave zyrtare pranohet se papunësia në fund të vitit 2005 arriti në 39.7%. Ky është edhe niveli më i lartë i papunësisë në të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit, ndërsa në krahasim me vlerën mesatare të shkallës së papunësisë në Bashkimin Europian papunësia e Kosovës është rreth 4.5 herë më e lartë. Papunësia e femrave është rreth dy herë më e lartë se e meshkujve.

Figura 3.5: Papunësia në Kosovë



Papunësia ka ardhur duke u rritur nga viti në vit e ndikuar më së shumti nga ndryshimet strukturore të ekonomisë jo konkurruese të Kosovës, zhvillimi i ngadaltë i sektorit privat, mungesa e investimeve të huaja, vonesa në rigjallërimin e prodhimtarisë bujqësore private dhe rritja e vazhdueshme e numrit të punëtorëve të rinjë në tregun e punës, kundrejt punësimit të një numri shumë të vogël të tyre. Sipas të dhënave zyrtare, në fundin e 6-mujorit të parë të vitit 2006, numri i të papunëve arriti në rreth 324 mijë vetë, duke shënuar një rritje prej rreth 15% në krahasim më fundin e vitit 2003 (shih Figurën 3.5)[106]. Vetëm gjatë vitit 2005 numri i të papunëve u rrit rreth 5.7% në krahasim me vitin 2004, dhe rritjen më të madhe e kishte numri i femrave të regjistruara, 7.1%, kundrejt rreth 4.5% që ishte për meshkujt (shih Tabelën 3.4). Këto

ritme të rritjes së papunësisë janë më të lartat të krahasuara me të gjitha vendet e Europës Juglindore.

Tabela 3.4: Numri i të papunëve dhe i bizneseve

Komunat	Të papunë			Numri i gjitha bizneseve	
	Numri	Në %	Rritja 2004/05 në %	5 e më pak punonjës	Më shumë se 5 punonjës
Prishtina	65.112	20.45	3.3	5.949	1.092
Mitrovica	62.594	19.66	5.7	1.728	184
Prizreni	51.946	16.31	10.2	3.608	391
Gjakova	36.397	11.44	6.5	2.050	294
Gjilani	32.920	10.34	5.6	1.966	280
Ferizaj	32.498	10.21	5.8	2.545	348
Të tjera	36.903	11.59	na		
Gjithsej	318.390	100	5.7	31.563	4.189

Burimi: ESK, 2005

Papunësia e lartë është një fenomen tipik në të gjitha komunat e Kosovës. Numrin më të madh të të papunëve e ka Prishtina, ku është edhe përqëndrimi më i madh i popullsisë, e ndjekur nga Mitrovica. Megjithatë, Prishtina ofron më shumë mundësi punësimi, sepse ka edhe numrin më të madh të bizneseve të regjistruara, kështu që ritmet e rritjes së numrit të të papunëve aty janë më të ultat në Kosovë. Ndikimin më të madh e jep numri i bizneseve me më shumë se 5 punonjës, i cili është rreth 2.5 herë më i madh se mesatarja e Kosovës. Ritmet më të larta vjetore të rritjes së numrit të të papunëve i ka komuna e Prizrenit, rreth 10.2%.

Pjesën më të madhe të numrit të të papunëve, rreth 91.4%, e zënë shqiptarët (shih Figurën 3.6). Serbët zënë rreth 3.7% ndërsa komuniteti RAE, turqit dhe boshnjakët, së bashku zënë rreth 4.9%. Të dhëna zyrtare mbi shkallën e papunësisë në secilin prej grupeve etnike nuk ka të publikuara, por nga shërbimi publik i punësimit vlerësohet se qasja e etnive sërbe dhe RAE në këtë shërbim ka filluar të përmirësohet dukshëm dhe kjo po krijon mundësinë për të dhëna më të plota e më reale për ta, duke filluar nga viti 2006.

Figura 3.6: Të papunët sipas etnive



Burimi: MPMS, Puna dhe Punësimi, Raporti vjetor, 2005

Nga të dhënat e Tabelës 3.5 shihet qartë se papunësia më e lartë është për moshat nën 40 vjeç: në çdo 4 të papunë, 3 prej tyre janë në moshë më pak se 40 vjeç. Të rinjtë zënë rreth 29% të të papunëve gjithsej dhe numri i tyre në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2006 arriti në rreth 94 mijë. Shqetësues është fakti që në vitin 2005 numri i të papunëve të rinje të regjistruar është rreth 3 herë më i madh se numri i të punësuarve gjatë po këtij viti për të njejtën grupmoshë. Kjo dëshmon për rritje të vazhdueshme të

Tabela: 3.5: Papunësia sipas grup-moshave

Grup-mosha	Të papunë dhjetor 2005		Dinamika	
	Numri	Në %	Hyrje gjatë vitit 2005	Dalje gjatë vitit 2005
15-24	90.791	28.52	10.323	3.094
25-39	140.478	44.13	12.396	5.621
40-54	63.939	20.09	4.965	3.110
55-64	23.182	7.62	1.978	1.121
Gjithsej	318.390	100	29.662	12.946

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor 2005.

papunësisë tek të rinjtë me ritme shumë më të larta se të gjitha grupmoshat e tjera.

Shkalla e papunësisë së të rinjve është rreth 10% më e lartë se niveli mesatar i papunësisë së Kosovës, ndërkohë që papunësia e të rinjve të grupmoshës 20-24 vjeç është rreth dy herë më e lartë se ajo e grupmoshës 15-19 vjeç[107]. Kjo vjen nga fakti se deri në moshën 20 vjeç shumica e të rinjve ndjekin shkollën dhe hyrjet në tregun e punës nga kjo grupmoshë janë shumë më të pakëta.

Figura 3.7: Të rinj të papunë sipas gjinisë



Burimi: Qeveria e Kosovës, Plani akcional i punësimit të të rinjëve në Kosovë Prishtinë, Tetor 2006

Në mesin e të rinjve, numri i të papunëve meshkuj është pak më i lartë se i femrave (shih Figuren 3.7). Ky ndryshim vjen kryesisht ngaqë numri i vajzave të grupmoshës 15-19 vjeç, që hyjnë në tregun e punës, është më i vogël se i djemve, sepse vajzat e kësaj grupmoshe nuk tentojnë të kërkojnë punë jasht familjes dhe më me dëshirë mirren me punët breda familjes.
Dinamika e tregut të punës tregon se regjistrimet e reja të të papunëve janë sistematikisht më të shumta se ato që dalin nga listat dhe që më së shumti konsiderohen të punësuar. Nga të dhënat e (tabelës 3.6) shihet qartë se në vitin 2005 numri i të regjistruarve ishte më shumë se dy herë më i madh se i atyre që kanë dalë nga listat. Kjo dinamikë tregon se praktikisht papunësia vazhdon të rritet dhe janë vetëm ritmet e rritjes së saj që ndryshojnë nga viti në vit.

Dinamika e tregut të punës dominohet nga punëtorët e pakualifikuar. Në fund të vitit 2005 ata përfaqësonin rreth 59% të numrit të përgjithshëm të të papunëve, si dhe rreth 55% të të papunëve të regjistruar rishtazi gjatë këtij viti. Ata përfaqësonin, gjithashtu, rreth 43% e numrit te pergjithshem të të punësuarve gjatë po këtij viti (shih Tabelën 3.6), ndërkohë që punëtorët e kualifikuar dhe ata me arsim të mesëm të lartë dhe universitar zënë vetëm rreth 14.6% të të punësuarve. Kjo dëshmon për zhvillim të pakët të bizneseve që bazohen në teknologji të reja dhe kërkojnë punëtorë të kualifikuar.

Punëkërkues të papunë të regjistruar

Të dhënat administrative mbi shkallën e punësimit dhe të papunësisë në përgjithësi dhe për të rinjtë në veçanti, bazohen në regjistrimin e punëkërkuesve të papunë në zyrat e shërbimit publik të punësimit, i cili ka ngritur një rrjet agjencish në të gjithë Kosovën të përbërë nga 7 qendra rajonale dhe 22 zyra komunale. Ky është një shërbim universal, që i jep të drejtën çdo të papuni të regjistruar të marrë këshilla e udhëzime në lidhje me punësimin e tij. Kjo realizohet nëpërmjet punonjësve të shërbimit publik të punësimit dhe sot ka afërsisht një punonjës për rreth 1600 të papunë të regjistruar. Mendohet se këto të dhëna nuk e pasqyrojnë siç duhet realitetin për disa arsye kryesore:

(i) **Ndihmesa e shërbimit publik të punësimit për të gjetur punë është mjaft e vogël**. Të papunët janë të shkurajuar për tu rregjistruar për shkak të mundësive shumë të pakëta të punësimit që ofrohen nga ky shërbim;

(ii) **Regjistrimi nuk sjell ndonjë dobi, qoftë edhe të përkohshme, për të papunët**. Kjo lidhet me mungesën e skemave të ndihmës sociale për papunësinë, që, në ndryshim nga vendet e tjera të tranzicionit, ende nuk janë zbatuar në Kosovë;

Tabela 3.6: Shkalla e kualifikimit të të papunëve të regjistruar

Kualifikimi	Të papunë		Dinamika	
	Numri	Në %	Hyrje gjatë vitit 2005	Dalje gjatë vitit 2005
Të pakualifikuar	188.948	59	16.409	5.584
Gjysëm të kualifikuar	13.221	4	711	478
Të kualifikuar[108]	28.640	9	2.054	992
Arsim i mesëm i ulët	82.880	26	9.497	4.993
Arsim i mesëm i lartë	2.344	1	365	351
Universitet	2.357	1	626	553
Gjithsej	318.390	100	29.662	12.946

Burimi: MPMS, Departamenti i Punës dhe Punësimit, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor 2005

(iii) **Aftesimi profesional nga shërbimi publik i punësimit është për një numër mjaft të kufizuar të papunësh,** kështu që nuk mund të shërbejë si nxitje për t'u regjistruar.

Më pak të interesuar për t'u regjistruar si të papunë në shërbimin publik të punësimit duket se janë të rinjtë, sidomos ata që kërkojnë të punësohen për herë të parë. Ata shprehen se kjo vjen ngaqë ata janë të sigurtë se kjo nuk sjell ndonjë rezultat për zgjidhjen e problemit të tyre. Prandaj mendojnë se papunësia është shumë më e lartë se ajo e deklaruar nga të dhënat zyrtare[109]. Megjithatë, po të mirret parasysh edhe prania në një masë të konsiderueshme e ekonomisë informale në Kosovë, të dhënat administrative mbi papunësinë mund të konsiderohen si të pranueshme.

530 të papunë për 1 vend pune të lirë

Figura 3.8: Vendet e punës sipas sektorëve



Numri i vendeve të lira të punës, që u ofrohen të papunëve të regjistruar nga shërbimi publik i punësimit, është mjaft i vogël. Në vitin 2005 u ofruan 7121 vende pune krahasuar me 8400 dhe 7848 përkatësisht në vitin 2004 dhe 2003. Kjo do të thotë se mesatarisht për një vit ofrohet një vend pune për rreth 45 të papunë. Ndërsa në terma praktike, duke konsideruar se çdo muaj ofrohen mesatarisht rreth 593 vende pune, rezulton se për një vend pune janë kandidatë rreth 530 të papunë. Ky është një tregues shkurajues për ritmet e uljes së papunësisë në Kosovë. Ai është shkurajues edhe për të papunët për tu regjistruar në zyrat lokale të shërbimit publik të punësimit, gjë që e vështirëson më tepër përcaktimin e saktë të numrit të të papunëve.

Shkurajues është, gjithashtu, fakti që në çdo katër vende pune që ofrohen, tri janë në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që vetëm 15% e vendeve të punës janë në sektorin prodhues (shih Figurën 3.8). Kjo përforcon përfundimin e mësipërm që bizneset prodhuese, të cilat bazohen në teknologji të reja dhe hapin më shumë vende pune, po zhvillohen shumë ngadalë.

Numri mjaft i vogël i vendeve të punës që ofrohen konsiderohet nga të rinjtë edhe arsyeja kryesore e papunësisë.

Kutiza 3.3 ***Përse krijohen kaq pak vende pune?***

Si faktorë më kryesorë për krijimin e një numri të pakët vendesh pune në Kosovë, të rinjtë rendisin: (i) Institucionet e dobëta, që janë rezultat i të kaluarës, i ngadalësisë së riaftesimit gjatë tranzicionit dhe i statusit të paqartë të Kosovës; (ii) Mungesa e politikave qeveritare, të tilla si ato për nxitjen e investimeve vendase dhe tërheqjen e investimeve të huaja; (iii) Mungesa e të dhënave reale për papunësinë dhe ekonominë informale, që pengon hartimin e politikave realiste e të frytshme për rritjen e punësimit; (iv) Shkalla e ulët e kualifikimit të fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të nivelit të ulët të sistemit të arsimit. – Nga tryezat e debatit me të rinjtë në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj e Gjakovë.

Përgjithësisht ata mendojnë se ka kaq pak vende pune sa që nuk mund të mendohet për të përzgjedhur punëra të mira, me paga të arsyeshme dhe që përputhen me shkallën e kualifikimit apo shkollimit që ata kanë[110]. Këtë mendim e shprehin rreth 55% e të rinjve të anketuar, ndërkohë që vetëm 23% e tyre shprehen se janë të papunë ngaqë nuk kanë nivelin e duhur të shkollimit (shih Figurën 3.9).

Figura 3.9: Arsyet e të qënit i papunë



Nxitja e ndërmarrësisë

Politikat e rritjes së punësimit në Kosovë përgjithësisht janë fokusuar në sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme, zhvillimin e shpejtë të bizneseve për të krijuar vende të reja puna dhe pajisjen e forcave të punës me njohuritë e nevojshme, sa më në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Edhe në politikat më specifike për të nxitur punësimin e të rinjve, rëndësi i kushtohet masave që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional të të rinjve, kështillimit dhe inaftesimit për të gjetur punë, kontratave të punës etj. Të gjitha këto masa janë të domosdoshme por jo të mjaftueshme për të zgjidhur këtë problem të madh e shqetësues për Kosovën.

Nxitja e ndërmarrësisë së rinisë vlerësohet si një rrugë tjetër e rëndësishme për rritjen e punësimit. Në përgjithësi numri i të rinjve që përfshihen në veprimtari ndërmarrësie është shumë më i vogël se ai i grupmoshave më të rritura. Megjithatë, potenciali sipërmarrës i të rinjve është i konsiderueshëm dhe, kur nxirret në pah, lehtëson punë-

simin e tyre dhe zbut dukshëm problemet e papunësisë. Kjo është më e dallueshme në vendet me të ardhura të ulta[111]. Kjo lidhet me mundësitë e pakta për punësim që ato ofrojnë, nivelin e lartë të varfërisë dhe të ardhurat e pakta të familjeve, të cilat së bashku përbëjnë një shtysë për t'i përfshirë të rinjtë në ndermarrësi.

Rëndësia e nxitjes së ndërmarrësisë lidhet edhe me një tipar dallues të shoqërisë kosovare. Më shumë se një dekadë represioni, diskriminimi e përjashtimi social nga ana e regjimit serb, i ka orientuar kosovarët nga ndërmarrësia, duke themeluar me investime të vogla firma private, më së shumti familjare, për të siguruar mbijetesën.

Pas përfundimit të konfliktit, u krijuan kushte për ta zhvilluar më tej këtë potencial, duke përfituar nga rrethanat e reja për të bërë biznes. Edhe sot, në Kosovë predominojnë bizneset e vogla e familjare dhe në çdo katër të rinj, një është në familje që ka një biznes të vogël familjar (shih Figurën 3.10)[112].

Figura 3.10: Biznesi familiar



Në Kosovë është vështirë të gjesh të dhëna statistikore mbi përfshirjen e të rinjve në ndërmarrësi. Të dhëna të tilla mungojnë edhe në dokumentet e politikave të përgjithshme mbi rininë apo atyre të veçanta mbi punësimin e të rinjve, mbase ngaqë kjo çështje është lënë jasht vemendjes. Por analiza e disa faktorëve që lidhen me ndërmarrësinë mund të çojë në disa vlerësime të rëndësishme që duhen konsideruar nga politikëbërësit.

Njohuritë e marra në shkollë nga të rinjtë mbi ndërmarrësinë janë të kufizuara dhe jo të përditësuara sa duhet. Reformat që lidhen me futjen e programeve të reja mësimore, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, trajnimin e mësuesve dhe lidhjen e shkollës me biznesin janë në fillimet e tyre. Të rinjtë rrethohen nga një mjedis social e kulturor që nuk e kultivon sa duhet ndërmarrësinë për shkak të traditës, mosbesimit apo faktorëve të tjerë që lidhen me shoqërinë në tërësi dhe familjen në veçanti. Të gjitha këto bëjnë që dëshira dhe guximi i të rinjve për të filluar një biznes të jenë të ndrydhura dhe të shfaqen me vonesë.

Mundësitë e të rinjve për të siguruar financimin e domosdoshëm për të filluar një biznes janë, gjithashtu, mjaft të kufizuara. Ata, përgjithësisht, nuk kanë burime të veta financiare, janë të painformuar e të pafamiljarizuar me procedurat e komplikuara të kreditimit të bankave dhe nuk i kanë garancitë e kërkuara prej tyre. Kjo vështirësohet më tej nga kostoja e lartë e biznesit për shkak të mungesave në infrastrukturë, energji, ujë etj., si dhe nga përqindjet e larta të interesave të kredive që ofrojnë bankat.

Kuadri ligjor e rregullues, që lidhet me fillimin e një biznesi dhe me vazhdimin e tij, nuk parasheh masa të veçanta për nxitjen dhe lehtësimin e ndërmarrësisë tek të rinjtë, si dhe për të mbështetur bizneset e reja të krijuara prej tyre me asistencë dhe shërbime pa pagesë. Të rinjtë në Prishtinë[113] vlerësojnë se fillimi i një biznesi përballet me procedura të komplikuara, për shkak të byrrokracisë së autoriteteve lokale. Për të kompletuar dokumentacionin e duhur duhet shkuar në shumë institucione dhe shpeshherë marrja e dokumenteve vështirësohet artificialisht nga nëpunësit. Niveli i bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme është i ulët, aq sa, kur të duhet të marrësh një dokument, duhet një tufë dokumentesh të mëparshme, sepse nuk ka sisteme elektronike, që të tregojnë marrëdhëniet e mëparshme me institucionin ose me institucionet e tjera. Në shumë raste, për të mbaruar punë shpejt, duhet njohje personale ose të paguash diçka. Ndjehet mungesa e një institucioni, ku të mund të merret informacion i plotë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për të filluar një biznes. Pas fillimit të një biznesi, ndërmarrësit e rinj përballen me barriera të mëdha, që lidhen me sistemin konfuz dhe mjaft të vështirë për t'u kuptuar të taksave sidomos prej vlerave të ndryshme të taksave, taksat e larta dhe dekurajuese, si dhe nga sjellja e nëpunësve ndaj bizneseve, që shkojnë për kontroll me mendësinë vetëm për të gjetur gabime.

Kutiza 3.4 ***Plan i veprimit për rininë 2007-2010***

Plani Kosovar i Veprimit për Rini 2007-2010 është pjesë e dokumentit të Politikave Rinore të Kosovës. Ai ka një kosto totale të masave që parashikon prej 10.59 mil. Euro, nga të cilat 72% parashikohet të mbulohen nga buxhetet vjetore të shtetit dhe 28% nga mbështetja e donatorëve. Rreth 43% e këtyre fondeve, apo 4.5 milion Euro, parashikohen për nxitjen e punësimit të të rinjve. Masat kryesore që parashikohen të ndërmerren për nxitjen e punësimit janë: (i) Miratimi i një sistemi te favorshëm taksash dhe përmirësimi i sistemit të trajnimeve (rreth 70 mijë Euro); (ii) Forcimi i kapaciteteve të shërbimit të punësimit dhe financimi i programeve të punesimit sezonal (rreth 755 000 Euro); (iii) Krijimi i një sistemi inaftësimi për tregun e punës dhe mundësitë e punësimit (rreth 84000 Euro); (iv) Lehtësimi i tranzicionit të të rinjve nga shkolla në punë nëpërmjet programeve të praktikave profesionale të të rinjve në institucionet publike (rreth 60000 Euro); dhe (v) Nxitja e vetëpunësimit të të rinjve në zonat rurale nëpërmjet krijimit të një fondi vetëpunësimi dhe krijimi i lehtësive fiskale (3.45 mil. Euro).

Nxitja e të rinjve për t'u përfshirë në ndërmarrësi ka një interes të dyfishtë për Kosovën. Së pari, ajo zbut në mënyrë të drejtpërdrejt shkallën e lartë të papunësisë së të rinjve, veçanërisht të atyre të grupmoshës 20-24 vjeç. Së dyti, vë në shërbim të Kosovës potencialin sipërmarrës të të rinjve dhe i fut ata në rrugën e ndërmarrësisë, duke krijuar një brez plot interesa dhe ambicie për të përparuar në fushën e biznesit privat . Këta sipërmarrës të rinj, me përvojën, pjekurinë, njohuritë dhe kapitalin që krijojnë janë brezi i biznesmenëve të ardhshëm të Kosovës.

Në kuadrin e masave për nxitjen e punësimit të të rinjve, të parashikuara ne Planin e Veprimit për Rininë (shih Kutizën 3.4), është përfshirë edhe nxitja e vetëpunësimit për rreth 2000 të rinj në zonat rurale me anë të financimeve prej mesatarisht 1500 Euro për vetëpunësim[114].

Mundësitë e punësimit në fshat

Megjithëse rreth gjysma e numrit të të rinjve të Kosovës janë pjesë e popullsisë rurale, numri i atyre të punësuar në sektorin bujqësor vazhdon të jetë mjaft i vogël. Në mungesë të të dhënave zyrtare, të dhënat e anketës së RZHNJ tregojnë se vetëm 11% e të rinjve të Kosovës deklarohen se punojnë në fermat bujqësore[115]. Kjo lidhet me disa faktorë kryesorë:

(i) **Bujqësia vuan pasojat e tranzicionit më shumë se çdo sektor tjetër**. Kjo shprehet në rënien e përgjithshme të prodhimit bujqësor edhe në zonat me shumë traditë për zhvillimin e këtij sektori, mundësitë e pakta financiare për futjen e teknologjive të reja të prodhimit dhe pamundësinë e përballimit të konkurrencës së prodhimeve bujqësore të importit. Si rezultat, aktiviteti bujqësor i sotëm është kthyer në një aktivitet prodhimi më shumë për mbijetesë se sa për treg;

(ii) **Zhvillimi i sektorit jo bujqësor në fshat është, gjithashtu, i vonuar**. Duke përjashtuar bizneset e tregtisë dhe shërbimeve, të tjerat dhe veçanërisht agroindustria janë biznese private shumë të pakta në numër. Agro-industria promovon produktet bujqësore si dhe rrit punësimin në agrikulturë.

(iii) **Rikthimi në fshat i popullsisë së zhvendosur nga konflikti është i ngadaltë.** Kjo ka vonuar rikthimin në normalitet të sektorit bujqësor dhe investimet private në bujqësi;

(iv) **Interesi i të rinjve për të punuar në bujqësi ka rënë.** Kjo vjen pjesërisht ngaqë ata nuk janë optimistë për mundësitë e ndryshimit të shpejtë të gjendjes së këtij sektori, pra për mundësitë e punësimit në fshat. Por, kjo ka lidhje edhe me tendencën e shumë të rinjve për të gjetur një punë në qytet, ku ata mendojnë se zhvillimi është më i shpejtë dhe, gjithsesi, jetohet më mirë se në fshat. Për tu theksuar është se në këtë aspekt ka një ndryshim thelbësor midis të rinjve serbë dhe të rinjve të tjerë. Në sektorin bujqësor deklarohen se punojnë rreth 39% e të rinjve të komunitetit serb, kundrejt vetëm 8% të të rinjve shqiptarë dhe 7.7% të të rinjve të komunitetit RAE. Kjo shpreh një dëshirë më të madhe të të rinjve serbë për të punuar e jetuar në fshat, por mund të jetë ndikuar edhe nga mundësitë më të kufizuara që ata kanë për të lëvizur në zonat urbane me mundësi më të mëdha punësimi të Kosovës.

Kutiza 3.5 ***Fond Vetëpunësimi për rininë në fshat***

Në Planin e Veprimit për Rininë 2007-2010, është përfshirë një Fond Vetëpunësimi për të rinjtë e zonave rurale. Ai parashikon vetëpunësimin brenda vitit 2010 të rreth 2000 të rinjve e të rejave të zonës rurale me anë të një financimi prej mesatarisht rreth 1700 Euro për person.

3.4 Aftësimi profesional

Kapacitete trajnuese të kufizuara

Aftësimi profesional konsiderohet si një urë lidhëse midis shkollës dhe punës. Në të gjitha vendet, pavarësisht shkallës së zhvillimit të tyre, ky sistem shërben për të përgatitur të rinjtë të hyjnë në tregun e punës dhe për t'u krijuar atyre mundësi të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë e tyre në përgjigje të ndryshimeve teknologjike dhe kërkesave të zhvillimit të ekonomisë globale.

Sot në Kosovë funksionojnë 8 Qendra të Aftësimit Profesional. Në vitin 2005 aty u aftësuan 3925 vetë dhe në çdo tre të trajnuar një ishte femër[116]. Rreth 88% të të trainuarve ishin shqiptarë, 5% serbë dhe 7% nga komunitetet e tjera etnike.

Nga të trainuarit gjithsej, rreth 59.3% janë të rinj, shumica që kanë mbaruar arsimin e mesëm të ulët, gjë që dëshmon për një përkujdesje të veçantë të strukturave qeverisëse për përgatitjen me prioritet të të rinjve për të hyrë në tregun e punës (shih Tabelën 3.7).

Tabela 3.7: Të trainuarit sipas grup-moshave

Grup-mosha	Të trainuar	
	Numri	Në %
15-24	2.321	59.3
25-39	1.306	33.4
40-54	278	7.2
55-64	23	0.1
Gjithsej	3.928	100

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor 2005

Numri i të trainuarve dhe shpërndarja gjeografike e Qendrave të Aftësimit Profesional, dhe, për pasojë, qasja në to e të rinjve të papunë, janë shumë të kufizuara. Në Tabelën 3.8 shihet qartë se gjatë vitit 2005 u krijuan mundësi trainimi vetëm për 1.23% të të papunëve. Ky është një numër tepër i vogël, po të kihet parasysh se rreth 28% e të papunëve janë të rinj dhe shumica e tyre, që vijnë nga një sistem arsimor i papërshtatur me tregun e punës, kanë nevojë për njohuri praktike profesionale.

Deri më sot në Kosovë dominon sektori i aftesimit profesional në varësi të Shërbimit Publik të Punësimit i financuar nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe mundësitë e tjera për kualifikim janë shumë të kufizuara. Ndërkohë, në vendet e OECD-së shpenzohet deri në 2% të PBB-së për politikat aktive të punësimit, ku trainimi i të rinjve zë një pjesë të rëndësishme. Vetëm 1/10 e kësaj shume financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe pjesa tjetër janë financime të sektorit privat.

Në Kosovë, megjithëse njohuritë dhe kompetencat e forcës punuese janë faktorë të rëndësishëm në performancën e bizneseve private, shpenzimet për aftësimin profesional ende shihen prej tyre si kosto e jo si investim. Si rrjedhim, pothuajse nuk ka informacion mbi shpenzimet e kompanive private për trainimin e vazhdueshëm profesional. Kjo shpesh spjegohet me faktin se trainimet lidhen ngushtë me madhësinë e ndërmarrjes. Investimi për trainime i Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, që dominojnë sektorin privat në Kosovë, është shumë më pak i mundshëm krahasuar me atë të firmave të mëdha. Zgjidhja e përshtatshme

Tabela 3.8: Të trainuarit sipas komunave

Komunat	Të papunë		Të trainuar gjatë 2005	
	Numri	Në %	Numri	Në %
Prishtina	65.112	20.45	689	18
Mitrovica	62.594	19.66	924	24
Prizreni	51.946	16.31	797	20
Gjakova	36.397	11.44	305	8
Gjilani	32.920	10.34	345	9
Ferizaj	32.498	10.21	420	11
Të tjera	36.903	11.59		
Gjithsej	318.390	100	3.928	100

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor 2005

në këto kushte konsiderohet krijimi i rrjeteve të trajnimit të sektorit privat me bazë sektori apo profesionesh, që bazohen në partneritetin e bizneseve në nivel qëndror apo lokal. Kjo mënyrë ndihmon të krijohen mundësi për të investuar së bashku në trainimin profesional të punonjësve të tyre. Qeveria e Kosovës, nga ana e saj, mund ti nxisë këto lloj nismash nëpërmjet lehtësive fiskale.

Sektori privat i aftësimit profesional nuk është zhvilluar ende sepse mundësitë paguese të të rinjve apo të rriturve ende nuk janë në nivelin e kostos së këtij lloj biznesi.

Çertifikata kundrejt kontrata pune

Në Qendrat e Aftësimit Profesional të Shërbimit Publik të Punësimit trainohen mesatarisht 3500-4000 vetë çdo vit. Me të përfunduar kurset, të gjithë pajisen me certifikata për profesionin që mësojnë. Ky sistem i përparuar aftësimi përballet me disa probleme thelbësore:

(i) **Kërkesa për trainim tejkalon kapacitetet për trainim** . Në përgjithësi, profesionet për të cilat aftësohen kursantët janë profesione "të reja", që janë përzgjedhur në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo shpjegon edhe kërkesën e madhe për të marrë pjesë në këto kurse aftësimi profesional, e cila e tejkalon disa herë kapacitetin e qendrave. Zgjerimi i kapaciteteve të qendrave, si nga pikëpamja e numrit të pranimeve ashtu edhe e shpërndarjes gjeografike, mbetet problem themelor për t'u konsideruar nga Qeveria, si dhe nga donatorët ndërkombëtarë që kontribuojnë në këtë sektor;

(ii) **Ngritja dhe forcimi i qendrave është bërë dhe vazhdon të bëhet pa asnjë lidhje me shkollat e mesme profesionale**. Kjo ka dy pasoja negative. ***Së pari***, reforma e VET është një reformë e kushtueshme për një

Kutiza 3.6 ***Frytshmëri e ulët e shërbimit të punësimit***

"…Entet publike të shërbimit për punësim nuk kryejnë ndonjë funksion konkret e të dobishëm për të lehtësuar punësimin e të rinjve, bile as hulumtime mbi tregun e punës, që mund të na orientonin mbi të ardhmen e punësimit, sektorët, profesionet, shkallën e kualifikimit, shpërndarjen gjeografike etj. të mbështetura në të dhëna reale. Nga ky shërbim janë krijuar edhe qendrat e aftësimit professional. Për to janë shpenzuar shumë fonde për kapacitete shumë të vogla trainimi, kur duhej të financohej riaftësimi i shkollave profesionle ekzistuese, që të mund të përfitonin më shumë të rinj. Ne nuk jemi aq të pasur sa të kemi edhe shkolla profesionale të mira edhe qendra trainimi moderne…". – Nga tryeza e të rinjve të Rahovecit, 23 nëntor 2006.

vend të vogël si Kosova dhe me kufizime buxhetore të dukshme. Kostoja e infrastrukturës ndërtimore, mjeteve didaktike, laboratorëve dhe kabineteve profesionale, si dhe e kurrikulave dhe e përgatitjes së stafit, është e konsiderueshme. Në këto kushte, zhvillimi i një reforme të aftësimit profesional të ndarë nga reforma e arsimit profesional nuk duket se është zgjidhja më optimale për Kosovën. ***Së dyti***, aftësimi profesional dhe arsimi profesional duhet të jenë sisteme që plotësojnë njëri tjetrin dhe si të tillë ato duhet të paktën të konsiderojnë njeri tjetrin, të shkëmbejnë përvojat e njëri tjetrit dhe të kontribuojnë për suksesin e njëri tjetrit;

(iii) Megjithë metodat e përparuara dhe tendencën për të qenë më afër kërkesave të tregut të punës, Qendrat vazhdojnë të ndikohen nga tradita e vjetër e inputeve, duke qenë pak të orientuara nga suksesi i kursantëve në tregun e punës. Kursantët pajisen me certifikata për kurset që ndjekin, por strukturat qeveritare nuk janë në gjendje të thonë se sa prej tyre arrinë të sigurojnë kontrata pune[117]. Kjo nuk është thjesht një çështje statistikash, edhe pse do të ishte mirë që të dhëna të tilla të ishin pjesë e programeve statistikore që lidhen me tregun e punës. Problemi është shumë më i thellë. Sistemi i aftesimit profesional nuk ndjen nevojën e monitorimit dhe vlerësimit të rezultatit të punës së tij, sepse nuk ka si referencë të tij rezultatin por vetëm inputet. Ky konceptim nuk përputhet me tendencat e sotme të sistemeve të përparuara perëndimore të kualifikimit profesional. Vetëm duke monitoruar rezultatet sistemi mund të ballafaqohet në mënyrë të vazhdueshme me tregun e punës, të vlerësojë punën që bën dhe të programojë e zbatojë masa të frutshme për riaftesimin e tij;

3.5 Planet për të ardhmen

Të rinjtë janë përballë vështirësisë për të gjetur punë dhe dëshirës për të punuar, për të fituar aftësitë profesionale dhe për të kontribuar në përparimin e Kosovës.

Kutiza 3.7 ***A është zgjidhje emigrimi?***

"..Njerëzit në komunën tonë kanë qenë tradicionalisht punëtorë të mëdhenj, si meshkujt ashtu edhe femrat, por veçanërisht të rinjtë. Klima e mirë e ka favorizuar zhvillimin e bujqësisë. Por tani papunësia i ka prekur të gjithë. Më shumë të prekur jemi ne të rinjtë, që, megjithëse jemi të shkolluar, nuk shohim asnjë perspektive. Në këto kushte zgjidhja e vetme është, që në vend që të rrimë të papunë në Kosovë, të emigrojmë në perëndim…". Nga tryeza e debatit me të rinjtë në Rahovec, 23 nëntor 2006.

Të rinjtë e papunë shohin mundësi të kufizuara punësimi dhe interesim shumë të pakët të institucioneve qëndrore e lokale për t'i ndihmuar të gjejnë punë. Ritmet e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe të krahinave ku banojnë i japin atyre pak shpresë për ndryshimin e statusit të tyre në tregun e punës. Kjo vështirësohet edhe nga shkalla e kualifikimit të tyre, që shpesh nuk përshtatet me kërkesat e tregut të punës. Mundësitë për të përfunduar kurse aftësimi profesional janë, gjithashtu, të kufizuara.

Ata që janë të punësuar mendojnë se nuk janë të vlerësuar sa duhet dhe shumë shpesh nuk janë duke punuar në vendin e duhur, në bazë të njohurive dhe kualifikimit që kanë.

Ata që janë të punësuar në administratën publike, nuk kanë në plan ta lënë punën, megjithëse, kur mërziten nga puna e rëndomtë dhe nga pagat jo inkurajuese, e kanë menduar shpesh këtë gjë. Dëshira për të bërë një karrierë profesionale në Kosovë është dominuese tek këta të rinj.

Të gjithë të rinjtë, të punësuar ose jo, mendojnë se janë të vlefshëm për Kosovën por se absolutisht nuk mund të vazhdojnë tërë kohën kështu. Më optimistët mendojnë se të gjitha këto pengesa do t'i kapërcejnë me kohën dhe kjo nuk do të vonojë. Më pak optimistët mendojnë se vënia në rrugë të mbarë dhe zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve do të jetë një proces shumë i gjatë dhe, veçanërisht për tu punësuar, rruga e emigrimit është më tunduese se qëndrimi pa punë në Kosovë.

3.6 Politika dhe masa prioritare

Njësimi i strategjive

Plani i Veprimit për Rininë (2007-2010) dhe Plani Aksional i Punësimit të të Rinjve të Kosovës (2007-2010), si dy do-

kumente strategjikë me të njejtin objektiv të përgjithshëm dhe të hartuara në të njejtën periudhë kohe, kanë nevojë të njësohen, për të evituar konfuzionin dhe mbivënien e përgjegjësive të institucioneve përkatëse dhe të buxheteve të parashikuara. Pas kësaj, kostoja e masave prioritare, që mendohet se mund të financohet Buxheti i konsoliduar i Kosovës, duhet të konsiderohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave në Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme 2006-2008.

Lehtësimi i vendimmarrjes mbi profesionin

Për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve dhe veçanërisht femrave në tregun e punës është i nevojshëm të zhvillohet sistemi i orientimit profesional të tyre në mënyrë përpjestimore me moshën, që u lehtëson të rinjve marrjen e një vendimi të drejtë mbi kohën dhe mënyrën e kalimit të suksesshëm nga shkolla në punë.

Kjo arrihet përmes: (i) Inaftësimit mbi cilësitë, dallimet dhe avantazhet e arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional, si dhe mbi mundësitë që ata krijojnë për punësim në të ardhmen; (ii) Dhënies së informacionit cilësor mbi tregun e punës, me të dhëna e vlerësime mbi sektorët e zhvillimit ekonomik e social në Kosovë, në vendet fqinjë dhe në vendet e përparuara perëndimore, mundësitë dhe nevojat e punësimit sipas nivelit dhe profilit të arsimimit, si dhe karriera profesionale për lloje të ndryshme punësimi; (iii) Inaftësimit mbi procesin e kërkimit të punësimit të parë, rregullat e punësimit në sektorin publik e privat, dallimet midis punësimit formal e informal, afatgjatë e afatshkurtër, me kohë të plotë apo të pjesshme; (iv) Shpjegimeve mbi procedurat e zhvillimit të veprimtarisë private, etj.

Njohuri të tilla të rinjtë duhet ti marrin përmes programeve mësimore, fushatave ndërgjegjësuese të programuara për grupmosha të ndryshme, si dhe përmes faqeve të posaçme të internetit. Ky duhet të jetë një proces interaktiv, që zhvillon tek të rinjtë ndjenjën e përgjegjësisë për të marrë një vendim të drejtë dhe i krijon atyre kushtet për të sqaruar gjithçka që lidhet me këtë vendim.

Shfrytëzimi i potencialit të ndërmarrësisë

Nxitja e ndërmarrësisë dhe e vetëpunësimit të të rinjve mund të realizohet përmes: (i) Edukimit të nxënësve, duke e përfshirë ndërmarrësinë në programet mësimore të shkollës së mesme, për të kultivuar tek të rinjtë dëshirën, vullnetin dhe besimin për të vetëvepruar dhe realizuar idetë sipërmarrëse; (ii) Fushatave të ndërgjegjësimit të publikut, për të krijuar një mjedis social-kulturor favorizues e besues për suksesin e të rinjve; (iii) Mundësive reale për të financuar fillimin e një biznesi, duke krijuar Fondin e Ndërmarrësisë për të rinjtë, apo nxitur mekanizma bankare private financimi me kushte dhe skema kreditimi të lehtësuara nga shteti, si dhe duke ju dhënë të rinjve falas asistencën e nevojshme; (iv) Heqjes së barrierave administrative për biznesin në përgjithësi dhe për biznesin e të rinjve në veçanti, duke projektuar e zbatuar një reformë të plotë rregullatore, e cila krijon lehtësi për rregjistrimin dhe liçensimin e shpejtë dhe në një sportel të vetëm të bizneseve, lehtësi fiskale për bizneset e të rinjve, veçanërisht në fshat, dhënie shërbimesh falas, që lidhen me krijimin e kapaciteteve njerëzore për administrimin dhe zhvillimin e biznesit; (v) Motivimit financiar, që nxit punësimin e të rinjve të tjerë në ndërmarrësinë e krijuar nga të rinjtë.

Kushte të favorshme punësimi në administratën publike

Për të rritur punësimin e të rinjve në administratën publike është e nevojshme të punohet për përmirësimin e kuadrit ligjor, krijimin e kushteve për zbatimin me korrektësi të tij dhe forcimin e kontrollit institucional të Ministrisë së Shërbimeve Publike[118] mbi zbatimin e këtij legjislacioni. Në mënyrë të veçantë, mund të konsiderohen këto masa prioritare: (i) Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullues ekzistues, që lidhet me Ligjin e Shërbimit Civil[119], dhe veçanërisht i udhëzimeve mbi procedurat e rekrutimit, kontratave, periudhën e provës dhe përshkrimet e punës; (ii) Miratimi i shtesave të duhura ligjore që kufizojnë presionin politik dhe joinstitucional ndaj sistemit të shërbimit civil, veçanërisht për punësimin dhe largimin nga puna; (iii) Parashikimi i kritereve të posaçme që i japin përparësi punësimit të të rinjve dhe nxisin punësimin e të rinjve që kanë studjuar në universitete të përparura perëndimore;(p.sh një opcion mund të jetë futja e kuotës për punësim e të sapodiplomuarve) (iv) Kryerja dhe zbatimi i analizës funksionale të të gjitha strukturave të institucioneve publike, duke përcaktuar dhe bërë publike detyrat dhe përgjegjësitë për çdo vend pune, si dhe nivelin arsimor dhe aftësitë profesionale të kërkuara për çdo vend pune; dhe (v) Planifikimi nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike[120] i kurseve të posaçme të trainimit për të rinjtë e punësuar në administratën publike.

Krijimi i mundësive të aftësimit profesional

Për të rritur mundësitë për aftesimin profesional të të rinjve, veçanërisht për ti përgatitur ata për punësimin e parë, janë të nevojshme të konsiderohen këto masa të veçanta: (i) Koordinimi institucional i sistemit të Aftesimit Profesional me atë të Edukimit Profesional, nëpërmjet ngritjes së një Agjencie ndërministrore sipas përvojës së vendeve, që këto dy sisteme i kanë të ndara; (ii) Rritja e

kapaciteteve trainuese dhe përmirësimi i shpërndarjes gjeografike të qendrave të trainimit; (iii) Krijimi i mundësive për të marrë shërbime këshillimi falas për të rinjtë që dëshirojnë të zgjerojnë njohuritë e tyre profesionale pa u shkëputur nga puna; dhe (iv) Miratimi i një pakete masash, ku të parashikohen stimuj që lidhen me sistemin e taksave ose subvencione për veprimtari trainuese, që nxisin bizneset të investojnë në aftësimin profesional të të rinjve të punësuar prej tyre.

Rritja e eficiencës së ndihmës së donatorëve

Pjesa më e madhe e financimeve për masat prioritare të parashikuara në dokumentet strategjikë mbi punësimin e të rinjve është parashikuar të mbulohet me kontributin e donatorëve ndërkombëtarë. Pa këtë kontribut, zbatimi i planeve të hartuara nuk është i mundur. Rrjedhimisht, është e domosdoshme që masat e koordinuara prioritare të bëhen objekt diskutimi me donatorët ndërkombëtarë për të nxitur interesin dhe për të vlerësuar shkallën e angazhimit të tyre.

Krijimi i një Forumi koordinimi të donatorëve, që kontribuojnë për fuqizimin e rinisë, nën drejtimin e një institucioni qeveritar të Kosovës, do të ishte një masë e rëndësishme për lidhjen më të mirë të projekteve të tyre me masat prioritare të parashikuara, koordinimin e veprimtarive dhe rritjen e efiçiencës së financimeve të tyre.

Kapitulli 4

Pjesëmarrja - e drejtë dhe përgjegjësi

4 Pjesëmarrja - e drejtë dhe përgjegjësi

Ndikimi i rinisë së Kosovës ndaj vendimmarrjes së institucioneve, që kanë lidhje me jetën e tyre, është shumë i vogël. Kjo vjen sepse institucionet nuk e ndiejnë detyrimin për ta respektuar të drejtën e pjesëmarrjes së rinisë, por edhe ngase vetë të rinjtë nuk e kuptojnë pjesëmarrjen si përgjegjësi qytetare. Ndërgjegjësimi i shoqërisë për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes, nxitja e të rinjve për ta ushtruar këtë të drejtë në të gjitha nivelet dhe krijimi i instrumenteve, që e mundësojnë pjesëmarrjen, janë detyra të përbashkëta të të rinjve dhe të institucioneve të Kosovës.

4.1 Pjesëmarrje simbolike e të rinjve

Rinia është mosha kur njeriu fillon të pranohet dhe dëgjohet jashtë familjes së tij. Në këtë moshë ai fillon të ndjehet pjesë e një familjeje më të gjerë shoqërore, komunitetit, dhe të bashkëpunojë me të. Ai kupton se ky ndërveprim udhëhiqet nga disa të drejta dhe detyra të ndërsjellta, të cilat përcaktojnë edhe shkallën e qytetarisë e të demokracisë individuale e kolektive të shoqërisë.

Megjithëse pjesëmarrja është një koncept i gjerë që përfshin shumë aspekte të të drejtave dhe përgjegjësive të të rinjve, pjesëmarrja në jetën shoqërore në komunitet dhe pjesëmarrja në demokraci konsiderohen si dy elementët më themelorë, që e karakterizojnë aë[121].

Kutiza 4.1	*Koncepti i pjesëmarrjes*
Pjesëmarrja e të rinjve është krijimi i lidhjeve dhe partneriteteve në mes të të rinjve dhe të rriturve në të gjitha fushat e jetës, që të rinjtë të mund të marrin një pozitë të vlerësuar në komunitet dhe shoqëri, të përfitojnë nga kontributi, idetë dhe energjitë e të rriturve, si dhe të kontribuojnë me mendësinë e tyre të re dhe me energjitë e moshës. Pjesëmarrja është e drejtë themelore qytetare dhe garanci që të rinjtë të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në vendimmarrje. Ajo rrit rëndësinë e individit si një anëtar i përgjegjshëm dhe kontribues i mirëqenies së shoqërisë por edhe ndihmon për përparimin e tij personal. Pjesëmarrja ndikon drejtpërdrejt në shumë çështje kyçe të jetës së rinisë, të tilla si arsimimi, liria e shprehjes, liria e ushtrimit të fesë, punësimi, shëndeti etj., duke krijuar mundësi që zgjidhja e tyre të mos përcaktohet ekskluzivisht nga faktorë të jashtëm.	

Në Kosovë ekziston një mendim i përgjithshëm që pjesëmarrja reale e të rinjve në shoqëri, dhe veçanërisht në vendimmarrje, është e pakët. Kjo shprehet në shumë studime e analiza të përgatitura nga vetë organizatat rinore, institucionet vetëqeverisëse të Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Institucionet Qeveritare shumë shpesh ndiejnë nevojën e përdorimit të sllloganit "*ky dokument u përgatit nëpërmjet një procesi pjesëmarrjeje të gjerë*", duke kuptuar me pjesëmarrje, në rastin më të mirë, marrjen e ndonjë komenti mbi dokumentin. Po kështu, Partitë politike në Kosovë shpesh pohojnë se kanë bërë gjithçka që është e mundur për të "*freskuar*" strukturat e tyre drejtuese dhe për të krijuar kushte që të rinjtë të përfshihen e të kontribuojnë brenda tyre, por përfshirja është realisht shumë e pakët. Ajo vazhdon të jetë e një natyre simbolike *tokeniste*[122], spontane, jo e institucionalizuar, pa rregulla e detyrime të qarta, të diktuara nga nevoja apo nga standardet mbi të drejtat e rinisë.

Tabela 4.1: Të dhëna mbi pjesëmarrjen e të rinjve në Kosovë

2006	Viti i anketimit
4.1	Kanë marrë pjesë në projekte të OJQ
3.0	Kanë përfituar nga një projekt i OJQ-ve
1.7	Kanë marrë pjesë në aktivitete të sindikatave
7.6	Kanë marrë pjesë ne diskutime publike
11.2	Kanë marrë pjesë në iniciativa qytetare
25.0	Kanë nënshkruar peticion
21.7	Pjesëmarrje në protesta publike
6.5	I janë bashkuar lëvizjes "Vetëvendosja"

Në një përfundim të ngjashëm mbi angazhimin qytetar të të rinjve mund të arrihet edhe nga të dhënat e Raportit të Zhvillimi Njerëzor. Në (Tabelën 4.1) janë përmbledhur disa të dhëna mbi pjesëmarrjen e të rinjve në Kosovë, në bazë të anketës së vitit 2006[123] e ku shihet qartë, se, ky angazhim ende mbetet në nivele të ulëta.

Aktualisht, rreth 4.1% e të rinjve shprehen se janë përfshirë vetë ose një pjesëtar i familjes së tyre në veprimtari e projekte të zbatuara nga OJQ-të. Ata përgjithësisht nuk ndjehen përfitues të projekteve të organizatave rinore dhe për këtë shprehen mbi 93.8% e të rinjve të intervistuar (shih Tabelën 4.1).

Figura 4.1: Pjesëmarrja e të rinjve në veprimtari shoqërore, 2006



Vetëm numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në protesta publike dhe kanë nënshkruar peticione është më i madh. Rreth 22% e të rinjve të intervistuar kanë marrë pjesë në protesta publike dhe 1 në çdo 4 të rinj ka nënshkruar një peticion gjatë vitit 2006. Kjo duket se vjen kryesisht nga vijimësia e traditës së protestave prej viteve të pasigurisë dhe të diskriminimit etnik. (shih Figurën 4.1).

Angazhimi i pakët qytetar i të rinjve të Kosovës dhe mungesa e pjesëmarrjes aktive të tyre lidhet më së shumti me disa faktorë kryesorë:

(i) **Shkolla është preokupimi kryesor i të rinjve të grupmoshës 15-19 vjeç.** Shumica e këtyre të rinjve vazhdojnë shkollën dhe mësimi konsiderohet si detyra e tyre më kryesore. Prindërit, nga ana e tyre, dëshirojnë që vëmendja e fëmijëve të jetë e përqëndruar tek mësimi dhe nuk e nxisin ose synojnë ta kufizojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në veprimtari që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mësimin. Kjo vjen edhe pse, përgjithësisht, kultura e pjesëmarrjes nuk është aq e zhvilluar as tek vetë prindërit. Prandaj edhe ndikimi i familjes tek të rinjtë në këtë aspekt pothuajse mungon.

(ii) **Gjetja e një vendi pune është problemi themelor i të rinjve të grupmoshës 20-24 vjeç**. Në këtë moshë të rinjtë kanë filluar të kuptojnë vështirësitë serioze të jetës së tyre dhe të familjeve ku bëjnë pjesë. Ata dallojnë shumë më qartë problemet ekonomike dhe shkallën e varfërisë. Pavarësisht nëse vazhdojnë apo jo studimet, të rinjtë e kësaj grupmoshe janë me fytyrë nga tregu i punës dhe janë të preokupuar në radhë të parë për t'u punësuar. Në këto kushte, ata janë të prirur më shumë për çdo lloj veprimtarie që i lehtëson zgjidhjen e problemit kryesor që kanë dhe janë shumë më pak të interesuar për veprimtari të tjera;

(iii) **Kultura e pakët e anagazhimin qytetar.** Të rinjtë e të dy grupmoshave nuk kanë marrë njohuri në shkollë që kultivon tek ata përgjegjësitë qytetare. Duke qenë se edhe familja nuk ushtron ndonjë ndikim të dukshëm pozitiv tek ata për këtë angazhim, ata nuk janë edukuar me këtë koncept dhe përgjithësisht kanë kulturë të pakët angazhimi qytetar;

(iv) **Mendësia se pjesëmarrja nuk është çështje e tyre**. Shpesh herë tek të rinjtë haset mendësia se pjesëmarrja në veprimtaritë shoqërore komunitare është një çështje që ka më shumë lidhje me prindërit e tyre se sa me ata vetë. Poashtu, po të shikohet nga aspekti historik, pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete deri ne vitin 1999, në shumicen e rasteve ka pasë reperkusione negative individuale ngase aktivistët kane perfunduar prapa grilave, dhe kjo eksperience ka lënë pasoja negative në pjesëmarrjen e te rinjve.

4.2 Jeta shoqërore në komunitet

Mundësia për të ndikuar

Kultura e pakët e pjesëmarrjes dhe mendësia hierarkike ballkanase, që i jep familjes dhe prindërve rolin kryesor në vendimmarrje dhe atributet e përfaqësimit të të gjithë pjesëtarëve të familjes, bëjnë që ndikimi i të rinjve në komunitetin dhe në mjedisin që i rrehon të jetë shumë i vogël. Kjo pasqyrohet qartë në rezultatet e anketës (shih Figurën 4.2)[124]. Më shumë se 60% e të rinjve shprehen se nuk janë në gjendje të kenë asnjë ndikim në çështjet e vendbanimit në tërësi dhe të lagjes ku jetojnë në veçanti. Rreth 80% e tyre shprehen se nuk janë në gjendje të ndikojnë në punët

dhe çështjet që ndodhin në Komunën e tyre. Vetëm se në familje ata mendojnë se janë në gjendje të ndikojnë më tëpër dhe është pozitiv fakti se këtë mendim e shprehin rreth 60% e të rinjve të pyetur.

Në këtë vlerësim të tërheq vëmendjen, gjithashtu, numri i madh i të rinjve që nuk dinë të shprehen rreth kësaj çështjeje, të cilët përfaqësojnë deri në 20% të të rinjve gjithsej. Kjo është dëshmi e kulturës së pakët të angazhimit qytetar sepse, në disa prej rasteve, të rinjtë e pyetur nuk ishin të qartë se pse duhej të ndikonin në çështje, të cilat i kishte për detyrë t'i zgjidhte administrata lokale.

Figura 4.2: Ndikimi në çështjet komunitare



Pjesëmarrja në Organizatat Jo-Qeveritare

Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) luajnë një rol të rëndësishëm për të ndërtuar besimin e njerëzve tek njëri-tjetri, forcuar bashkëpunimin e tyre në dobi të përmbushjes së qëllimeve të përbashkëta, nxitur e realizuar procesin e pjesëmarrjes aktive të njerëzve në zhvillimin e shoqërisë, si dhe për dhënien e shërbimeve të ndryshme në dobi të njerëzve. Ato shpesh synojnë, gjithashtu, të nxisin ndërveprimin dhe marrëveshjen e qytetarëve me shtetin.

Në Kosovë janë të regjistruara më shumë se 3500 OJQ, por vetëm rreth 500 prej tyre janë aktive[125]. Disa organizata të të rinjve kanë ekzistuar edhe para luftës, por kanë qenë të pakta dhe aktivitetet e tyre kanë qenë të penguara nga situata e përgjithshme politike para vitit 1999. Shumica OJQ-ve është themeluar pas vitit 1999, e nxitur në një masë të madhe, jo vetëm nga nevoja që shoqëria Kosovare e pasluftës kishte për t'u mbështetur, por edhe nga financimet e shumta, që u vunë në dispozicion nga komuniteti ndërkombëtar. Numri më i madh i OJQ-ve është regjistruar në vitin 2000 ndërsa në vitin 2005 dhe 2006 është regjistruar një numër shumë i vogël OJQ-ësh.

Kutiza 4.2 ***Objektiva të OJQ-ve rinore***

(i) Nxisin pluralizmin, shumëllojshmërinë dhe tolerancën në shoqëri, duke mbrojtur dhe përforcuar identitetet kulturore, etnike, fetare, gjuhësore etj;
(ii) Çojnë përpara shkencën dhe të menduarit, zhvillojnë kulturën dhe artin, mbrojnë mjedisin dhe mbështesin të gjitha shqetësimet e një shoqërie energjike civile;
(iii) Motivojnë qytetarët për të qënë aktivë në të gjitha sferat e shoqërisë dhe për të mos qëndruar në mëshirën e fuqisë së strukturave shtetërore;
(iv) Janë alternativa me më shumë pavarësi dhe fleksibilitet për disa veprimtari, që kryhen nga agjencitë shtetërore;
(v) Ndërtojnë mekanizma përmes të cilave institucionet shtetërore dhe tregu i japin përgjegjësi publikut.

Sipas një studimi të Fondacionit Kosovar të Shoqërisë Civile, rezulton që rreth 19.4% e organizatave të regjistruara janë organizata rinore[126]. Edhe pse ky është një fakt inkurajues, numri i të rinjve, që janë anëtarë të këtyre organizatave rinore apo i të rinjve që janë të përfshirë në nismat rinore është shumë i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të të rinjve në Kosovë. Sipas anketimit, vetëm rreth 4.4% e të rinjve të pyetur shprehen se janë anëtarë të OJQ-ve dhe vetëm 1.9% se janë pjesë e ndonjë iniciative rinore, pra vetëm më pak se 6.5% e të rinjve janë të interesuar për veprimtaritë e OJQ-ve (shih Figurën 4.3). Kjo përgjigje është e përafërt si për të rinjtë shqiptarë ashtu edhe për ata të komuniteteve të tjera etnike.

Figura 4.3: Pjesëmarrja e të rinjve në OJQ



Ky nuk është një fenomen që vihet re vetëm në Kosovë. Në shumicën e vendeve Europiane në tranzicion përgjithësisht vërehet një zvogëlim i shkallës së pjesëmarrjes së të rinjve ne OJQ për të ushtruar presion civil në çështje, të cilat shqetësojnë shoqërinë. Pjesmarrja ka njohur norma më të larta se zakonisht në rastet kur në këto vende kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme, të cilat kanë shërbyer si

shtysë për nisma qytetare të përmasave të mëdha, apo në raste të veprimtarive të shoqatave jo qeveritare me financime të konsiderueshme.
Kjo gjendje është e përafërt, gjithashtu, në vendet e tjera të Ballkanit, ku vlerësohet se vetëm 4% deri 5% e të rinjve janë të përfshirë në organizata rinore[127]. Megjithatë, edhe në kushtet e nivelit të ulët të pjesëmarrjes, në këto vende i është kushtuar rëndësi faktit që, kur pjesëmarrja bëhet e mundur, të mos jetë formale, të mos motivohet thjesht nga nevoja e organizatave për kryerjen e aktiviteteve të tyre, por nga domosdoshmëria për të paraqitur një shqetësim të shoqërisë apo për të zgjidhur një çështje konkrete të saj. Gjithsesi, Kosova ka më shumë nevojë se vendet e tjera për ta kapërcyer këtë "*deficit demokratik*". Ajo është në valën e përpjekjeve për të arritur një demokraci funksionale dhe një vetëqeverisje të qëndrueshme, të cilat kanë nevojë për një rol më aktiv të organizatave jo qeveritare dhe për pjesëmarrje shumë më të gjerë në to të rinisë.

Figura 4.4: Pjesëmarrja e të rinjve në iniciativa rinore



A jeni përfitues nga ndonjë projekt i OJQ-ve?

Pyetjes nëse janë përfitues nga ndonjë projekt i OJQ-ve, vetëm rreth 6.2% e të rinjve i përgjigjen pozitivisht si përfitues vetë ose ndonjë pjesëtar i familjes së tyre (shih Figurën 4.4)[128], gjë që tregon se përgjithësisht të rinjtë nuk ndjehen përfitues të projekteve. Ky tregues është i përafërt për të rinjtë shqiptarë dhe ata serbë. Ndërsa për të rinjtë e komunitetit RAE rezulton se numri i atyre që ndjehen përfitues është rreth 2 herë më i madh se numri i të rinjve të komuniteteve të tjera. Kjo lidhet me faktin se për këtë komunitet OJQ-të kanë zhvilluar më shumë veprimtari që lidhen me mbështetjen humanitare, këshillimin shëndetësor etj.

Shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe e përfitimit të të rinjve nga veprimtaritë e OJQ-ve rinore shëmbëllen me një krizë interesimi ose besimi ndaj tyre. Pyetjes se a do të donit të merrnit pjesë vullnetarisht në një OJQ, rreth 91% e të rinjve i përgjigjen negativisht (shih Figurën 4.5)[129].

Më shumë se 100 OJQ rinore dhe Qendra të Rinisë në Kosovë bëjnë pjesë në Rrjetin Rinor të Kosovës[130]. Misioni

Kutiza 4.3 ***Ç'po ndodh me OJQ-të rinore?***

Në OJQ-të rinore, jo vetëm pjesëmarrja e të rinjve është e pakët, por edhe numri i të rinjve përfitues është shumë modest. Kjo shtron natyrshëm për diskutim çështjen e efiçiencës së këtyre organizatave. Kufizimi i pjesëmarrjes bën që OJQ-të të mbyllen në vetvete, të kthehen në organizata të një numri të kufizuar të rinjsh dhe të largohen gradualisht nga funksioni për të cilin janë krijuar. Ato fillojnë t'i kushtojnë rëndësi sasisë së financimeve dhe shpenzimit të fondeve dhe jo efektivitetit të veprimtarive që zbatojnë. Natyrshëm shtrohet, gjithashtu, diskutimi i transparencës së menaxhimit dhe i kapaciteteve të OJQ-ve për të përmbushur misionin e tyre. Kjo implikon kërkesa më rigoroze edhe për donatorët ndërkombëtarë, që financojnë projektet e OJQ-ve, për t'i mbështetur vlerësimet e tyre më shumë tek rezultatet se sa tek shkalla e shpenzimit të fondeve.

i këtij rrjeti është t'i zhvillojë aftësitë e të rinjve, t'i adresojë nevojat e tyre, që të bëhen faktorë efektivë në një shoqëri civile të lirë, të hapur dhe demokratike, dhe të koordinojë veprimtaritë e përbashkëta të organizatave anëtare. Ai është krijuar në vitin 2001 pas Kongresit të të Rinjve të Kosovës, gjatë diskutimeve në një sërë takimesh të të rinjve nga e gjithë Kosova.

Figura 4.5: Dëshira për të marrë pjesë në OJQ



A do të merrnit pjesë vullnetarisht në një OJQ ?

Asambletë Komunale Rinore

Sipas përvojës së vendeve anëtare të Bashkimit Europian, përfshirja, pjesëmarrja dhe angazhimi i vërtetë qytetar i të rinjve duhej të fillojë në nivel lokal[131]. Një nga format më efektive për ta realizuar këtë përfshirje është krijimi i Asambleve Komunale Rinore.

Në Kosovë, janë bërë disa përpjekje për të mobilizuar të rinjtë të ngrejnë zërin në institucionet vendore lidhur me çështjet që janë me interes për ta. Me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, në trembëdhjetë Komuna janë themeluar Asambletë Komunale Rinore (shih Figurën 4.6).

Figura 4.6: Shpërndarja e Asambleve Komunale Rinore

Këto janë imitime jo-qeveritare e jo-politike të Asambleve Komunale në Kosovë. Ato përbëhen prej grupe të rinjsh në secilën Komunë, të cilët kryejnë funksione dhe organizojnë veprimtari të ngjashme me ato të Asambleve Komunale. Asambletë Komunale Rinore përfshijnë të rinj të komuniteteve të ndryshme: shqiptarë, serbë, boshnjakë, ashkalinj, romë, turq dhe kroatë. Anëtarët e Asambleve Komunale Rinore takohen dhe diskutojnë çështje që janë me interes për të rinjtë dhe bashkinë e tyre, ata bashkëpunojnë me përfaqësuesit e qeverisë lokale për këto çështje, trajnohen në një sërë fushash dhe japin rekomandime për çështjet e rëndësishme, që preokupojnë të rinjtë e komunës. Ata kanë përcaktuar dhe janë pajtuar së bashku se papunësia, marrëdhëniet e dobëta ndëretnike, mungesa e shërbimeve për të rinj, mungesa e konsultimeve me të rinjtë në organet vendimmarrëse, standardet dhe mundësitë për t'u arsimuar, mjedisi dhe dallimet gjinore janë problemet më prioritare, që preokupojnë sot të rinjtë e Kosovës[132].

Qendrat Rinore pa financime

Në Kosovë janë 31 Qendra Rinore në nivel komunash, të cilat janë mbështetur me financime nga donatorët, veçanërisht nga GTZ, UNICEF, UNDP, OSBE etj. Ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në edukimin jo-formal profesional të rinisë, nëpërmjet organizimit të kurseve të gjuhëve të huaja, kompjuterit, gazetarisë, rrobaqepësisë etj., duke përkrahur të rinjtë për punësim. Qendrat Rinore shërbyen për nxitjen e aktiviteteve sportive dhe rikrijuese për rininë, kontribuan për organizimin e shumë fushatave mbi edukimin shëndetësor, seminareve mbi drogat, sëmundjet ngjitëse seksualisht të transmetueshme, trafikimin etj. Shumë prej veprimtarive shërbyen për të nxitur përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike midis të rinjve.

Qendrat u vendosën në godina të reja, ose në godina ekzistuese, të cilat u morën me ose edhe pa qira. Te gjithë ishin entuziastë për krijimin e tyre, prandaj u krijuan dhe u kompletuan me shpejtësi me të gjitha pajisjet dhe me staf lokal të paguar mirë. Qendrat në shumë raste u ngritën edhe pa bashkëpunim me institucionet qendrore dhe duke anashkaluar pushtetin lokal.

Kutiza 4.4 ***Një qasje e gabuar?***

Qendrat Rinore, rrjetet rinore, parlamenti rinor, Qendra Burimore e OJQ-ve dhe shumë OJQ të tjera në Kosovë u krijuan me një qasje nga lart poshtë, të drejtuara nga donatorët ndërkombëtarë, që vunë në dispozicion financimet e tyre dhe transmetuan modelet e suksesshme që ata sillnin nga përvoja e tyre. Institucionet qëndrore e lokale të porsangritura dhe pa përvojën e veprimtarive të shoqërisë civile u anashkaluan. Ky ishte një proces i shpejtë, i diktuar nga nevojat e mëdha e urgjente të shoqërisë civile të Kosovës, e cila po hidhte hapat e para në një shoqëri demokratike. Kërkohej njëherësh ngritja e organizatave të shoqërisë civile, krijimi i kapaciteteve njerëzore, ofrimi i sa më shumë shërbimeve për rininë dhe komunitetin. Ndërkohë, askush nuk mendoi për një strategji daljeje. Shumica e strukturave të ngritura rezultuan fare të paqëndrueshme dhe e ndërprenë veprimtarinë e tyre sapo u ndërprenë financimet.

Tani entuziazmi ka rënë. Qendrat Rinore e kanë pakësuar dukshëm veprimtarinë e tyre, si rezultat i ndërprerjes së financimeve nga organizatat ndërkombëtare dhe i mungesës së angazhimit të institucioneve publike qendrore e lokale për të vazhduar mbështetjen e tyre. Një pjesë e tyre tashmë janë mbyllur. Një pjesë tjetër janë në trysninë e pushtetit lokal, i cili kërkon t'i marrë për vete godinën dhe pajisjet. Komuna e Istogut, për shembull, ka tri Qendra Rinore dhe të tria pothuajse nuk funksionojnë. Tani financimet e donatorëve shkojnë vetëm aty ku ka komunitete mikse etnike.

Përfaqësuesit e Qendrave Rinore shfaqin shkallë të lartë pakënaqësie ndaj institucioneve lokale dhe Drejtorive për Kulturë, Rini e Sport pranë çdo Kuvendi Komunal, duke argumentuar që mbyllja e një Qendre Rinore në një komunitet është po aq me pasoja negative sa mbyllja e një shkolle[133].

Përvoja e disa vendeve të tjera, ku kanë funksionuar qendra të ngjashme rinore, tregon se aktiviteti i tyre ka ardhur në ulje me zvogelimin e financimit nga donatorët dhe ato nuk kanë mundur të mbijetojnë edhe në rastet kur i është dhënë hapësirë nga autoritetet lokale. Kjo pasi pjesa

më e rëndësishme e një qendre janë aktivitetet, një pjesë e të cilave ka qenë e natyrës së shërbimeve për të rinjtë dhe një pjesë aktivitete advokuese. Riorientimi i aktiviteteve të Qendrave Rinore më shumë nga aktivitetet advokuese, duke iu larguar gradualisht aktiviteteve të shërbimeve, të cilat janë më të kushtueshme dhe të paqëndrueshme, mund të ishte një mundësi për të rigjallëruar Qendrat rinore. Kjo kërkon forcimin e aftësive të tyre për të aplikuar për fonde pranë MKRS ose prane donatorëve. Një përvojë e tillë e mirë është zbatuar në Qendrat Rinore të Prizrenit e të Gjilanit, të cilat janë kthyer ne OJQ dhe kanë mbijetuar me aplikime për fonde.

Vullnetarizmi

Vullnetarizmi është përshkruar si shprehje e vullnetit dhe mundësisë së njerëzve që t'u ndihmojnë të tjerëve dhe ta përmirësojnë shoqërinë pa ndonjë lloj kompensimi[134]. Ai është veçanërisht i dobishëm për rininë, sepse i mundëson asaj angazhimin në veprimtari, përmes të cilave rinia fiton përvojë praktike, nxit miqësinë dhe ndjesinë e qytetarisë, pronësisë dhe pushtetit.

Tradita e vullnetarizmit është tipike për vendet ish-komuniste të Europës Juglindore. Vullnetarizmi, i njohur ndryshe si puna vullnetare, ishte pjesë e rëndësishme e doktrinës komuniste dhe përdorej shpesh për fushata në bujqësi apo ndërtimin e veprave infrastrukturore e industriale. Ka shumë argumente që provojnë se vullnetarizmi i asaj periudhe, më shumë se vullnetarizëm i mirëfilltë në dobi të shoqërisë, ishte shëmbëlltyrë e punës së detyruar. Kosova ka një përvojë krejtësisht të veçantë e origjinale për vullnetarizmin. Ajo ka një potencial të madh e tradicional vullnetarësh, përvoja e të cilëve është me shumë vlera për veprimtaritë e sotme të të rinjve. Vullnetarët dhe vullnetarizmi kanë luajtur një rol të madh në vitet 1990, kur në Kosovë ka ekzistuar periudha e të ashtuquajturit "*vullnetarizëm institucional*.

Qeveria Paralele e Kosovës në atë kohë, duke përfshirë edhe sistemet paralele të arsimit dhe shëndetësisë, financohej nga taksat vullnetare, që paguanin shqiptarët e Kosovës dhe të diasporës dhe që arrinte deri në 3% të të ardhurave të tyre[135]. Gjatë kësaj periudhe shumë shërbime brenda Kosovës jepeshin nga vullnetarë pa pagesë. Është plotësisht e vërtetuar se sistemi paralel i mbijetoi vështirësive e pengesave kryesisht në sajë të vullnetarizmit të shumicës së popullsisë.

Përfundimi i konfliktit krijoi një klimë të re në Kosovë, e cila influencoi në një masë të madhe edhe tek përhapja dhe natyra e vullnetarizmit. Vullnetarizmi shumë shpejt u zëvendësua me veprimtarinë e një numri të madh organizatash ndërkombëtare të shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës, që nga shpërndarja e ushqimit dhe deri tek projektet e mëdha infrastrukturore. Paralelisht, u krijua një numër i madh organizatash jo qeveritare vendase, të cilat, të mbështetura nga donatorët, filluan zbatimin e projekteve të shumta.

Por, megjithë këtë traditë të veçantë dhe dëshirën e madhe për të dhënë kontribut vullnetar, vullnetarizmi në Kosovë është në rënie, veçanërisht tek të rinjtë. Kjo pohohet nga një sërë studimesh, të cilat vënë në dukje se veprimtaritë vullnetare kanë pësuar rënie menjëherë pas konfliktit. Arsyet e kësaj rënie lidhen me ndryshime të kushteve politike, ekonomike e shoqërore në Kosovë dhe ndikohen nga disa faktorë:

(i) Përvoja e vullnetarizmit kosovar është përvojë e viteve të pushtimit dhe represionit te regjmit serb, e nxitur nga ndjenja e patriotizmit dhe trysnia e mbijetesës. Sot, në kushtet e paqes, lirisë e demokracisë, shumë prej këtyre elementëve nxitës e motivues nuk janë më të pranishëm ngaqë mungon një situatë ku shoqëria të ndjehet e rrezikuar;

(ii) Familjet sot përballen me vështirësi të mëdha ekonomike dhe përpjekja për të zgjidhur problemet e tyre konsiderohet nga shumica prej tyre më prioritare se zgjidhja e problemeve komunitare;

(iii) Diaspora e konsideron të përmbushur me sukses misionin e saj historik ndaj Kosovës dhe tani është më pak e prirur për nisma, që kanë si bazë kontributet vullnetare;

Kutiza 4.5 ***"Vullnetarizmi institucional" i Kosovës***

Përvoja e vullnetarizmit në Kosovë është shumë e ndryshme nga ajo e vendeve të tjera të tranzicionit. Ajo nuk lidhet me disa veprimtari të shkëputura, të komanduara nga shteti, si në shumicën e vendeve komuniste. Në Kosovë, për gati një dekade, funksionoi një qeveri paralele, një sistem arsimor e shëndetësor paralel, tërësisht i mbështetur tek vullnetarizmi. Ky lloj vullnetarizmi "institucional", për nga mënyra si u zbatua, përmasat dhe koha, duket se është unikat në llojin e vet. Gjatë kësaj periudhe, në Kosovë vepronin një numër shumë i kufizuar organizatash jo-qeveritare dhe organizatash bamirësie. Një pjesë e mirë e tyre nuk regjistroheshin sepse nuk kishte një ligj të veçante për këtë qëllim dhe se nuk dëshironin të ekspozonin qëllimin e tyre. Pjesa më e madhe e aktivitetit të tyre realizohej nga vullnetarë. Shoqata "Nënë Tereza" është nga më të njohurat e këtij lloji, e cila i shpërndante ushqime njerëzve në nevojë nëpërmjet një rrjeti të gjerë vullnetarësh. Vullnetari ishte cilido që ndiente se mund të bënte dicka për njerëzit në nevojë, për fëmijët që të shkolloheshin në gjuhën shqipe, për Kosovën. Prandaj ai ishte një vullnetarizëm masiv, vecanërisht në zonat rurale

(iv) Vihet re njëfarë shkurajimi i njerëzve në lidhje me kontributin vullnetar përmes OJQ-ve, më së shumti e ndikuar nga perceptimi se në veprimtarinë e tyre ka mungesë transparence, aq sa projektet, që bazohen në punën vullnetare, ka raste që shihen me dyshim;

(v) Shumë njerëz, që kontribuan vullnetarisht, janë të shkurajuar pas konfliktit nga mungesa e vëmendjes së shoqërisë ndaj kontributit të tyre në periudhën pas konfliktit. Mësuesit dhe mjekët, të cilësuar si heronj për kontributin që dhanë gjatë funksionimit të sistemit paralel, ndjehen të papërfillur nga trajtimi i sotëm;

(vi) Nga institucionet nuk është bërë kujdes që përvoja historike të evidentohet dhe t'ju transmetohet të rinjve, për të nxitur tek ata ndjenjën e vullnetarizmit.

Figura 4.7: Pjesëmarrja si vullnetarë



Të pyetur rreth kësaj çështje,[136] rreth 68% e të rinjve shprehen se nuk kanë punuar ndonjëherë në ndonjë veprimtari vullnetare (shih Figurën 4.7). Të rinjtë e zonave rurale janë më të gatshëm për të marrë pjesë në veprimtari vullnetare krahasuar me ata të zonave urbane dhe 38% e tyre shprehen se kanë punuar si vullnetarë, kundrejt 27% të të rinjve të qytetit.

Ndjenja e vullnetarizmit është më shumë e zhvilluar tek të rinjtë shqiptarë dhe shumë më pak tek të rinjtë serbë dhe kjo pasqyrohet në faktin se rreth 18% e të rinjve serbë shprehen se kanë marrë pjesë në veprimtari vullnetare, kundrejt 34% të shqiptarëve dhe 27% të të tjerëve. Të rinjtë, që e njohin vullnetarizmin, parapëlqejnë të kontribuojnë në veprimtari në fushën e shëndetit dhe arsimit, veprimtari kulturore dhe të përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike.

Figura 4.8: Perceptimi mbi përfitimet nga puna vullnetare



Vullnetarizmi perceptohet nga të rinjtë më tepër si aktivitet edukues sesa si një aktivitet shoqëror. Pyetjes se çfarë përfitimesh vijnë nga përfshirja në punë vullnetare, një në çdo dy të rinj i përgjigjet se përfitimi kryesor është *aftësimi dhe fitimi i përvojës* dhe vetëm një në çdo katër të rinj konsiderojnë se përfitimi është kontributi i dhënë për zhvillimin e komunitetit (shih Figurën 4.8).

4.3 Pjesëmarrja në demokraci

Dialogu institucional

Veçori për Kosovën është se si qeveria ashtu edhe OJQ-të rinore janë krijuar në të njejtën kohë, pas konfliktit, dhe janë së bashku pa ndonjë traditë e përvojë të gjatë e të pasur bashkëpunimi.

Është pozitiv fakti që në Kosovë ka një institucion të ngarkuar posaçërisht me çështjet rinore: Departamenti i

Kutiza 4.6	*Misioni dhe objektivat e Departamentit të Rinisë*

Misioni:
Fuqizimi i te rinjve dhe krijimi i mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre.

Objektivat:
(i) Krijimi i mundësive për nxitjen, zhvillimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në jetën aktive shoqërore;
(ii) Ofrimi i shërbimeve të barabarta për të gjithë të rinjtë, mundësimi i zhvillimit të aftësive dhe vlerave shoqërore duke respektuar veçoritë individuale

Rinisë në MKRS. Ky Departament ka funksione koordinuese për problematikën rinore me të gjitha institucionet e tjera qendrore të Kosovës. Ai bashkëpunon me Drejtoritë Komunale për Kulturë, Rini e Sport, në nivel Komunash. Departamenti është struktura ku adresohen OJQ-të rinore, Rrjetet Rinore dhe Qendrat Rinore.

Programet e tij të rinisë Departamenti i realizon përmes OJQ-ve rinore, duke financuar disa projekte të tyre me fonde të buxhetit të konsoliduar të Kosoves. Për vitin 2006 rreth 5% e buxhetit të përgjithshëm të MKRS prej 6.3 milion Euro iu akordua Departamentit të Rinisë.

Financimi i OJQ-ve bëhet në bazë projektesh, me përzgjedhje aplikimesh sipas 7 programeve kryesore, që lidhen me fusha të tilla si informimi, nxitja dhe fuqizimi i OJQ-ve, politikat rinore, edukimi jo formal e punësimi, edukimi shëndetësor etj. Duke qenë se fondi i Departamentit për projekte të OJQ-ve është shumë i pakët, synohet që projektet të bashkëfinancohen nga donatorë të ndryshëm mbarëkombëtarë. Banka Botërore është njëri ndër donatorët që do të përkrahë Qendrat Rinore në tri vitet e ardhshme përmes Departamentit të Rinisë, dhe kjo do të jetë një stimulues i mirë për vazhdimin e punës me të rinjtë.

Për të përmbushur objektivin e tij për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore, Departamenti ka përgatitur dy dokumente kryesore:

(i) **Politika Rinore e Kosovës,** i cili i kushton pjesëmarrjes një kapitull të veçantë, duke konsideruar çështje të tilla si forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore, nxitjen e vullnetarizmit dhe kornizën ligjore për pjesëmarrjen e rinisë. Ky dokument synon të angazhojë institucionet e ndryshme të Kosovës në marrjen e masave të posaçme në favor të rinisë, duke i përcaktuar e zbatuar këto masa me anë të dialogut e bashkëpunimit me rininë;

(ii) **Ligji mbi Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë**[137], i cili përcakton konceptet themelore mbi pjesëmarrjen, të drejtat dhe detyrimet e të rinjve, përgjegjësitë e institucioneve qëndrore dhe të atyre komunale. Në bazë të këtij ligji, institucionet qendrore të Kosovës ngarkohen të kenë konsultime të rregullta me të rinjtë dhe t'i informojnë ata dhe organizatat rinore për rregulloret, standardet, procedurat dhe mundësitë e financimit të aktiviteteve të tyre. Besohet se ky ligj do të nxisë krijimin e mekanizmave institucionalë dhe ligjorë për pjesëmarrje të rregullt dhe domethënëse të rinisë, veçanërisht në hartimin dhe zbatimin e politikave sektoriale, që kanë lidhje me interesat e rinisë.

Kutiza 4.7	*Model i suksesshëm pjesëmarrjeje*

Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës 2007-2013 është duke u përgatitur nga një Sekretariat i posaçëm i vendosur pranë Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Për përgatitjen e strategjisë u ngritën tre grupe: Grupi i rrjetit të shoqërisë civile, Grupi makroekonomik dhe Grupi teknik. Hartimi i politikave prioritare u mbështet në një proces të gjerë konsultimesh me organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat rinore. Në shtatë rajone të Kosovës janë organizuar mbi 65 tryeza diskutimi me grupe të shoqërisë civile, shumica të rinj, 10 prej të cilëve me grupe të minoritetit serbë. Me secilin grup debati është përqëndruar në një numër të kufizuar çështjesh ku përfshihen bujqësia, zhvillimi rural, biznesi, arsimi, shëndetësia, kultura, të drejtat e njeriut, infrastruktura, rinia. Rezultatet janë diskutuar edhe në takime më të gjera në të gjitha rajonet e Kosovës. Problematika e zhvillimit e nxjerrë për secilin rajon është kthyer në një grup politikash prioritare të propozuara nga shoqëria civile. Kjo konsiderohet si nisma më serioze e institucioneve të Kosovës për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave të zhvillimit.

Hapat pozitive të ndërmarë nga pikëpamja institucionale për të fuqizuar pjesëmarrjen e rinisë tregojnë se, brenda mundësive dhe përvojës që ka, MKRS ëahtë e angazhuar të nxisë dialogun midis institucioneve dhe rinisë. Por, në

Kutiza 4.8	*Objektivat e politikës së pjesëmarrjes*

(i) Të nxiten dhe sigurohen mekanizma institucionalë për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendim-marrjes;
(ii) Të sigurohet qasje në informacione dhe të rritet transparenca e institucioneve publike në çështjet e të rinjve;
(iii) Të sigurohet përkrahje për sektorin e rinisë në nivel lokal;
(iv) Të mundësohet ndërlidhja e të rinjve kosovarë me të rinj në rajon, Evropë dhe më gjerë;
(v) Të forcohen kapacitetet e rrjeteve dhe OJQ-ve rinore
(vi) Të nxitet dhe njihet puna vullnetare e të rinjve

fakt, çështja e pjesëmarrjes duket se është shumë më komplekse se sa paraqitet në këto dy dokumente, veçanërisht në lidhje me këto aspekte:

(i) **Pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje është një proces përfshirjeje**, ku të rinjtë duhet të jenë aktorë në proces, nëpërmjet një dialogu institucional të vendimmarrësve të të gjitha niveleve me të rinjtë dhe organizatat rinore. Institucionet përgjithësisht kanë një interpretim më të thjeshtëzuar të pjesëmarrjes, i cili kufizohet në mbledhjen e disa komenteve për ndonjë dokument që përgatisin. Kjo ndodh veçanërisht në rastet e dokumenteve strategjikë, ku me pjesëmarrje shpesh kuptohet vetëm një tryezë diskutimi me të rinjtë, në të cilën ata informohen mbi draftin e përgatitur;

(ii) **Këto dy instrumente nuk përcaktojnë se në cilat raste është e domosdoshme pjesëmarrja dhe si duhet realizuar**. Kjo lihet në gjykimin e institucioneve dhe janë nëpunësit ata që përzgjedhin dhe e zbatojnë sipas shkallës së njohurive dhe vullnetit që kanë. Për rastin e përgatitjes së Ligjit për Rininë, dokumentit të Politikës Rinore të Kosovës dhe Planit të Veprimit për Rininë, përfaqësues të Rrjetit Rinor Kosovar, kanë qenë pjesë e Hartimit të Ligjit për fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë si dhe partnerë për Planin Kosovar të Veprimit per Rini[138].

Kutiza 4.9 ***Nisma për punësimin e të rinjve***

Në fillim të muajit dhjetor 2006 u organizua në Prishtinë Konferenca Kombëtare për Punësimin e të Rinjve. Në të morën pjesë përfaqësues të lartë të Qeverisë së Kosovës nga shtatë Ministri kryesore. Në konferencë u paraqit Plani Akcional i Punësimit të të Rinjve në Kosovë, i cili përcakton masat prioritare shumë sektoriale për të krijuar më shumë mundësi punësimi për të rinjtë. Plani u nënshkrua nga Kryeministri i Kosovës dhe përfaqësuesit e lartë të Ministrive dhe kjo ishte shprehje e angazhimit të tyre për të përmbushur detyrimet, që i rrjedhin secilës ministri për zbatimin e këtij plani. Pranimi formal i këtij Plani bie në mandatin e autoriteteve publike si dhe është përgjegjësi e qeverisë së Kosovës të realizojë objektivat e caktuara në këtë Plan, si dhe të monitorijë ndikimin final te tij.

Megjithë faktin se përfaqësuesit e të rinjëve ishin të invulvuar në identifikimin e mangësivë të të rinjëve, të politikave prioritare dhe në formulimin e objektivave specifike, midis numrit të shumtë të përfaqësuesve të ndryshëm në panelet drejtuese të Konferencës dhe folësve vendas dhe të huaj, që kanë ndihmuar për përgatitjen e këtij plani, nuk ishte asnjë përfaqësues i organizatave rinore të Kosovës, për të cilët ishte përgatitur ky plan.

Të rinjtë, nga ana e tyre, e dëshirojnë dialogun institucional për problemet më të rëndësishme të vendimmarrjes, të cilat lidhen me sfidat e zhvillimit politik, ekonomik e shoqëror që po përballon Kosova. Ata shprehen se institucionet nuk e konsiderojnë këtë dialog si të domosdoshëm për punën e tyre dhe aq më pak si një detyrë[139].

Ata e ndjekin punën e institucioneve qeverisëse dhe nuk hezitojnë të japin perceptimin e tyre mbi to. Kështu, afërsisht një në çdo dy të rinj është i kënaqur ose shumë i kënaqur me punën e administratës së UNMIK-ut (shih Figurën 4.9)[140]. Pjesa e pakënaqur i referohet më shumë transferimit të ngadaltë të përgjegjësive tek institucionet vendase. Vlerësimi i referohet, gjithashtu, faktit që shumë vendime të rëndësishme, që merren nga UNMIK, nuk konsiderojnë mendimet e tyre dhe të shoqërisë civile në përgjithësi. Të rinjtë shprehen se pjesëmarrja dhe dialogu institucional duhet të zbatohen nga të gjitha strukturat qeverisëse, përfshirë dhe UNMIK. Si një strukturë qeverisëse ndërkombëtare, UNMIK mund të shërbente si një model i pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe i rinisë në proceset e vendimmarrjes për administratën vendase. Kjo nuk po ndodh në realitet. Të rinjtë nuk janë dakord me mendësinë që UNMIK është i pagabueshëm dhe ajo që thuhet prej administratës së tij duhet konsideruar gjithnjë si tabu.

Figura 4.9: Perceptimi i të rinjve mbi punën e institucioneve



Numri i të rinjve që shprehen të kënaqur dhe shumë të kënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë

është më i madh dhe arrin përkatësisht në 52.5% dhe 52%. Por vetëm një në çdo tre të rinj shprehet i kënaqur me punën e pushtetit lokal. Kjo lidhet me faktin se kjo administratë është më afër komunitetit dhe përballet me problemet e përditshme të njerëzve, përfshirë rininë.

Të rinjtë shqiptarë të kënaqur me punën e strukturave qeverisëse janë më të shumtë se të rinjtë e komuniteteve të tjera. Të rinjtë serbë shprehen dy herë më pak të kënaqur se të rinjtë shqiptarë për punën e administratës së UNMIK-ut dhe rreth 35% e tyre nuk shprehen fare për këtë strukturë. Ky rezultat duket se është i ndikuar më shumë nga vlerësimet e përgjithshme politike se sa nga vlerësimi i veprimtarisë së administratës.

Për punën e Kuvendit të Kosovës shprehen të kënaqur vetëm 7% e të rinjve serbë të pyetur, kundrejt 56% të shqiptarëve dhe 46% të të rinjve të komuniteteve të tjera. Ndërkohë, nuk shprehen fare rreth 38.7% e serbëve dhe 33.8% e të rinjve të komuniteteve të tjera. Po kështu, për punën e Qeverisë së Kosovës shprehen të kënaqur vetëm 8.7% e të rinjve serbë dhe rreth 35% e tyre nuk shprehen fare. Edhe për punën e pushtetit lokal rezultatet janë të ngjashme: rreth 30% e të rinjve serbë nuk shprehen ndërkohë që të kënaqur shprehen vetëm 21% e tyre. Këto vlerësime janë shprehje e një shkalle të ulët integrimi të të rinjve serbë.

Politika – sakrificë, ambicie apo interes?

Politika është një nga temat më të pëlqyera të diskutimit për kosovarët, pavarësisht nga mosha, përkatësia etnike apo statusi social. Kjo lidhet me ngjarjet historike apo me dendurinë dhe me rëndësinë e madhe të vendimeve politike, që janë marrë gjatë kësaj periudhe, të cilat shpesh herë kanë qenë vendimtare për fatet e popullsisë së Kosovës.

Në ndryshim nga vendet e tjera të tranzicionit, politika ka marrë atribute të veçanta në Kosovë edhe nga fakti se shumë çështje, që lidhen me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit, si dhe me jetën e përditshme të njerëzve varen, në radhë të parë, nga vendimet politike të institucioneve ndërkombëtare. Në këtë kuptim, vendimmarrja e politikës vendase, për shumë çështje, perceptohet si e varur nga barometri politik ndërkombëtar. Në mendësinë e kosovarëve, çdo hap i politikës vendase matet me vlerësimet ndërkombëtare. *Po ndërkombëtarët çfarë thonë?* - është shprehja më e përdorur për shumë vendime që merren.

Të rinjtë ndajnë opinione të ndryshme mbi pjesëmarrjen e tyre në politikë[141]. Perceptimi i disave është se për t'u përfshirë në politikë, një i ri duhet të jetë i shkolluar, të ketë kurajo, energji dhe dëshirë për t'i shërbyer vendit.

Figura 4.10: Interesi për t'u marrë me politikë



A mendoni të merreni vullnetarisht me politikë?

Këta mendojnë se të merresh me politikë duhet përkushtim, shpenzim kohe, përfshirje në debate, përballje me trysni të opinionit publik etj. Të gjitha këto janë sakrifica personale e familjare të kushtueshme, por që ia vlejnë të bëhen në të mirë të përparimit të vendit.

Të rinj të tjerë e vlerësojnë pjesëmarrjen në politikë si ambicie personale të disa individëve, të cilët futen në politikë me pretendimin që të bëjnë karrierë. Në këtë rast interesi i individit për përfitime personale është shtysa kryesore për t'u përfshirë në politikë. Këtij i shtohet edhe mendimi se politika nuk merret dhe nuk jep ndonjë kontribut për zgjidhjen e problemeve kryesore të njerëzve. Ky perceptim ndikon negativisht tek dëshira e të rinjve për të kontribuar në jetën politike të Kosovës. Rreth 93.5% e të rinjve të pyetur shprehen se politika është jashtë interesit të tyre dhe se nuk mendojnë të merren ndonjëherë vullnetarisht me politikë (shih Figurën 4.10)[142]. Në këtë opinion nuk ka dallime të mëdha midis të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike. Në Mitrovicë të rinjtë janë larguar gjithnjë e më shumë nga politika sepse nuk shohin zgjidhje prej saj[143]. Secili mendon se si të gjejë ndonjë punë për të mbijetuar. Shumica e të rinjve janë në favor të një angazhimi "*fleksibël*" në shoqata apo klube rinore edhe jo për një angazhim "*formal*" në partitë politike[144].

Interesi i pakët i rinisë për t'u marrë me politikë në krahasim me brezin e mëparshëm përputhet edhe me tendencat e rinisë në shumicën e vendeve të tjera, ku, vitet e fundit, është dëshmuar se partitë politike kanë vështirësi të tërheqin të rinjtë.[145]

Rinia nuk ka qasje të mjaftueshme në vendimmarrjen politike. Duke mos u anëtarësuar në forumet rinore të partive, ajo është jashtë procesit të vendimmarrjes që zbatojnë partitë politike brenda strukturave të tyre. Jashtë këtij procesi, ato nuk praktikojnë ndonjë qasje pjesëmarrjeje për të rinjtë, me përjashtim të rasteve të fushatave elektorale.

Edhe përfaqësimi i të rinjve në nivelet e ndryshme politike vlerësohet nga të rinjtë se është shumë i pakët. Numri i politikanëve të rinj në pozicione drejtuese është mjaft i

Figura 4.11: Përfaqësimi në politikë



A mendoni se rinia është e përfaqësuar sa duhet në politikë?

Figura 4.12: Interesi për të marrë pjesë në votime



A do të votoni në zgjedhjet e ardhshme?

vogël. Rreth 70% e të rinjve të pyetur shprehen se rinia nuk është e përfaqësuar sa duhet në politikë (shih Figurën 4.11)[146].

Pjesëmarrja në votime

Ushtrimi i të drejtës për të votuar është një formë tjetër e pjesëmarrjes së të rinjve në demokraci. Në këtë aspekt, Kosova paraqet një model paksa të ndryshëm nga vendet e tjera të tranzicionit. Në shumicën e këtyre vendeve ka një rënie të përgjithshme të interesit të popullsisë për të shkuar në votime. Tek të rinjtë kjo është edhe më e theksuar se tek më të rriturit. Në Bosnje dhe Hercegovinë, për shembull, vetëm rreth 1/3 e të rinjve marrin pjesë në votime[147]. Kjo mungesë interesi në shumicën e vendeve lidhet me zhgënjimet nga tranzicioni dhe mosbesimin se klasa politike e votuar do të jetë e angazhuar të përmbushë premtimet e marra ndaj votuesve.

Edhe në Kosovë numri i votuesve të rinj ka ardhur duke u zvogëluar, sepse, siç shprehen të rinjtë, interesi dhe angazhimi i të zgjedhurve në problemet e rinisë vlerësohet se ka qenë gjithnjë e më i pakët dhe se ata shohin se zgjedhjet nuk sjellin ndonjë përmirësim të gjendjes së përgjithshme në Kosovë dhe, veçanërisht të rinisë[148]. Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhjet e fundit lokale e parlamentare ishte rreth 49%, kur numri i përgjithshëm i votuesve ishte rreth 53% të popullsisë në moshë për të votuar[149].

Megjithatë, për zgjedhjet e ardhshme, vihet re një rritje e konsiderueshme e interesit të të rinjve. Rreth 81.4% e tyre shprehen se këtë radhë do të votojnë me shpjegimin se këto do të jenë zgjedhjet e para pas shpalljes së Statusit përfundimtar të Kosovës (shih Figurën 4.12)[150].

Këtë mendim e kanë rreth 83.1% e të rinjve shqiptarë të pyetur dhe rreth 63.5% e të rinjve të komunitetit serb. Interesi i të rinjve ndaj votës së tyre shprehet, gjithashtu, në vlerësimet që ata japin për proceset zgjedhore. Vetëm rreth 38% e të rinjve e konsiderojnë procesin e sotëm zgjedhor me lista të mbyllyra si të ndershëm e demokratik dhe një pjesë e konsiderueshme mendojnë se ky është më shumë një sistem zgjedhor i kushteve të emergjencëss që ka nevojë për përmirësime rrënjësore (shih Figurën 4.13).

Figura 4.13: Vlerësime mbi sistemin e zgjedhjeve në Kosovë



Besimi tek mediat

Mediat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e angazhimit qytetar të rinisë dhe të pjesëmarrjes aktive të saj në jetën politike e shoqërore të vendit, por ndikimi i tyre tek të rinjtë varet shumë nga shkalla e besimit që ata kanë tek mediat.

Besimi i rinisë tek media është i ndryshëm në vende të ndryshme dhe në përgjithësi kjo është e lidhur ngushtë me nivelin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të Kosovës. Po të nisesh nga renditja e vendeve sipas shkallës së të ardhurave të tyre, vërehet që besimi tek media është ulur ose ka mbetur i pandryshuar tek vendet me nivel të

mesëm dhe të lartë të ardhurash dhe ka pësuar rritje të dukshme në vendet me të ardhura të ulëta[151]. Në vendet e Bashkimit Europian besimi tek mediat është relativisht i ulët, me përjashtim të vendeve Skandinave[152].

Figura 4.14: Vlerësime mbi besueshmërinë e mediave në Kosovë



Roli i mediave në nxitjen e angazhimit qytetar të rinisë dhe për informimin e tyre mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm në Kosovë, ku besimi i të rinjve tek mediat është në një shkallë të konsiderueshme.

Pyetjes se sa janë të besueshme mediat e Kosovës, rreth 73% e të rinjve i përgjigjen se ato janë shumë të besueshme ose të besueshme deri diku, dhe vetëm rreth 5% e tyre shprehen se mediat nuk janë aspak të besueshme (shih Figurën 4.14)[153]. Më të besueshme mediat janë për të rinjtë shqiptarë, gjë që shprehet me faktin se rreth 80% e tyre i vlerësojnë mediat si shumë të besueshme ose të besueshme deri diku. Mediat janë më pak të besueshme për të rinjtë e komunitetit serb. Vetëm një në çdo tre të rinj serbë i konsideron mediat si shumë të besueshme ose të besueshme deri diku.

Mediat në Kosovë konsiderohet se janë në fazën fillestare të zhvillimit. Organizatat ndërkombëtare kanë financuar projekte për rritjen e kapaciteteve të tyre nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për gazetarët dhe moderatorët e rinj. Megjithëse niveli vjen duke u rritur, pranohet nga të gjithë se mediat e Kosovës kanë ende një rrugë të gjatë për të përshkuar, që të mund t'i përgjigjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm kërkesës në rritje të shoqërisë ndaj tyre.

Të rinjtë sot kanë qasje në një sërë burimesh mediatike elektronike dhe të shkruara, të tilla si radioja, televizioni, shtypi, interneti etj. Shumica e këtyre janë burime private informimi. Televizioni është burimi kryesor i informimit dhe media më e shfrytëzuar nga të rinjtë për t'u informuar. Radio është burimi i dytë dhe më pas shtypi dhe interneti. Kjo renditje është e njëjtë për të gjitha grupet etnike.

Të rinjtë shqiptarë parapëlqejnë transmetimin më të shpeshtë të emisioneve arsimore dhe edukative, ndërsa të rinjtë serbë tërhiqen më shumë nga transmetimi i ngjarjeve sportive. Vetëm rreth 155 nga 1200 e të intervistuarve ndjekin dhe pëlqejnë edicionet e lajmeve apo edicionet informative. Po kështu, vetëm 1% e të rinjve të pyetur shprehen se parapëlqejnë të ketë më shumë emisione me përmbajtje fetare.

Media i kushton kohë dhe hapësirë të konsiderueshme të rinjve, por shumë më tepër të rinjve shqiptarë. Të rinjtë e komunitetit serb shprehen shumë më pak të kënaqur ne krahasim me të rinjtë shqiptarë për shumicën e mediave të shkruara dhe elektronike. Ndërsa të rinjtë e komuniteteve të tjera etnike shprehen se në media ka më pak hapësirë për ta në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së Kosovës.

Figura 4.15: Mediat dhe nevojat e të rinjve



Megjithatë, kërkesat e të rinjve ndaj mediave janë shumë më të mëdha dhe kjo vjen edhe ngaqë të rinjtë bëjnë krahasimin me mjetet e huaja të komunikimit të pranishme ose jo në Kosovë. Në këtë këndvështrim, pyetjes nëse mediat e Kosovës i përmbushin nevojat e të rinjve, më pak se 8% e të rinjve i përgjigjen se ato i përmbushin plotësisht. Mendimi i përgjithshëm i shprehur nga rreth 55% e të rinjve është se mediat i përmbushin shumë pak kërkesat e të rinjve (shih Figurën 4.15).

4.4 Politika dhe masa prioritare

Krijimi i kulturës së pjesëmarrjes

Institucionet publike, OJQ-të rinore dhe mediat duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e masave dhe

veprimtarive të domosdoshme, që ndihmojnë në krijimin e kulturës së pjesëmarrjes tek publiku i gjerë, por veçanërisht tek administrata publike, familjet dhe të rinjtë. Përfshirja e Edukatës Qytetare si një lëndë e veçantë në arsimin formal mund të jetë një mënyrë e mirë për të mesuar tek të rinjtë qytetarinë.

Plotësimi i kuadrit ligjor

Zbatimi i parimit të pjesëmarrjes së të rinjve lidhet me përgatitjen e një kuadri ligjor e rregullues, i cili jo vetëm e njeh këtë si një të drejtë të të rinjve dhe si një detyrë të institucioneve publike, por edhe përcakton qartë rregullat e vendosjes së një dialogu institucional, duke saktësuar të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e secilit aktor. Demokratizimi dhe transparenca e marrëdhënieve midis institucioneve publike dhe qytetarëve, integriteti i nëpunësve publikë, konflikti i interesave në administratën publike, përmirësimi i qasjes në informacion, krijimi i mekanizmave të transparencës, standardeve etike etj. janë disa nga komponentet më kryesore të këtij dialogu.

Mbështetja e projekteve të pjesëmarrjes

Autoritetet publike duhet të mbështesin nismat e të rinjve që kanë lidhje me pjesëmarrjen. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me mbështetjen financiare por edhe me lehtësimin e procedurave administrative, këshillimin apo ekspertizën për të rinjtë, sidomos për ata që janë më të disavancuar ose më të izoluar gjeografikisht. Për mbështetje të tilla duhet të ndërmerren fushata informimi, që këto të mos mbeten në duart e një grupi të privilegjuar të rinjsh, si dhe të nxiten donatorët e interesuar për t'i financuar me përparësi.

Monitorimi i zbatimit të politikave

Të rinjtë duhet të përfshihen gjerësisht në procesin e monitorimit të vendimmarrjes dhe të zbatimit të politikave qeveritare, që kanë lidhje të drejtpërdrejt me interesat jetike të qytetarëve në përgjithësi dhe të të rinjve në veçanti. Monitorimi i strategjive të shumta të reformave sektoriale, lufta kundër korrupsionit, transparenca dhe cilësia e shërbimeve të administratës publike etj. janë disa nga drejtimet më kryesore, ku mund të nxitet roli aktiv i orgnizatave rinore.

SHTOJCA 1

Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor - Kosova 2006

Në kuadrin e përgatitjes së Raportit të Zhvillimit Njerëzor -2006 u realizua një anketim nga Integra Consulting, i cili pati si synim kryesor evidentimin e perceptimeve dhe kryerjen e analizave mbi arritjet dhe problemet e rinisë në Kosovë. Rezultatet e anketës janë përdorur në Raport krahas të dhënave dhe informacioneve të siguruara nga institucionet publike statistikore të Kosovës, institucionet ndërkombëtare si dhe publikime të autorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj.

Mostra

Mostra është strukturuar dhe mbështetur në dy kritere kryesore: grupmosha dhe përkatësia etnike. Mostra përfshin 1200 persona të moshës 15 deri në 29 vjeç, 800 prej të cilëve janë Kosovarë Shqiptarë, 200 Kosovarë Serbë dhe 200 nga minoritetet e tjera. Mostra përfshin zonat urbane dhe rurale të Kosovës. Shpërndarja gjeografike e mostrës sipas etnive paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

Tabela 1: Shpëndarja gjeografike dhe etnike e mostrës

Rajoni	Komuna	Shqiptarë	Serbë	Minoritete të tjera	Totali
Mitrovicë	Mitrovica, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Vushtrri, Skenderaj	90	84	32	206
Prishtinë	Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushe Kosovë, Shtime, Gllogovc, Lypjan	302	42	45	389
Gjilan	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novoberdë	69	36	7	112
Ferizaj	Ferizaj, Shtërpcë, Kaçanik,	51	7	2	60
Prizren	Prizren, Suharekë, Dragash, Malishevë	141	7	80	228
Gjakovë	Gjakovë, Rahovec	63	8	2	73
Pejë	Pejë, Istog, Klinë, Deçan	84	16	32	132
Gjithsej		800	200	200	1,200

Figura 1: Shpërndarja e Mostrës sipas komunave



55.4% e të intervistuarve gjatë anketimit banojnë në zonat rurale dhe 44.6% në zonat urbane. Shpërndarja e mostrës në zonat rurale dhe urbane sipas përkatësive etnike paraqitet në tabelën e mëposhtëme. Numri i të intervistuarve nga zona rurale është më i lartë tek minoriteti serb.

Tabela 2: Shpërndarja e mostrës sipas etnive dhe zonës rurale dhe urbane (%)

	Shqiptarë	Serbë	Minoritete të tjera	Totali
Rurale	54.4	66.0	49.0	55.4
Urbane	45.6	34.0	51.0	44.6

Pyetsori

Përgatitja e pyetsorit u realizua nga ekspertët e Integra Consulting në bashkëpunim me UNDP. Ai përbëhet nga 100 pyetje kryesore të grupuara në 9 kapituj, të cilat mbajnë parasysh strukturën e Raportit të Zhvillimit Njerëzor dhe problematikën që ai trajton. Pyetjet në secilin kapitull japin informacione të ndryshme si: të dhëna të përgjithshme për të intervistuarin, të dhëna për familjen, pjesmarrja e rinisë në shoqëri, marëdhëniet sociale të rinisë, qasja e rinisë në shërbimet publike dhe në infrastrukture si dhe rinia lidhur me arsimin, statusin social, zhvillimin dhe politikën. Pyetjet kanë synuar marrjen e një informacioni sa më të gjerë dhe të përditësuar për rininë në Kosovë. Përveç pyetjeve që kanë në fokus të intervistuarin, një pjesë e pyetjeve synojnë të tërheqin perceptimin e të intervistuarit nga këndvështrimi i familjes në të cilën ai bën pjesë.

Kryerja e anketimit dhe metodologjia

Zbatimi praktik i anketës kaloi në disa faza. Fillimisht është bërë përgatitja e 30 intervistuesve lidhur me kon-

tekstin e përgjithshëm të anketës dhe të pyetsorit si dhe pyetjeve konkrete të tij. Testimi i pyetsorit u bë në Prishtinë. Zgjedhja e të intervistuarve ishte e rastësishme dhe numri i intervistimeve për efekte pilotimi ishte 30 ose 2.5% e mostrës. Së bashku me intervistuesit në procesin e pilotimit morën pjesë edhe ekspertë të përfshirë në përgatitjen e pyetsorit. Vërejtjet e grumbulluara nga intervistuesit u reflektuan në pyetsorin përfundimtar.

Anketa u bë ballë për ballë dhe të intervistuarit u përzgjodhën në mënyrë të rastësishme në zonat e paracaktuara nga Integra Consulting duke ruajtuar konfidencialitetin e tyre. Intervistuesit kanë treguar kujdes për të marrë sa më shumë përgjigje nga të intervistuarit. 34% e numrit të përgjithshëm të pyetsorëve të plotësuar në terren janë kontrolluar për të provuar vërtetësinë e tyre. Kjo u krye përgjatë zbatimit të anketimit në terren, dhe një pjesë e intervistave u kryen në prezencën e supervizorëve të Integra Consulting. Gjithashtu rreth 10% e personave të intervistuar, të cilët kishin bërë të dituar tek intervistuesit kontaktet e tyre u pyetën dhe konfirmuan që ishin intervistuar. Në procesin e intervistimit 24 persona refuzuan të intervistoheshin për arësye të mungesës së kohës apo mungesës së dëshirës dhe më shumë se gjysma e refuzuesve ishin në Prishtinë. 8 pyetsorë u deklaruan të pavlefshëm si rezultat i parregullsisë së informacionit në to.

2. Diskutimet në fokus grupe

Integra Consulting organizoi diskutime me nëntë fokus grupe me qëllim që të realizonte një vlerësim cilësor mbi çështjet që paraqisnin interes të veçantë. Grupet e fokusuara u përcaktuan në bashkëpunim me ekspertë të UNDP dhe përfshinin studentë, komunitetin e biznesit, aktivistët politikë dhe politikanët, prindërit, të papunët, veteranët e luftës, artistët, nëpunës civilë dhe minoritetet.

Gjithashtu UNDP organizoi shtatë debate publike me studentë, nxënës të shkollave të mesme, aktivistë të OJQ-ve, aktivistë te forumeve rinore të partive politike, gazetarë etj, në gjashtë qytete të Kosovës (Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovice, Rahovec) dhe një debat u organizua në Universitetin e Prishtinës në departamentin e sociologjisë. Në të gjitha takimet pjesmarrja ishte e konsiderueshme dhe aty morën pjesë edhe të rinjtë e komunave nga; Prizreni, Dragashi, Deqani, Istogu, Klina, Suhareka, Malisheva, Skenderaj, Kamenica, Novoberda, Zubin Potoku dhe Vitia.

Bibliografia

- Agjencioni për zhvillim të Arsimit - Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim, Procesi i statusit të ardhshëm të Kosovës, 19 korrik 2006
- Banka Botërore, Anketa për matjen e standardit të jetesës, Prishtine 2001, marrë nga http://www.worldbank.org/LSMS/country/kosovo/docs/KOSBID.pdf në 2006
- Banka Botërore, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, 16 qershor 2005 marrë nga http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Country%20Home/20662049/Kosovo_PA_report_final-16June2005.pdf in 2006
- Banka Botërore, Vlerësimi i varfërisë së Kosovës, Prishtine 20 dhjetor 2001 Parashikime
- D. Pupovci, Endrra për arsimim shumëetnik-trillim dhe realitet në arsimin e lartë në Kosovën e sotme, Prishtine, maj 2006
- Enti Statistikor i Kosovës, Kosova në shifra 2005, janar 2006, marrë nga http://www.ks-gov.net/esk/esk/pdf/english/general/kosovo_figures_05.pdf in 2006 ne 2006.
- EU White Paper, CEC, 2001
- European Training Foundation, Country Self Study on VET Financing, draft document, 2006
- IARD ((The Institute for Foreign Language Teaching Research from Milan), Study on the state of young people and youth policy in Europe, January 2001 marrë nga http://ec.europa.eu/youth/doc/studies/iard/summaries_en.pdf in 2006.
- International Labor Organization, Stimulating Youth Entrepreneurship: Barriers and incentives to enterprise start-ups by young people, 2006 retrieved from http://www.ilo.org/dyn/empent/docs/F2125512235/WP76-2006-Rev.pdf in 2006.
- International Monetary Fund, Aide Memoire, 2006
- Këshilli Qëndror i Zgjedhjeve, Rezultatet e zgjedhjeve, 2002 dhe 2004
- Kosovo Civil Society Foundation, Mapping analyses of civil society in Kosovo, September 2005,
- Likaj. R, Ismajli F, Country Peer Review, a World Bank study, 2006
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Strategjia e Kosovës për zhvillimin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 2007-2013, 2006
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015, Prishtinë 2004
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve 2006-2008, mars 2006, marrë nga http://www.seerecon.org/kdm/Kosovo%20MTEF%20March%2022%202006.pdf në 2006.
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Përmbledhje mujore e ekonomisë së Kosovës, korrik 2006
- Ministria e Kulturës,Rinise dhe Sportit, Departamenti i Rinisë, "Politika Rinore e Kosovës", draft publik, tetor 2006
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor për zhvillimin e Kosovës, Prishtinë 2005.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës 2005-2015, dhjetor 2005
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Punës dhe Punësimit, Promovimi i Punësimit – raport i performancës 2005/2006, qershor 2006
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Plani aksional i punësimit të të rinjve në Kosovë, Prishtinë tetor 2006
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor, Prishtine, 2005.
- Organizata per Aktivitetet e Popullatës e Kombeve të Bashkuara, Situata demografike, sociale dhe riprodhuese në Kosovë, Prishtine korrik 2003 marrë nga http://www.unfpakos.org/docs/DHS-2003/English.pdf më 2006.
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim e Europës-Misioni në Kosovë: Asambletë e të rinjve për zhhvillim të komuniteteve, 2006, marrë nga: http://www.osce.org/kosovo më 2006.
- Organization for Economic Cooperation and Development, Education at a Glance, 2005
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2004. Oxford: Oxford University Press, 2004 marrë nga http://hdr.undp.org/reports/global/2004/pdf/hdr04_complete.pdf më 2006.
- Pupovci D., Georg L.F. Woeber, Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë problemet, zgjidhjet dhë mësimet, Prishtine, Maj 2006 marrë nga http://www.kec-ks.org/botimet/education.pdf ne 2006.
- Qendra për Arsim e Kosovës, Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor, 2006
- Qeveria e Kosovës, Plani akcional i punësimit të të rinjve në Kosovë, Prishtinë, tetor 2006
- Qeveria e Kosovës, Plani i implementimit të standardeve për Kosovën, korrik 2004
- Rinia në Evropën Juglindore – Raport nga Konferenca e Romës mbi Pjesëmarrjen, Fuqizimin dhe Përfshirjen Sociale,qershor 2002
- Sommers, M. dhe Buckland, P., Parallel worlds - Rebuilding the education system in Kosovo; IIEP, UNESCO, 2004 marrë nga http://www.unesco.org/iiep/PDF/pubs/kosovo.pdf në 2006.
- United Nations Children's Fund and World Bank, Youth in South Eastern Europe, June 2002
- United Nations Children's Fund, The Children-Adolescence, Pristina, 2006
- University of Graz, Education and Media in Southeast Europe - Country reports, 1999 marrë nga http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/csbsc/country_reports/index.htm në 2006.

- Valli Corbanese, Gianni Rosas, Young people's transition to decent work: evidence from Kosovo, ILO, November 2006.
- World Bank, Kosovo- Public Expenditure and Institutional Review, September 2006
- World Bank, World Development Report 2007, retrieved from: http://wwwwds.worldbank.org/external/default/main?pagePK=64193027&piPK=64187937&theSitePK=523679&menuPK=64187510&searchMenuPK=64187283&theSitePK=523679&entityID=000112742_20060913111024&searchMenuPK=64187283&theSitePK=523679 in 2006.

Fusnotat

1. Per qëllim të këtij raporti, termi 'rinia' dhe ' të rinjtë' i referohën atyre të moshës 15-29 vjeq.
2. UNICEF and World Bank, Youth in South Eastern Europe, June 2002.
3. Ky përcaktim është përfshirë në projektin e Ligjit "Mbi fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë", i cili është në procesin e miratimit nga Kuvendi i Kosovës.
4. ESK, Kosova në shifra 2005, Prishtinë, janar 2006.
5. Banka Botërore, Anketa për matjen e standardit të jetesës, Prishtine 2001.
6. Ekonomitë familjare janë bashkësi të personave që jetojnë së bashku, ushqehen së bashku dhe i përdorin bashkërisht të ardhurat e tyre.
7. UNFPA, Situata demografike, sociale dhe riprodhuese në Kosovë, Prishtinë korrik 2003.
8. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
9. Po aty.
10. Nga tryeza e debatit të të rinjve në Gjilan, 14 nëntor 2006
11. Nga tryeza e debatit të të rinjve në Pejë, 9 nëntor 2006.
12. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
13. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
14. Po aty.
15. Nga tryeza e debatit të të rinjve në Gjilan, 14 nëntor 2006
16. Nga tryeza e debatit të të rinjve në Rahovec, 23 nëntor 2006
17. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
18. WB, UNICEF, Youth in South Eastern Europe, June 2002.
19. Nga tryeza e debatit të prindërve në Prishtinë, 9 gusht 2006.
20. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, qershor 2006.
21. Nga tryeza e debatit të të rinjve minoritarë në Prishtinë, 8 gusht 2006.
22. EU White Paper, CEC, 2001.
23. MKRS, Politika Rinore e Kosovës (draft publik), 27 tetor 2006.
24. Qeveria e Kosovës, Plani i implementimit të standardeve për Kosovën, korrik 2004.
25. Banka Botërore, Vlerësimi i varfërisë së Kosovës, Prishtinë 20 dhjetor 2001.
26. Parashikime nga FMN, IMF Aide Memoire, May 2006 dhe për të dhënat e 2004 2006 nga IMF Aide Memoire, February 2007.
27. Ministria e Ekonomisë dhe Financës, Kuadri Afatmesëm i Shpenzimeve 2006-2008, mars 2006.
28. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
29. IMF, Aide Memoire, 2006.
30. Kosova është shtuar për qëllime krahasimi nga autorët e RZHNJ në bazë të vlerës së përafërt të dërgesave.
31. Në bazë të reportit të ESI-t, 'Cutting the Lifeline" i 18 shtatorit 2006, vërehet një ulje e dërgesave të parave në përgjithsi. Mirëpo, raporti i fundit i FMN (IMF Aid Memoire of 19-27 February 2007), tregon se gjatë dy viteve te fundit, megjithatë, ka pasë një rritje në dërgimin e parave.
32. Një numër i madh emigrantësh janë kthyer pas vitit 1999 nga Gjermania apo Anglia, të cilat para dhe gjatë konfliktit të Kosovës aplikuan rregulla lehtësuese për pritjen e emigrantëve nga Kosova.
33. Banka Botërore, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, 16 qershor 2005.
34. Po aty.
35. Banka Botërore, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, 16 qershor 2005.
36. Banka Botërore, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, 16 qershor 2005.
37. AED - USAID, Procesi i statusit të ardhshëm të Kosovës, 19 korrik 2006.
38. Nga tryezat e debatit të të rinjve në Prishtinë, Gjilan dhe Ferizaj, gusht-nëntor 2006
39. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani hapësinor i Kosovës 2005-2015, dhjetor 2005.
40. Nga tryeza e debatit të të rinjve në Prishtinë, 8 gusht 2006.
41. UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2004.
42. Meqë regjistrimi i fundit i besueshëm i popullatës daton në vitin 1981, aktualisht një pjesë e madhe e statistikave në Kosovë janë vlerësime të përafërta. Me këtë konsiderim, treguesit për kokë banori gjithashtu janë vlerësime të përafërta. Gjatë përpilimit të këtij raporti, ekipi jonë u ballafaqua me dilemën se a do të duhej të paraqiteshin shtrirjet e vlerave të çdo treguesi apo të paraqiteshin vlerat e tyre mesatare. Për hir të qartësisë, ekipi vendosi që vlerat mesatare të çdo kalkulimi të prezantoheshin"
43. Figura 1.13 ndërlidhet me figurat e renditura në vazhdim; 1.14, 1.15 dhe 1.16 të cilat kanë për qëllim të sqarojnë se si vendet me indeks të lartë të zhvillimit njerëzor, mund të përmbajnë indikatorë me vlera më të ulëta. Kjo është pjesë e metodologjisë së indekseve të zhvillimit njerëzor global. Vlerat janë marrë nga vite të ndryshme.
44. Për krahasimet e treguesve janë përdorur vlerat e Raportit Global të Zhvillimit Njerëzor 2005, të cilat u referohen të dhënave të vitit 2003.
45. Të dhënat e vitit 2001 dhe 2004 janë marrë nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2004
46. Informata më të detajizuara në lidhje me IVNJ-1 dhe IVNJ-2 mund të gjinden gjatë një rishikimi të Raportit të Zhvillimit Njerëzor 2006 l cili gjindet në faqen e internetit: http://hdr.undp.org/hdr2006/pdfs/report/Techinical_notes.pdf. Në mesin e disa spcifikave janë edhe "probabiliteti në lindje i atyre që nuk mbijetojnë deri në moshën 40 vjeç, përqindja e popullatës pa qasje të qëndrueshme në ujin e pijshëm, dhe përqindja e njerëzve të cilët jetojnë nën linjën e varfërisë."
47. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
48. UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.
49. Të dhënat e vitit 2001 dhe 2004 janë marrë nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2004.
50. Për këtë arsye arsimimit dhe punësimit të të rinjve i kushtohen edhe dy kapituj të veçantë të këtij raporti, ku analizohet gjendja dhe rekomandohen masa e politika prioritare specifike.
51. Sommers, M. dhe Buckland, P.: Parallel worlds - Rebuilding the education system in Kosovo; IIEP, UNESCO, 2004.
52. University of Graz, Education and Media in Southeast Europe – Country reports, 1999.

53 Sistemi tradicional i shkollimit në Kosovë ka perfshirë 4 vite të shkollimit fillor të detyruar dhe katër vite tjera të shkollimit të ulët të mesëm. Ndërkohë që shkollimi i mesëm i lartë gjithashtu ka përfshirë 4 vite.

54 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

55 Nga tryeza e debatit me prindërit e të rinjve në Prishtinë, 9 gusht 2006.

56 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

57 Sipas të dhënave të Bankës Botërore, shkalla e regjistrimit në arsimin fillor në vendet e BE-15 është 100%.

58 Qendra për Arsim e Kosovës, Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit

59 UNICEF, The Children-Adolescence, Pristina, 2006.

60 Qendra për Arsim e Kosovës, Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor, 2006.

61 The World Bank, Kosovo-Public Expenditure and Institutional Review, September 2006.

62 MASHT, Plan strategjia e zhvillimit të arsimit, shkencës dhe teknologjisë 2007-2013.

63 ESK, Kosova në shifra 2005, Paga mesatare më e ulët prej 163 Euro në muaj, është ajo e punonjësve të shëndetësisë, por aty përfshihet edhe personeli i pakualifikuar dhe i mesëm i këtij sektori.

64 Paga mesatare e këtij sektori është 164 Euro në muaj.

65 ETF, Country Self Study on VET Financing, draft dokument, 2006

66 Likaj. R, Ismajli F, Country Peer Review, a World Bank study, 2006.

67 Po aty.

68 Sipas të dhënave të Universitetit të Prishtinës.

69 OECD, Education at a Glance, 2005.

70 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtine, qershor 2006.

71 Po aty.

72 Nga tryeza e debatit me studentët e Universitetit të Prishtinës, 7 gusht 2006.

73 Nga tryeza e debatit me prindërit e të rinjve, Prishtinë, 9 gusht 2006.

74 D.Woeber G., Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë, problemet, zgjidhjet dhe leksionet, Prishtinë, maj 2006.

75 Riinvest, 2004.

76 MASHT, Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015, Prishtinë 2004.

77 Nga tryeza e debatit me përfaqësues të komunitetit të biznesit, Prishtinë, 3 gusht 2006.

78 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

79 MASHT, Strategjia e Kosovës për zhvillimin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 2007-2013, 2006.

80 D. Pupovci, Endrra për arsimim shumë etnik-trillim dhe realitet në arsimin e

81 The World Bank, Kosovo- Public Expenditure and Institutional Review, September 2006.

82 Vendet të cilat ju bashkuan Bashkimit Europian në 2004 janë; Polonia, Estonia, Hungaria, Latvia, Sllovakia, Sllovenia, Republika Çeke, Qirpoja dhe Malta.

83 Georg L.F. Woeber, Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë problemet, zgjidhjet dhe mësimet, Prishtine, Maj 2006.

84 Nga tryeza e debatit me të rinjtë e Ferizajt, 11 nëntor 2006.

85 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

86 Valli Corbanese, Gianni Rosas, Young people's transition to decent work: evidence from Kosovo, ILO, November 2006.

87 Kjo nënkupton punësimin në një kompani të regjistruar dhe me kontratë pune, sipas kritereve të Organizatës Botërore të Punës (OBP).

88 MPMS, Plani akcional i punësimit të të rinjve në Kosovë, Prishtinë, tetor 2006.

89 UNDP,Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

90 Nga tryeza e debatit të të rinjve në Prishtinë, 5 gusht 2006.

91 Carbanese V., Rosas G., Young people's transition to decent work: Evidence from Kosovo, ILO, November 2006

92 Të dhënat nga MFE, tetor 2006.

93 MPMS, Plani aksional i punësimit të të rinjve në Kosovë, Prishtinë tetor 2006.

94 Po aty.

95 UNDP Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

96 ESK, Kosova në shifra 2005, janar 2006.

97 Nga tryeza e debatit të të rinjve në Prishtinë, 5 gusht 2006.

98 Nga tryezat e debatit të të rinjve në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj e Rahovec, gusht-nëntor 2006.

99 Nga tryeza e debatit të të rinjve në Prishtinë, 5 gusht 2006.

101 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani hapësinor i zhvillimit të Kosovës, Prishtinë 2005.

102 UNMIK Regulation 2001/9 on the Constitutional Framework of Self-Government in Kosovo.

103 UNMIK Regulation 2004/18 on the Promulgation of the Gender Equality Act of Kosovo.

104 Valli Corbanese, Gianni Rosas, Young people's transition to decent work: evidence from Kosovo, ILO, November 2006.

105 MPMS, Puna dhe punësimi, Raporti vjetor, Prishtine, 2005.

106 MFE, Përmbledhje mujore e ekonomisë së Kosovës, korrik 2006

107 MPMS, Plani akcional i punësimit të të rinjve në Kosovë, tetor 2006.

108 Këto kategori, 'Të kualifikuar' dhe 'Të pakualifikuar' janë standarde të vëna nga Korniza Europiane e Kualifikimit.

109 Nga tryeza e debatit të të rinjve në Gjilan, 14 nëntor 2006.

110 Nga tryeza e debatit të të rinjve në Prishtinë, 3 gusht 2006.

111 ILO, Stimulating Youth Entrepreneurship: Barriers and incentives to enterprise start-ups by young people, 2006.

112 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006

113 Nga takimi mbi mjedisin e biznesit me të rinjtë e Prishtinës, 3 gusht 2006.

114 Të dhënat mbi aftesimin profesional janë marrë nga Raporti Vjetor për vitin 2005 i shërbimit publik të punësimit

115 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor Kosova 2006, Prishtinë,qershor 2006

116 Të dhënat mbi aftesimin profesional janë marrë nga Raporti Vjetor për vitin 2005 i shërbimit publik të punësimit

117 Në vitin 2005 OBP ka vlerësuar efektin e shërbimeve të punësimit nëpër-mjet një vrojtimi. Ka rezultuar se ndër personat e intervistuar të diplomuar në Qendrat e Aftësimit Profesional janë punësuar dhe vetëpunësuar rreth 40.8% e meshkujve dhe 28.1%e femrave. 118. Kjo Ministri është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të politikave të shërbimit publik, zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit civil dhe sistemin e pagesave të punonjësve publikë (Aneksi IX i rregullores së UNMIKut, Nr. 2005/15)

119 Rregulloja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe 12 Udhëzimet ekzistuese që rrjedhin prej saj.

120 IKAP është institucioni kryesor përgjegjës për trainimin e punonjësve të shërbimit civil në Kosovë.

121 European Commission, White Paper – a new impetus for European youth, November 2001. 122. Tokenizmi është fenomeni kur duket se të rinjve u është dhënë e drejta për t'u shprehur, por në fakt ata kanë pak ndikim në atë se çfarë bëjnë dhe si marrin pjesë.

123 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

124 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

125 MRKS, Politika rinore e Kosovës, tetor 2006.

126 KCSF, Mapping analyses of civil society in Kosovo, September 2005.

127 Po aty,

128 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

129 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

130 Si pjesë e programit "Youth Post Conflict Participation Program" të financuar nga UNDP dhe zbatuar nga IRC.

131 Karta e Komisionit Evropian "Një nxitje e re për rininë europiane".

132 Misioni i OSBE-së në Kosovë: Asambletë Rinore për Zhvillim të Komunitetit, 2006.

133 Një projekt i ri i Bankës Botërore, që synon forcimin e kohezionit social dhe të bashkëpunimit midis të rinjve të etnive të ndryshme, parashikon financime projektesh për Qendrat rinore kundrejt aplikimesh.

134 UN – Vullnetarizmi në Kosovë, Prishtinë 2003.

135 UN – Vullnetarizmi në Kosovë, Prishtinë 2003.

136 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

137 Ky Ligj është në procesin e miratimit nga Kuvendi i Kosovës.

138 Letër e kryetarit të Rrjetit Rinor Kosovar drejtuar Departamentit të Rinisë, tetor 2006.

139 Nga tryeza me të rinjtë veprimtarë politikë, Prishtinë, gusht 2006.

140 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

141 Nga tryezat me të rinjtë në Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe Gjilan, gusht-nëntor 2006.

142 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

143 Nga tryezat me të rinjtë në Mitrovicë, nëntor 2006

144 Nga tryezat me të rinjtë në Prishtinë, gusht 2006.

145 Te Rinjtë dhe Politika – faktorët kryesorë të vendosjës demokratike, Sofija 2005

146 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

147 Rinia në Evropën Juglindore, – Raport nga Konferenca e Romës mbi Pjesë-marrjen, Fuqizimin dhe Përfshirjen Sociale, qershor 2002.

148 Nga tryezat me të rinjtë në disa komuna të Kosovës.

149 KQZ, Rezultatet e zgjedhjeve, 2002 dhe 2004.

150 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.

151 WB, World Development Report 2007.

152 IARD, Study on the state of young people and youth policy in Europe, January 2001.

153 UNDP, Anketa e Raportit të Zhvillimit Njerëzor – Kosova 2006, Prishtinë, qershor 2006.